ISSN 1857-6443

Skriningu

Me drejtësinë, aty ku dhemb më shumë

Fq.3

EMIGRANTËT NGA IRANI

"Ruta Ballkanike" ende aktive

Fq.5

OSMANI

Nuk meritonim fitore

Fq.19

www.koha.mk

Koha

Buzëqeshja e heshtur

Fq.17

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XII · Numri 3471 · e premte, 28 shtator 2018 · 4°c | 21°c · 15 DEN

ETIOLOGJIA E KRIMIT NË MAQEDONI

ÇDO VRASJE I KA SPECIFIKAT E VETA

Në Maqedoni janë kryer disa krime viteve të fundit, kurse natyra e tyre ka qenë e ndryshme. Por, pamundësia për të detektuar drejt shkaqet dhe motivet e një krimi, ka shpie në përsëritjen e krimit. Motivet e vrasjeve janë të shumta, por më të shpeshta ndërlidhen me xhelozinë dhe dashurinë, me borxhet, dhe me problemet tjera sociale

Fq.7

AKTUALE

Druri, alternativa kryesore për ngrohje

Me uljen e temperaturave në Maqedoni kanë filluar edhe përgatitjet për sezonin e dimrit. Andaj, edhe banorët po bëjnë përllogaritjet se cila mënyrë e ngrohjes dhe me cilin energjens do t'ju shpaguhet më shumë. Në parim, druri mbetet alternativa kryesore për ngrohje e banorëve të Maqedonisë në vendbanimet rurale. Nga ana tjetër, energjia elektrike, përkundër çmimit që rëndon xhepat e qytetarëve, megjithatë mbetet opsioni...

Fq.7

GLOBI

Pesë mundësi si mund të shkojnë punët

Fq.15

RAJON

Kina hyn në Ballkan, po a përbën rrezik?

Fq.14

Mësim nën pikat e shiut

Tetovë, 27 shtator - Shkolla fillore periferike "Gjergj Skënderbeu" në fshatin Xhepçisht, gjatë reshjeve të shiut pikon nga pullazi nëpër mësonjtore. Ndonëse bëhet për një objekt, i cili është inauguruar para 5 viteve, megjithatë objekti më shumë se 20 vite nuk ishte lëshuar në përdorim. Përgjegjësi i shkollës, Imri Abdylamiti, thotë se këto probleme shfaqen gjatë kohës kur ka të reshura. "Ky problem po na ndjek katër apo pesë vite me radhë. Me kalimin e kohës, komuna ka bërë intervenime, por ato kanë qenë afatshkurtra, dhe ky problem neve po na përcjell çdo vit shkollor. Tash me reshjet e para kur do të vijnë, jemi të shqetësuar se mësonjëtoret do të pikojnë. Po ashtu kalon edhe nëpër rrjetin elektrik dhe paraqet rrezik për ndonjë problem më të madh për jetën dhe shëndetin e nxënësve. Ne si...

Fq.9

INTERVISTË

"NE KONSIDEROHEMI SI MEDIA ARMIKE"

Ministria e Brendshme e Austrisë donte të mënjanonte disa media kritike, ndër të tjera gazetën javore, Falter. Kryeredaktori i revistës, Armin Thurnher shprehet për Deutsche Wellen se është i zemëruar, po jo i habitur

Në një E-Mail drejtuar Drejtorive të Policisë në landet austriake, Ministria e Punëve të Brendshme e drejtuar nga politikani i FPÖ-së, Herbert Kickl kishte rekomanduar që komunikimi me media si Kurier, Standard dhe Falter "të kufizohet në masën më të nevojshme (e paraparë nga ligji). Ky disfavorizim i mediave të caktuara solli reagime të forta në Austri. Kancelari austriak, Sebastian Kurz dhe ministri Herbert Kickl, u detyruan të distancohen nga njoftimi.

Deutsche Welle: Z. Thurnher, pse Ministria e Punëve të Brendshme e drejtuar nga partia populiste djathtiste, FPÖ nuk do t'i japë më, siç thuhet në E-Mail, "sheqerka" mediave si Standard, Kurier apo gazetës suaj Falter?

ARMIN THURNHER: Këto janë natyrisht media që janë kritike ndaj ministrit të Punëve të Brendshme. Falter është përgjithësisht shumë kritik dhe shumë jokomod, sepse e ka shoqëruar që nga fillimi punën e qeverisë me histori investigative. Prandaj le të themi se ne shihemi aty që nga fillimi si media armike, ata nuk na duan. Edhe ne sigurisht nuk i duam, por ne përpiqemi megjithatë të ruajmë kriteret e duhura. Nga ana tjetër me sa duket kjo nuk bëhet.

A ju ka shokuar përmbajtja e Emailit?

Natyrisht jam i zemëruar, por nuk jam i habitur. Çfarë përmendet aty është një praktikë e njohur në Austri. Jo vetëm ky ministër, por edhe të tjerë para tij i kanë furnizuar mediat bulevardeske me informacione ekskluzive. Ato merreshin me vete në aksionet kundër trafikantëve afrikanë të drogës, për të treguar se ky është problem i madh. Deri në një masë të caktuar është normale që politikanët të kenë kontrollin mbi mesazhet që japin. Por kam ndjesinë se FPÖ dhe qeveria kanë një axhendë komunikimi mjaft të ekzagjeruar. Sidomos në një shoqëri të depërtuar nga mediat masive sociale është e rrezikshme, kur nga qeveria nuk ka informacione transparente ku kanë akces të gjitha mediat.

A e shihni lirinë e shtypit në rrezik në Austri?

Kur një institucion demokratik shpërblen mediat që mbajnë qëndrim pro dhe ndëshkon ato kritike kjo është një ndërhyrje fundamentale në lirinë e shtypit dhe mendimit. Në këtë formë kjo është e re për Austrinë dhe vetë FPÖ-në. Por në tërësi nuk jam i shqetësuar për lirinë e shtypit, sepse ne mund të mbrohemi kundër shkeljeve të tilla. Fakti që E-Maili u bë publik tregon, se jo të gjithë në ministri e mbështesnin këtë.

Ministria e Brendshme u mbrojt duke theksuar, se bëhej fjalë për propozime, Kickl vetë ia hodhi përgjegjësinë për formulimin zëdhënësit. Si e shihni këtë?

Nuk është e besueshme që Kickl nuk ka të bëjë me përmbajtjen e këtij E-Maili. Ai e thotë këtë natyrisht që të mos rrezikojë postin. Zëdhënësi i tij, zoti Pölzl ka qenë më parë zëdhënës personal i zotit Kickl, pra ka një afërsi mes tyre. Por nga ana tjetër ka edhe një përgjegjësi politike, ministri është përgjegjës për nëpunësit e tij.

Edhe kancelari Sebastian Kurz është shprehur për këtë duke theksuar se "çdo kufizim i lirisë së shtypit është i papranueshëm". Mbyllet me këtë historia?

Jo, nuk mendoj se mjafton ky reagim. Kur një ministër vepron kështu, kancelari ka detyrimin të ndërhyjë. Kurz mund t'i kërkojë FPÖ-së, se është e pamundur që Kickl të qëndrojë në këtë post duke kërkuar zëvendësimin e tij.

Si e shihni të ardhmen ju si përfaqësues i shtypit austriak?

Ishte inkurajuese të shihje se një pjesë e madhe e popullsisë, pavarësisht nëse e përkrahte qeverinë apo jo, në këtë çështje kishte një qëndrim të qartë. Dhe shumica e politikanëve thanë, "kjo nuk tolerohet aspak." Por ne mediat duhet të mbetemi vigjilente.

Armin Thunher (lindur në 1949) është gazetar e publicist austriak. Ai është botues dhe kryeredaktor i gazetës liberale të majtë, Falter në Austri dhe është nderuar me disa çmime.

PROJEKTI "KOPSHT ME SENSOR"



"Avancimi i cilësisë së procesit edukativo-arsimor të nxënësve me aftësi të posaçme, zgjerimi i mundësive arsimore për ta, e më pas edhe mundësive për punësim dhe në përgjithësi sigurimi i të gjitha të drejtave që ua garanton Kushtetuta dhe korniza juridike e shtetit është obligim jo vetëm i institucioneve të sistemit, por edhe i çdo individi që është pjesë e proceseve të përgjithshme shoqërore.
Bashkë me ambasadorin amerikan Xhes Bejlli, sot në shkollën fillore 'Dimitar Vllahov' vëmë në funksion projektin 'Kopsht me sensor' ku nxënësit do të mund t'i zhvillojnë shkathtësitë fizike, aftësitë për orientim dhe lëvizje në ambient.
Falënderoj Odën Ekonomike Amerikane në Maqedoni dhe të gjithë anëtarët e saj që kanë dhënë donacion që ky projekt të realizohet, si dhe dua të falënderoj Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës e cila vite me radhë janë partnerët tanë të sinqertë në përmirësimin e të gjitha sferave të jetës shoqërore në vend", ka shkruar një status në Facebook, ministri i Arsimit dhe Shkencës, Arbër Ademi.

VRASËSIT MODERN TË ARSIMIT SHQIP !

"Si hulumtuese kam nevojë për një përgjigje konkrete. Kur është bërë testimi i fundit në shkollat fillore për arritjen e nivelit të gjuhës shqipe?
Personalisht për veten time çdo ditë e ushtroj gjuhën nëpërmjet të librave, gazetave, shkrimeve të ndryshme në rrjetet sociale dhe debatet me miqtë e mi.
Edukatorët që kanë marrë mbi vete detyrën e arsimimit të gjeneratave të reja pa marrë parasysh cilën lëndë e ushtrojnë si mundet të mos i vërejnë lëshimet gjuhësore të fëmijëve gjatë ushtrimeve të orës.
Parashtrohet pyetja vallë këto ushtrues detyre me certifikata magjistra dhe doktora shkencash janë vrasësit modern të arsimit shqip!", ka shkruar në profilin e saj në Facebook, Sibela Alimovska.

GJYNAH QË NUK ËSHTË BËRË AKTOR VUÇIQI!

"Në një fjalë që ka mbajtur në partinë e vet, (SNS) Vuçiqi ka thënë se mendon që nga shumë anë Serbinë e përjetojnë si "faktor çrregullues."
Bile është shfaqur i çuditur me këtë gjë! Sigurisht që ai nuk sheh atë që shohin të tjerët.
Ai demek nuk sheh që BeH po stabilizohet me diversionet dhe presionet serbe.
Nuk sheh që edhe Kosova mbahet nën presion, me planin për aneksimin e veriut të saj. Ai tipi nuk ka parë as mercenarët serbë që kanë qenë pjesë komplotit ruso-serb për ta vrarë ish kryeministrin malazez.
Natyrisht Vuçiqi nuk e ka parë as ndërhyrjen e personelit të ambasadës së Serbisë në Shkup, në dhunën në Kuvend.
Gjynah që nuk është bërë aktor ky person, pasi në të njëjtën shfaqje di të aktrojë rolin e xhelatit dhe të viktimës", ka shkruar një status në Facebook, Milazim Krasniqi.

NËSE NUK E KENI DITUR...

ÇFARË KA QENË LINJA?

Linja ka qenë pjesë kryesore e veshjes popullore, e përhapur pothuaj në të gjithë Shqipërinë. Bëhej me pëlhurë shtëpie, dikur prej liri (prej nga ka marrë edhe emrin) ose kërpi dhe, më vonë, prej pambuku. Kishte shtat të drejtë, me kinda anëve, dhe mëngë të gjata. Linja ishte e gjatë deri në gju ose deri në pulpë. Janë të njohura për larminë dhe hijeshinë e zbukurimeve të tyre linjat e Myzeqesë, të Dumresë, të Shpatit, të Fushë-Krujës, të Zadrimës, të Bregut të Bunës, të Hasit etj. Në shumë zona linja mbahej si veshje e sipërme dhe njëkohësisht si ndërresë mbi të cilën vishej një fustan i gjatë.
Linja e ka prejardhjen nga një veshje e ngjashme, e përdorur nga ilirët, që përmendet te autorët me emrin "dalmatika" (veshje e dalmatëve).

NË BRUKSEL FILLOI PROCESI I SKRININGUT PËR MAQEDONINË

ME DREJTËSINË, ATY KU DHEMB MË SHUMË

Drejtori i Drejtorisë për Zgjerim në Bashkimin Evropian, Kristijan Danielson, tha se takimi për kapitullin 23 është fundamental, jo vetëm për shkak të metodologjisë së re negociuese të Komisionit Evropian për vendet e reja anëtare, por sepse me reformat lidhur me drejtësinë dhe sundimin e ligjit janë kushte të vendosura nga Këshilli i BE-së për fillim efikas të bisedimeve me BE-në në qershor të vitit 2019

Koha — Fatos RUSHITI

Shkup, 27 shtator - Të enjten në Bruksel është hedhur hapi i parë i përgatitjes së Maqedonisë për anëtarësim të plotë në Bashkimin Eevropian, tre muaj pasi vendi ynë mori rekomandim pozitiv për hapje të negociatave nga ana e Këshillit të BE-së për në qershor të vitit të ardhshëm. Delegacioni 40 anëtarësh i Qeverisë së Maqedonisë në krye me zëvendëskryeministrin për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, nisën procesin e Skriningut pranë zyrtarëve më të lartë të BE-së. Zëvendëskryeministri Osmani gjatë fjalës së tij vuri theksin tek tre objektivat me të cilat Qeveria dhe i gjithë shteti do të punojnë në kuadër të procesit për integrim.

"Shteti paralelisht do ti përkushtohet implementimit të Marrëveshjeve për fqinjësi të mirë me Bullgarinë dhe Greqinë, do ta mbajë momentumin reformues për përmbushjen e vërejtjeve dhe udhëzimeve të konkluzioneve të këshillave të qershorit, si dhe fuqishëm dhe pa kompromis të hyjë në përmbushjen e detyrimeve nga skriningu shpjegues, duke u përgatitur për të, në tre fushat paralelisht, për fillimin e negociatave në qershor të vitit të ardhshëm", theksoi Osmani, duke shtuar se këtë shans që është dhënë nga BE, gjenerata e tanishme politikanëve në Maqedoni nuk duhet ta lëshojë.

Takimi i punës në të cilën Komisioni Evropian prezantoi analizën e Kapitullit 23 - gjyqësorit dhe të drejtave fundamentale, për Maqedoninë vazhdon gjatë gjithë ditës në vijim, ndërkaq sipas agjendës, grupi punues do të vazhdojë me punë edhe gjatë ditës së nesërme, ku dhe pritet t'ju bashkohet edhe Eurokomisioneri për Zgjerim, Johanes Han. Para të pranishmëve, fjali rasti pati edhe ministrja e Drejtësisë, Renata Deskoska, si dhe drejtori i Drejtorisë për Zgjerim në Bashkimin Evropian, Kristijan Danielson dhe përfaqësues të tjerë të Komisionit Evropian.

Danielson përpara dy ekipeve negociuese, atij të Shqipërisë dhe Maqedonisë, deklaroi se sot është fillimin i angazhimit më intensiv i lidhjes sonë të gjatë. "Ekspertët tanë do ta sqarojnë gjatësinë dhe thellësinë e ligjvënësit të përbashkët evropian (acquis communautaire), rregullat e BE-së, tha Danielson. Sipas tij, ekspertët e BE-së, delegacioneve të Maqedonisë dhe Shqipërisë për dy ditë do ti sqarojnë legjislacionin e plotë të BE-së dhe praktikat më të mira në fushën e drejtësisë dhe të drejtave fundamentale. "Vitin e ardhshëm do të mbahen edhe 32 mbledhje të këtilla, për çdo kapitull të procesit negociues, që gjithsej ka 33, ose 160 mijë faqe ligje evropiane dhe rregulla, të cilat patjetër duhet të transferohen në ligjvënësin e brendshëm. Ekipet do të kenë edhe shtatë takime të këtilla", theksoi Danielson. Patjetër, sipas Danielson, të ketë mirëkuptim të përbashkët për atë se çfarë janë rregullat e BE-së që të përgatiteni për anëtarësim në të ardhmen. Danielson tha se takimi për kapitullin 23 është fundamental, jo vetëm për shkak të metodologjisë së re negociuese të Komisionit Evropian për vendet e reja anëtare, por pasi me reformat e lidhura me drejtësinë dhe sundimin e ligjit janë kushte të vendosura nga Këshilli i BE-së për fillim efikas të bisedimeve me BE-në në qershor të vitit 2019.

Sipas metodologjisë së re të BE-së, të vendosur pas valës së fundit të zgjerimit, të gjitha vendet e reja kandidate në mënyrë të obligueshme fillojnë me këto dy kapituj, kyçe për konsolidimin e sundimit të së drejtës të drejtave të njeriut dhe drejtësisë. Në muajt e ardhshëm, madje deri në qershor të vitit 2019, kur Këshilli i BE-së duhet edhe zyrtarisht të japë dritën e gjelbër për fillimin e negociatave nëse Maqedonia i përmbush kushtet e dhëna, duhet të mbahen 31 takime të ngjashme si ky i djeshmi për çdo kapitull tjetër negociues, nga bujqësia e deri te mjedisi i jetesës apo edhe konkurrencës.

Të gjitha këto takime përgatitore do të mbahen së bashku me delegacionin shqiptar, për shkak të faktit që të dyja vendet në qershor së bashku morën datë të kushtëzuar për fillimin e negociatave. Kjo praktikë nuk është e zakonshme për BE-në, e cila preferon që secili vend të përparojë sipas meritave të veta, por në këtë fazë përgatitore - është vendosur që të dyja vendet të shkojnë në pako. Më tej, gjatë negociatave për anëtarësim, pritet të zbatohet parimi "secili sipas meritës së vet", brifojnë burime diplomatike në Bruksel. Nga ana tjetër, shumë ekspertë të marrëdhëniëve ndërkombëtare theksojnë se Maqedonia shumë shpejt do të mund jo vetëm ta kalojë Shqipërinë, por edhe "të parët" e tanishëm, Malin e Zi dhe Serbinë, sepse vendi si kandidat shumëvjeçar për anëtarësim që moti punon në vendosjen dhe harmonizimin e kornizës legjislative për aderim drejt BE-së.

Termi "skrining" përdoret nga ana e vendeve kandidate, por shmanget në komunikimin me vendet anëtare, para së gjithash për shkak të vendeve si Franca dhe Holanda, nga shkaqe politike, sepse për këto vende çdo aluzion i zgjerimit është i ndjeshëm deri në zgjedhjet e ardhshme evropiane në vitin 2019, sqarojnë diplomatët evropianë në Bruksel.

AMBASADA E SHBA-SË ME REKOMANDIM

Evitoni lëvizjet para Parlamentit dhe në sheshin "Maqedonia"

Shkup, 27 shtator - Ambasada e SHBA-së në Republikën e Maqedonisë në ueb faqen e saj publikoi kumtesë në të cilën i porosit shtetasit amerikanë që të evitojnë vendet ku janë të mundura tubime të qytetarëve në vigjilje të referendumit javor, sidomos para Parlamentit dhe sheshit "Maqedonia". "Grupe të ndryshme kanë për qëllim të demonstrojnë kundër referendumit të ardhshëm për marrëveshjen e Prespës për emrin mes Maqedonisë dhe Greqisë, që do të mbahet të dielën më 30 shtator. Protesta spontane të paparalajmëruara mund të ndodhin edhe në lokalitete tjera në Shkup dhe pjesë tjera të vendit në këtë periudhë. Personelit të Qeverisë amerikane i këshillohet t'i evitojë vendet ku janë të mundura protestat", theksohet në kumtesën e Ambasadës amerikane.

Prokuror kujdestar ditën e Referendumit

Shkup, 27 shtator - Prokuroria Publike e Maqedonisë do të jetë e gatshme të procedoj çdo lloj veprimi të kundërligjshëm, i cili eventualisht mund të ndodhe me 30 shtator, ditën kur pritet të mbahet Referendumi në vendin tonë. Prokurori Xhelal Bajrami, i cili e kryeson Komisionin e përkohshëm për monitorimin e parregullsive eventuale në Referendum, të enjten njoftoi se më 30 shtator, në prokurori do të ketë të angazhuar prokuror kujdestar. Mes tjerash, ai njoftoi se pjesë e ekipit të prokurorëve janë përfaqësues nga katër prokuroritë e larta në vend, si dhe një përfaqësues i Prokurorisë së Shkupit. "Komisioni jonë është formuar në bazë të Kapitullit 16 të Kodit Penal të Maqedonisë, pjesë kjo e cila lidhet me parregullsitë gjatë zgjedhjeve dhe votimeve. Detyrë e këtij komisioni do të jetë përcjellja e shkeljeve eventuale ligjore që kanë të bëjnë procesin e referendumit që do të mbahet të dielën, me 30 shtator 2018. Njëkohësish, ky komision në vazhdimësi i ka përcjellur të gjitha aktivitet dhe organizimet për referendumin", tha prokurori Bajrami.Ndryshe, ai gjatë konferencës për shtyp theksoi se deri në Prokurorinë Publike deri më tani është parashtruar një kallëzim penal që lidhet me referendumin dhe e njëjta është deleguar për procedim në Prokurorinë e Kumanovës.

Linjë falas për shkeljen e të drejtës së votës

Shkup, 27 shtator - Të dielën më 30 shtator, në ditën e mbajtjes së referendumit, në zyrën e Avokatit të Pupullit në periudhën prej orës 7 deri në orën 18 do të funksionojë linja telefonike falas 0800-54321 në të cilën qytetarët do të mund të paraqesin çdo lloj shkelje të së drejtës zgjedhore. Të gjitha shtatë zyrat e Avokatit të popullit në Shkup, Manastir, Kërçovë, Kumanovë, Strumicë, Tetovë dhe Shtip të dielën do të hapen me qëllim që qytetarëve t'u ndihmohet në realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre. Avokati i Popullit komunikoi se qytetarët mund të drejtohen personalisht në zyrat, por edhe në linjën falas të telefonit në numrat: Manastir 047 242-310, Kërçovë 045 228-586, Kumanovë 031 431-448, Strumicë 034 329-996, Tetovë 044 344-082 dhe Shtip 032 389-701. Avokati i Popullit në njoftimin e sotëm për media përkujtoi rëndësinë e jashtëzakonshme të realizimit të së drejtës së prononcimit të drejtpërdrejtë dhe konsideron se deklarimi i qytetarëve dhe i qëndrimit të tyre lidhur me pyetjen në referendum, është detyrim i tyre dhe në mënyrë aktive kontribuojnë për të ardhmen në shoqëri.

DITËT EVROPIANE TË TRASHËGIMISË

MERRENI MË SERIOZISHT TRASHËGIMINË

Mbrojtja e trashëgimia është vendosur këtë vit nën dritën e fortë të prozhektorëve, duke e shpallur 2018-ën si "Viti i trashëgimisë kulturore evropiane", e që do të thotë promovim i kujdesit për diversitetin kulturor, përpjekjeve për ta mbrojtur dhe konservuar atë. Për atë se çfarë ka ndodhur gjatë një viti, aktorë të kësaj sfere pohojnë se qasja ndaj trashëgimisë vazhdon të jetë selektive dhe shumë pak serioze, ndërsa trajtimi institucional është shumë larg normave dhe standardeve evropiane

Koha Evis HALILI

Shkup, 27 shtator - Mbi njëzet muze, organizata joqeveritare dhe institucione të tjera janë përfshirë në manifestimin "Ditët evropiane të trashëgimisë" që zhvillohet nga datat 27 deri më 7 tetor. Mbrojtja e trashëgimia është vendosur këtë vit nën dritën e fortë të prozhektorëve, duke e shpallur 2018-ën si "Viti i trashëgimisë kulturore evropiane", e që do të thotë promovim i kujdesit për diversitetin kulturor, përpjekjeve për ta mbrojtur dhe konservuar atë. Për atë se çfarë ka ndodhur gjatë një viti, aktorë të kësaj sfere pohojnë se trajtimi institucional është shumë larg normave dhe standardeve evropiane, qasja ndaj trashëgimisë vazhdon të jetë selektive dhe shumë pak serioze. Drejtori i Qendrës Nacionale të Konservimit, Mehmet Selmani pohon se vetë situata ku gjenden institucionet, me mungesa të theksuara kuadri dhe qindra objekte nën kujdes, tregon se trashëgimia mbetet në margjinat e kujdesit shtetëror.

"Promovimi i trashëgimisë kulturore evropiane është i lidhur vazhdimisht me konceptin e diversitetit kulturor, që merr një vend gjithnjë e më të rëndësishëm në mendimet bashkëkohore si një vlerë evropiane në vetvete dhe si një karakter specifik i kulturës evropiane. Ne duhet të jemi më korrekt dhe jo me qasje selektive ndaj kulturës dhe trashëgimisë, sidomos kur flasim për atë shqiptare. Por mbi të gjitha dua të veçoj një problem që e kemi, mungesën e kuadrit. Katedrat duhet të stimulojnë studentët që të paktën numri i arkeologëve, historianëve të artit të jetë më i madh. Si shembull e marr QNK, ku numri i specialistëve është jashtëzakonisht i vogël", thotë drejtori i QNK, Mehmet Selmani. Angazhimi institucional për të mbrojtur trashëgiminë është i vogël, pohon drejtori i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore dhe Kulturore, Skënder Asani.

"Instituti është duke punuar që të mbrojë dhe të afirmojë pjesën e trashëgimisë shpirtërore, por nevojitet një përkrahje më e madhe institucionale në mënyrë që trashëgimia të etablohet si duhet, me të gjitha potencialet e saj. Nga ana tjetër, proceset që po vijnë dhe ndodhin në Europë me vështirësi gjejnë zbatim tek ne për shkak se nuk janë kompaktibile me vetë mënyrën sesi perceptohen tek ne. Prandaj metodologjia për mbrojtjen e trashëgimisë duhet të ndryshojë, pasi qarqe të ndryshme institucionale vazhdojnë të jenë të ngarkuar me nacionalizma të cilat krijojnë barriera në ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë së përbashkët", thotë drejtori Asani.

Mbrojtja e trashëgimisë materiale dhe jomateriale është një temë që ngacmon vazhdimisht, thotë historiania artit dhe arkeologia Narona Luma.

"Në Maqedoni po mbahen aktivitete të ndryshme kulturore që i takojnë trashëgimisë kulturore, duke përfshirë debate kulturore, promovime librash nga trashëgimia, ekspozita e të tjera. Sikur ka filluar ringjallja dhe angazhimi i shoqërisë, si dhe institucioneve kulturore për promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore shqiptare, por gjithsesi duhet ende edhe më shumë punë për të bërë dhe angazhim akoma më të madh. Ndoshta është ky fillimi ku punohet në këtë drejtim dhe shpresoj që në vazhdimësi në të ardhmen të përfshirja dhe përkushtimi të jenë edhe më të mëdha, sidomos për trashëgiminë kulturore shqiptare. Niveli ku është mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë materiale dhe jomateriale është shqetësuese dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me trashëgiminë kulturore duhet të jetë shqetësuese, sepse përmes saj kemi se çka ju tregojmë brezave të ardhshëm", thotë Luma.

MEHMET SELMANI

Ne duhet të jemi më korrekt dhe jo me qasje selektive ndaj kulturës dhe trashëgimisë, sidomos kur flasim për atë shqiptare. Por mbi të gjitha dua të veçoj një problem që e kemi, mungesën e kuadrit. Katedrat duhet të stimulojnë studentët që të paktën numri i arkeologëve, historianëve të artit të jetë më i madh. Si shembull e marr QNK, ku numri i specialistëve është jashtëzakonisht i vogël

SKENDER ASANI

Instituti është duke punuar që të mbrojë dhe të afirmojë pjesën e trashëgimisë shpirtërore, por nevojitet një përkrahje më e madhe institucionale në mënyrë që trashëgimia të etablohet si duhet, me të gjitha potencialet e saj. Nga ana tjetër, proceset që po vijnë dhe ndodhin në Europë me vështirësi gjejnë zbatim tek ne për shkak se nuk janë kompaktibile me vetë mënyrën sesi perceptohen tek ne

NARON LUMA

Niveli ku është mbrojtja dhe ruajtja e trashëgimisë materiale dhe jomateriale është shqetësuese dhe gjithçka tjetër që ka të bëjë me trashëgiminë kulturore duhet të jetë shqetësuese, sepse përmes saj kemi se çka ju tregojmë brezave të ardhshëm

TALAT XHAFERI TAKON HOMOLOGUN E TIJ KOSOVAR, KADRI VESELI

INFRASTRUKTURA RRUGORE, PRIORITET I TË DYJA VENDEVE

Shkup, 27 shtator - Maqedonia është Kosova, si dy vende fqinje, nuk kanë çështje të hapura prandaj është më se i domosdoshëm të rrisin intensifikimin e marrëveshjeve bilaterale në të gjitha fushat, ekonomike, kulturore dhe arsimore. Kështu deklaroi kryetari i Parlamentit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, pas takimit me kryeparlamentarin e Maqedonisë, Talat Xhaferi. "Në këtë takim, përveç temave ekonomike që janë shumë të rëndësishme për të rritur këmbimin tregtar midis dy vendeve dhe ndërtimin e infrastrukturës rrugore, diskutuam edhe për politikat e përbashkëta të të dyja vendeve për rrugën në integrimin euroatlantik dhe në familjen e vendeve të BE-së. Së shpejti presim marrëveshje në mënyrë që të krijojmë premisa edhe për Ballkanin, por edhe për popujt tonë", tha Veseli.

Duke folur për marrëveshjet me Serbinë, Veseli tha se ka progres edhe për çështjen e Veriut të Kosovës. "Nuk do lejojmë asnjë precedent negativ në marrëveshjen me Serbinë. Gjithmonë është më lehtë të jesh joracionalë. Është lehtë të manipulohet emocionalisht te qytetarët, synimi është të arrihet një marrëveshje paqësore dhe të kalohet situata e konfliktit. Është lehtë të valohet flamuri i Kosovës dhe ai Shqipërisë. Arritje e marrëveshjes që po negociohet e që do të jetë e pranueshme për të dyja palët, po vështirësohet nga opozita e cila tani bënë thirrje edhe për protesta. Kjo po bllokon funksionet e shtetit për shkak të dialogut me Serbinë", tha Veseli. Kryeparlamentari i Maqedonisë, Talat Xhaferi, sa i përket bashkëpunimit bilateral midis Maqedonisë dhe Kosovës, tha se është arritur një konstatim i përbashkët - të dy kanë vendosur që dialogu bilateral të vazhdojë, edhe pse nuk mungon, por që duhet të ngritet në nivele më të larta dhe të zgjerohet bashkëpunimi. "Përsërisim bashkëpunimin e thellë drejt çështjeve evropiane për të dyja vendet tona. Ne inkurajojmë një seancë të përbashkët për bashkëpunim më të thellë, por edhe për prosperitet mes vendeve tona. Maqedonia përshëndet marrëveshjet e arritura me BE-në dhe vazhdimin e dialogut për prosperitet në Ballkan", tha Xhaferi.

(Z.V)

EMIGRANTËT NGA IRANI VËRSHOJNË MAQEDONINË

"RUTA BALLKANIKE" ENDE AKTIVE

Kronika e zakonshme e MPB-së muajve të fundit është kryesuar nga lajmet e hyrjeve ilegale të emigrantëve në Maqedoni. Në lokacione të ndryshme të vendit, gjatë tre muajve të kaluar, janë zbuluar grupe të mëdha emigrantësh, të cilët ose kishin hyrë nga Greqia, ose ishin kthyer nga shteti Serb

Koha — Omer XHAFERI

Shkup, 27 shtator - Nëse jo me mijëra, muajve të fundit nëpër Maqedoni janë zbuluar dhjetëra grupe ilegale të emigrantëve. Për dallim kur në të kaluarën numri më i madh i tyre vinin nga shtetet si Siria apo Iraku, periudhën e fundit numri më i madh i tyre janë nga Pakistani dhe Irani. Brenda muajve korrik-gusht, siç njoftojnë nga policia e shtetit për gazetën KOHA, nga Greqia në Maqedoni, nëpërmjet rrugëve ilegale, janë futur gjithsej 182 emigrantë. "Gjatë periudhës së theksuar është zbuluar një grup kriminele katërantarësh, i cili ka trafikuar 23 emigrantë nëpërmjet të ashtuquajturin 'brezin e gjelbër' nga Greqia në Maqedoni. Gjatë kohës së transportit të këtyre emigrantëve personi i denoncuar ka humbur kontrollin mbi automjetin dhe me shpejtësi të madhe është përplasur në një gardh mbrojtës. Si rezultat i kësaj ndeshjeje, humbën jetë dy emigrantë dhe 12 tjerë pësuan lëndime të rënda. Shumica e emigrantëve që tentojnë të futen apo të dalin në Maqedoni vijnë nga Irani, Pakistani, Afganistani, Libia dhe një numri i vogël nga shtetet tjera", thonë në MPB. Për dallim nga organet e rendit, të cilët shpeshherë hezitojnë të japin informacione për arsyet e shtimit të numrit të emigrantëve ilegal në vendin tonë, nga sektori civil thotë emigracioni ilegal si fenomen ndonëse me intensitet të ulët, çdoherë do të jetë aktiv. Sipas aktivistit Jasmin Rexhepi, edhe pse Ruta Ballkanike zyrtarisht u mbyll në vitin 2016, ky itinerar, siç thotë ai, vazhdon të mbetet linja më e preferuar e emigrantëve për të arritur në ndonjë prej shteteve të Bashkimit Evropian.

"Jo zyrtarisht, numri i migrimit ilegal në Maqedoni arrin deri në 10 persona në ditë. Kjo gjendje ka vazhduar që nga mbyllja e Rutës Ballkanike në vitin 2016. Duhet të dihet se migracioni është një çështje e ndryshueshme vazhdimisht. Çdoherë ekzistojnë njerëz që janë në lëvizje. Tash, vetë shteti ynë gjendet në aso pozite gjeografike-strategjike që ato persona, të cilët kryesisht vijnë nga Lindja e Mesme dhe Afrika, doemos të kalojnë përmes Ballkanit që të arrijnë në Evropë. Në këto rrethana aktualizohen rrugët e trafikantëve që janë prezent edhe në vendin tonë", thotë Rexhepit. Organizata jo qeveritare "Legis" dhe përfaqësues tjerë të shoqërisë civile vazhdojnë të jenë prezent në dy kampet e refugjatëve në Gjevgjeli dhe Tabanoc, përfshi kufirin verior me Serbinë. Trajtimi i emigrantëve në vendin tonë nga policia, sipas tyre, është në nivelin e duhur. Në njërin prej raporteve të fundit të Komitetit të Helsinkit, thuhet se një pjesë e emigrantëve në vendin tonë gjatë tre muajve të kaluar janë ballafaquar me dhunë dhe maltretime të ndryshme që kryesisht vijnë nga grupet kriminele. Duke folur për respektimin e konventave ndërkombëtare për liritë dhe të drejtat e njeriut, Jasmin Rexhepi, shprehet se emigrantët me probleme më serioze ballafaqohen gjatë hyrje-daljeve në pikat kufitare Serbi-Bosnje dhe Bosnje-Kroaci, ku këta të fundit në mënyrë të dhunshme i kthejnë në territorin e Bosnjës.

"Rrahja, maltretimet dhe nënçmimi janë vetëm një pjesë e metodave të cilën e shfrytëzojnë autoritet kroate në raport me emigrantët. Kjo qasje e tyre diskriminuese bëhet me të vetmin qëllim - që emigrantet të kthehen të demoralizuar dhe mos tentojnë të vazhdojnë rrugën drejtë shteteve të BE-së", thotë Rexhepi.

IRANIANËT IKIN NGA REGJIMI, PAKISTANEZËT NGA VARFËRIA

Arsyet sepse shumica e emigrantëve që muajve të fundit janë futur në vendin tonë e që vijnë nga Irani e Pakistani, sipas Rexhepit, janë të ndryshme. Mungesa e sigurisë në pjesën veriore të Pakistanit dhe varfëria apo gjendja e rëndë ekonomike në pjesën e mbetur të saj, paraqesin shkaqet kryesore që i shtyjnë banorët e këtij shteti ti rreken rrugës së emigracioni drejtë BE-së. "Shtimi i numrit të emigrantëve nga Irani në masë të madhe ka të bëjë me linjën direkte ajrore që është lëshuar përmes Beogradit dhe Teheranit. Në këtë mënyrë, atyre nuk ju nevojitet vizë, gjegjësisht me aeroplan - shtetasi (emigrantët) nga Irani për disa orë gjendet në afërsi të dyerve të BE-së, respektivisht nga Serbia ato tentojnë të futen në Kroaci. Ankesat më të shpeshta të tyre janë se në vendin e tyre mbizotëron një regjim totalitar", thotë Rexhepi.

POLICIA E KUMANOVËS PADIT ISH-MINISTREN E MPB-së

Edhe një padi për Jankullovskën

Shkup, 27 shtator - Ish-ministrja e Punëve të Brendshme, Gordana Jankullovska, ngarkohet edhe për një vepër penale. Nën dyshimin e "keqpërdorimit të detyrës zyrtare", policia e Kumanovës, të enjten deri te Prokuroria Publike dorëzoi kallëzim penale kundër ish-ministres Jankullovska.

"Jankullovska, si ish-ministre e Punëve të Brendshme e Maqedonisë, gjatë vitit 2012, në më shumë raste, duke e shkelur kornizën ligjore për pranim dhe procedurën publike për praktikantë, është drejtuar deri te Ministria e Financave me kërkesë për sigurimin e mjeteve financiare për punësimin e 70 praktikantëve me arsim të lartë dhe 30 praktikantëve me arsim të mesëm. Njëherësh, në këtë kërkesë, ajo ka theksuar se për pesë vende punë me arsim të lartë do të shpallet konkurs publik, përderisa për 65 vende praktikantë me arsim të lartë dhe 30 me arsim të mesëm punësimi do të bëhet pa konkurs publik, po me sigurimin e parave bruto, në vlerë prej 15.028 denarë për person", thonë nga MPB. Në njoftimin e policisë së shtetit, mes tjerash thuhet se me datë 06.06.2012 e denoncuara, për vendin e punës për të cilën është paraparë arsim profesional katërvjeçar, ka punësuar bashkëshorten e një funksionari të lartë të MPB, e cila nuk ka pasur nivelin e duhur arsimor, gjegjësisht ajo ka pas të kryer arsim të mesëm tre vjeçar. "Përkundër këtij statusi, personi në fjalë ka nënshkruar Marrëveshje pune, me pagë të plotë mujore prej 620 pikëve, pa vendosjen e klauzolës 'praktikant'. Në këtë mënyrë është përjashtuar paga e patjetërsueshme mujore, e cila jepet gjatë kryerjes së punës

për praktikantët. Me këtë veprim, e denoncuara ka dëmtuar MPB dhe buxhetin e saj në vlerë prej 1 milion e 700 mijë denarë", theksojnë nga MPB". Ndryshe, kundër ish-ministres Jankullovska, para Gjykatës Penale të Shkupit një kohë të gjatë po zhvillohen disa procese gjyqësore, nën dyshimin e "keqpërdorimit të pozitës zyrtare". *(O.Xh)*

Më 3 tetor fjalët përmbyllëse për Mercedesin e Gruevskit

Shkup, 27 shtator - Përfitimi i realizuar i operatorit ekonomik është në kuadër të përfitimit të zakonshëm nga shitja e automobilit "Mercedes C600", gjegjësisht nuk ka realizuar përfitim ekstra, theksoi sot në Gjykatën Penale në Shkup, eksperti për punë materiale dhe financiare, Strahil Gligorovski. Ekspertizën e ka bërë sipas urdhrit të PSP-së për ta konfirmuar përfitimin e dilerit të shitjes së automjetit për seancën e PSP-së në lëndën "Tank", për çka zhvillohet procedura e ndarë kundër ish-ministres së Punëve të Brendshme, Gordana Jankulloska për furnizimin publik të automobilit të blinduar "Mercedes Gard" në vlerë prej 600 mijë euro në vitin 2012. Seancën e ardhshme, gjykatësja Dobrila Kacarska e caktoi për më 1 tetor kur duhet të merret në pyetje dëshmitari i fundit dhe personi teknik i mbrojtjes si dhe të kryhen edhe dëshmitë shtesë nga të dyja palët. Gjykatësja Kacarska më 3 tetor i caktoi fjalët përmbyllëse.

Vlojnë arrestimet për tregti me drogë

Tetovë, 27 shtator - Në rrugën "Jashtë Vardarit", në Tetovë, pjesëtarët e policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë kanë ndaluar veturën "Daevu Matiz" me targa të Tetovës e drejtuar nga 36-vjeçari M.H. nga Tetova, ku kanë qenë shoqëruar edhe 41-vjeçari H.K. nga Reçica e Vogël dhe B.S. 40-vjeç nga Tetova. Gjatë kontrollit ndaj B.S., në xhepin e pantallonave është gjetur një ziper-qese me marihuanë, prej ku edhe është munduar të ik, por menjëherë është kapur nga policia, derisa nën ulësen e shoferit në veturë, është gjetur një qese e grisur me kokainë. Tre personat janë privuar nga liria, ndërsa droga e gjetur është fotodokumentuar dhe bashkë me veturën, janë marrë për ekspertizë. Pas zbardhjes së plotë të rastit, do të pasojnë edhe padi adekuate. Nga policia e Tetovës njoftojnë se në të njëjtën rrugë, janë privuar nga liria 24vjeçari Sh.S. nga Tetova dhe 21-vjeçari E.R. nga fshati Gjurgjevisht i Gostivarit. Gjatë kontrollit të tyre, nga personi Sh.S. janë marrë tre paketime me marihuanë, të cilat janë dërguar për ekspertizë. Pjesëtarët e policisë nga SPB-Tetovë, të mërkurën mbrëma në fshatin Çegran kanë privuar nga liria personin Sh.F. 25-vjeçar, tek i cili është gjetur një paketim me marihuanë. Pas zbardhjes së plotë të rastit, ndaj personit Sh.F. do të lëshohet kallëzim penal, informojnë nga policia. *(U.H)*

NIS SEZONI I DIMRIT

DRURI, ALTERNATIVA KRYESORE PËR NGROHJE

Dominimin e drurit si energjens kryesor për ngrohje e dëshmojnë edhe të dhënat zyrtare, sipas të cilave, nga numri i përgjithshëm i amvisërive në Maqedoni, afër 62 për qind e përdorin drurin si energjens kryesor për ngrohje, 28 për qind ngrohen me rrymë, 8 për qind nga ngrohtoret, ndërsa 2 për qind me lloje tjera të energjensave

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 27 shtator - Me uljen e temperaturave në Maqedoni kanë filluar edhe përgatitjet për sezonin e dimrit. Andaj, edhe banorët po bëjnë përllogaritjet se cila mënyrë e ngrohjes dhe me cilin energjens do t'ju shpaguhet më shumë. Në parim, druri mbetet alternativa kryesore për ngrohje e banorëve të Maqedonisë në vendbanimet rurale. Nga ana tjetër, energjia elektrike, përkundër çmimit që rëndon xhepat e qytetarëve, megjithatë mbetet opsioni kryesor i banorëve të vendbanimeve urbane. Megjithatë, edhe këtu ka përjashtime për shkak se në më shumë qytete të vogla, në mbarë vendin, por edhe në fshatra, të gjithë ata që jetojnë në shtëpi private në një pjesë të madhe orientohen në ngrohjen me dru, ndërsa rrymën e përdorin për ngrohje shtesë. Dominimin e drurit si energjens kryesor për ngrohje e dëshmojnë edhe të dhënat zyrtare statistikore, sipas të cilave, nga numri i përgjithshëm i amvisërive në Maqedoni, afër 62 për qind harxhojnë dru si energjens kryesor për ngrohje, afër 28 për qind përdorin energjinë elektrike, rreth 8 për qind energjinë e ngrohjes nga ngrohtoret dhe afër 2 për qind i përdorin llojet e tjera të energjenseve.

Ekspertët e energjetikës thonë se kostoja e ngrohjes së amvisërive varet edhe prej ngrohjes gjithë-ditore apo vetëm pas orarit të punës, jetesës në fshat apo qytet, ngrohjes së një apo më shumë dhomave, përdorimit më të madh apo më të vogël të izolimit, si dhe faktit se sa një sezon dimri do të përshkohet me periudha kohore më të gjata apo më të shkurtra të temperaturave të ulëta apo më të larta se zero.

"Llogaria mujore e ngrohje në një pjesë të madhe varet nga izolimi i objekteve të banimit. Njëherazi, vendosja e izolimit dhe ndërrimi i dritareve nuk është edhe e lirë dhe kërkon një investim jo të vogël, por megjithatë shpaguhet për shtatë deri tetë vite", thotë profesori universitar Risto Ciconkov. Në ndërkohë, statistika zyrtare tregon se hapësirat banuese në Maqedoni ngrohen gjashtë muaj e gjysmë, me një temperaturë mesatare prej 21.7 gradë celsius përgjatë periudhës së dimrit.

Nga ana tjetër, përllogaritjet tregojnë se një amvisëri në Maqedoni në mesatare harxhon prej 6 deri 10 metra dru që kushton afërsisht 50-60 euro m2, apo me fjalë tjera - për ngrohje harxhohen prej 300 deri 500 euro.

Rryma, edhe pse energjens i shtrenjtë për xhepin e amvisërive në vend, megjithatë mbetet preferenca e njerëzve sidomos në ambientet urbane me ndërtesa shumëkatëshe, ku nuk ekziston mundësia për ngrohje me dru. Njëherazi, rryma paraqet një energjens që ofron komoditet, nuk ka pastrim të koftorit apo oxhaqeve dhe as kërkon magazinë për ruajtjen e drurit. Vitet e fundit edhe në Maqedoni përdoren me të madhe llojet e reja të ngrohjes si kondicioneri, aparatet me inverter që kanë koeficient më të lartë të shfrytëzimit të energjisë. Në varësi prej cilësisë së aparateve të tilla, ato së paku përgjysmojnë çmimin e energjisë së harxhuar. Çmimet e modeleve të ndryshme në treg lëvizin prej 20 mijë deri më 50 mijë denarë. Përparësi e madhe ngrohjes me klimë inverter është dobia se, për një kilovat rrymë të harxhuar, fitohen 2-4 kilovat energji të ngrohjes për dallim prej aparateve të tjera për ngrohje që prodhojnë energji aq sa harxhojnë rrymë. Konsumi i rrymës për ngrohje përgjatë dimrit varet nga llojet e trupave për ngrohje, ngrohjes së një apo më shumë dhomave, kohëzgjatjes së ngrohjes përgjatë një dite, intensitetit të ngrohjes, andaj edhe amvisëritë harxhojnë në mesatare për ngrohje me energji elektrike prej 3000-4000 denarë deri më 8000 deri më 10 mijë denarë.

Ngrohja qendrore që në Maqedoni është kryesisht në përdorim në Shkup, ndërsa vitet e fundit shënon rënie të popullaritet për shkak të problemeve të ndryshme, si dhe pagesës përgjatë të gjithë 12 muajve. Ndryshe, njohësit e energjetikës në shtet presin që pas përfundimit të gazifikimit në Maqedoni, qytetarët do të mund të zgjedhin ndërmjet më shumë llojeve të ngrohjes si gazi, druri, thëngjilli e kështu me radhë. Pra gazi natyror pritet të ndikojë në rritjen e konkurrencës në sektorin e energjetikës dhe garën për konsumatorë me çmime konkurruese.

OFERTAT E TREGUT TË PUNËS

PROGRAMUESIT MË TË KËRKUARIT

Sigurimi i një vendi të punës dhe pagat e mira që mesatarisht lëvizin nga 1000 euro janë arsye shtesë e interesimit të madh në këtë fushë

Koha Remzije BILALLI

Shkup, 27 shtator - Në bazë të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikave në listën për paga më të larta është radhitur profesioni "Programimi kompjuterik" ku paga mesatare është 60.112. Kjo është rritje e madhe në krahasim me pagën mesatare në vend, e cila është 24.072 denarë, sidomos nëse krahasohet me vendet tjera më të zhvilluara. Paga mesatare e programuesve kompjuterikë në Maqedoni është më e lartë se niveli i lartpërmendur, ndërsa në listën e Agjencisë së punësimit, ndër profesionet më të kërkuara nga sektori i biznesit privat.

Numri i të interesuarve nga kjo fushë në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike është më i madh krahas viteve të kaluara, pavarësisht trendeve negative të cilat ndodhin në shoqërinë tonë siç janë migracioni, rrethanat politik dhe zhvillimi i dobët ekonomik. Mirëpo rritja e interesimit në këtë fushë, jo vetëm në Maqedoni, është vërejtur edhe në nivel global, sepse ky shekull njihet si shekull i teknologjisë. Profesori universitar Halil Snopçe për gazetën KOHA theksoi se jemi në kohën e digjitalizimit dhe programuesit janë të kudo ndodhur në të gjitha poret e shoqërisë, përfshi edhe institucionet dhe bizneset. Snopçe radhiti disa arsye se pse studentët drejtohen në drejtimet për shkenca kompjuterike, duke vendosur theksin tek favoret për punësim.

"Ky profesion garanton perspektivë, të ardhura të mira, siguron atraktivitet, prandaj të rinjtë zgjedhin këtë profesion. Favori qëndron edhe tek punësimi jashtë vendit, ndërsa kompanitë e ndryshme jashtë vendit kërkojnë shërbime nga ne sepse fuqia e punëtorëve është më e lirë këtu", nënvizoi Snopçe. Sipas tij, ky profesion ka nevojë për talent sepse gërsheton disa aftësi si kreativitetin, gjuhët, shkathtësinë dhe shpejtësinë e të qenit në hap me atë që na rrethon. Po ashtu ky profesion jep mundësi për të punuar individualisht, mjafton që personi të posedoj vetëm një kompjuter. Për studentët përveç zhvillimit masovik të teknologjisë dhe instalimit të saj në përditshmërinë tonë, faktor kryesor në një shtet drejt zhvillimit ekonomik luan edhe paga. "Shumica e të rinjve sipas meje frymëzohen nga rrogat, pasi gjendja ekonomike është e rënduar për popullin dhe nuk mendoj që të gjithë studentët që zgjedhin këtë drejtim e kanë edhe e duan atë, por këtu ndikon edhe kërkesa në tregun e punës, e cila rritet çdo ditë e më shumë", thotë studenti Veton Nesimi.

Në bazë të statistikave botërore tregu ka më tepër nevojë për ekspertë të IT-së se sa në faktë është numri i të diplomuarve në këtë fushë. Ky profesion edhe në vendet tjera ka të ardhura më të mëdha në krahasim me pagën minimale. Në SHBA, bie fjala, një programues ka pagë mesatare vjetore 69.083 dollarë, në Britanin e Madhe - 30.625 funta, në Rusi - 961.173 rubla, ndërka në Turqi - 35.662 dollarë.

Në UEJL filloi vitit i ri akademik 2018/2019

Tetovë, 27 shtator - Në Universitetin e Europës Juglindore ka filluar viti i ri akademik. Për të mirëpritur studentët e rinj të gjeneratës 2018/2019, është organizuar një pritje solemne nga stafi akademik i këtij universiteti nga dekanët dhe profesorët, të cilët studentëve të rinj u kanë dëshiruar mirëseardhje dhe suksese në vitin e ri akademik. Pjesë e pritjes solemne të studentëve të rinj ishte edhe rektori i këtij institucioni të lartë arsimor akademik, Abdylmenaf Bexheti, i cili në fjalën e tij përshëndetëse, përveçse ka uruar studentët për një fillim të mbarë të vitit akademik, ka nënvizuar edhe tre vendime të rëndësishme që janë determinante për një karrierë të suksesshme akademike. Studentëve të rinj me rastin e fillimit të vitit të ri akademik u është drejtuar edhe kryetari i Parlamentit studentor, Veton Iljazi, i cili studentët i ka njoftuar për rolin, veprimtarinë, funksionin dhe misionin e parlamentit studentor. Përndryshe, këtë vit akademik në Universitetin e Europës Juglindore studimet do ti ndjekin studentë në pesë fakultete (Biznes dhe Ekonomi, Shkenca dhe Teknologji Bashkëkohore, Administrim Publik dhe Shkenca Politike, Drejtësi dhe në Fakultetin e Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit). Studimet organizohen në gjuhën shqipe, maqedonisht dhe anglisht, ndërsa ndahen edhe bursa në bashkëpunim me Ministrinë, ambasada dhe kompani me renome ndërkombëtare. Këtë vit në këtë universitet janë regjistruar 1300 studentë të rinj. *(U.H)*

Pas NATO-s, më shumë investime dhe turistë

Shkup, 27 shtator - Hyrja në NATO do të thotë siguri më e madhe për turistin botëror, si dhe investime të përforcuara në infrastrukturën turistike, ndërsa me dyert e hapura drejt Evropës qëllimet tona ambicioze mund të bëhen realitet për një kohë shumë të shkurtër, tha dje ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, në manifestimin me rastin e Ditës Botërore të Turizmit. Bekteshi përmendi se Maqedonia vitin e kaluar e ka realizuar qëllimin e paparë - një milion turistë dhe mbi tre milionë bujtje. "Nuk ndalemi këtu sepse qëllimet tona janë shumë më ambiciozë, Maqedonia të jetë në hartën e vendeve më të rëndësishme turistike eksportuese në rajon, Evropë dhe më gjerë", tha ministri. Sipas tij, potenciali i turizmit është i madh vetëm duhet të shfrytëzohet, ndërsa për këtë nevojitet që bashkërisht të veprojnë të gjitha palët e prekura. Statistika tregon se në katër muajt e parë të këtij viti turizmi i Maqedonisë shënon 26,5 për qind rritje nga derdhja e realizuar devizore. Drejtori i Agjencisë për Zhvillim dhe Mbështetje të Turizmit Lupço Janevski vlerësoi se vendi në vit nga sektori i turizmit mund të realizojë derdhje devizore prej 380 deri në 400 milionë dollarë.

ETIOLOGJIA E KRIMIT NË MAQEDONI

ÇDO VRASJE I KA SPECIFIKAT E VETA

Në Maqedoni janë kryer disa krime viteve të fundit, kurse natyra e tyre ka qenë e ndryshme. Por, pamundësia për të detektuar drejt shkaqet dhe motivet e një krimi, ka shpie në përsëritjen e krimit. Motivet e vrasjeve janë të shumta, por më të shpeshta ndërlidhen me xhelozinë dhe dashurinë, me borxhet, dhe me problemet tjera sociale

Koha — Delvina KËRLUKU

Shkup, 27 shtator - Parahistoria e krimeve ka qenë dhe mbetet fushë delikate ekspertizash e studimesh. Proceset gjyqësore që kanë në thelb një krim të pasqaruar deri në fund, kanë intriguar madje edhe regjisorë e skenaristë të famshëm. Për rrjedhojë, pamundësia për të detektuar drejt shkaqet dhe motivet e një krimi, ka shpie në përsëritjen e krimit.

Por, nuk janë të pakt studiuesit të cilët duan ta lokalizojnë "embrionin" në të cilën një krim ngjizet dhe zakonisht ata përmendin çrregullimet shpirtërore e psikike, si shkaktarë më të shpeshtë që nxit një person të kryej krim. Karakterologjia e këtyre krimeve bazën e ka në gjendjen e destabilizuar shëndetësore të njerëzve, ndonëse studiuesit tjerë janë të prirur të besojnë se ekziston edhe korpusi i problemeve sociale që shërben si fitil për të dhezur pakënaqësi te ata që zgjedhin krimin si rrugën më të shkurtër në zgjidhjen e problemeve të grumbulluara.

Në Maqedoni janë kryer disa krime viteve të fundit, kurse natyra e tyre ka qenë e ndryshme. Rasti i vrasjes së Almirit të vogël nga ana e Bobal Iliqit nga Kumanova është një ekzemplar tipik i krimit me paramendim, i cili gjatë procesit gjyqësor pësoi deformim, duke e transformuar në një aksident të rëndomt trafiku. Që ky rast të jetë edhe më i komplikuar në pamundësinë e difinimit, flet edhe ekspertiza mjeko-ligjore e cila e nxjerr vrasësin të mos ketë motiv psiko-patologjik, gjegjësisht vrasje goja pa paramendim. Viktima tjera të një vrasje makabre na paraqiten anëtarët e një familjeje shqiptare nga Maqedonia, prej kohësh me banim në Trevizo të Italisë. Pas hetimev të bëra policia arriti në përfundim të zbardhjes së shkaqeve që çuan 28-vjeçaren Blerta Pocesta të vret babain, nënën dhe motrën 13-vjeçare në shtëpinë familjare në Dibër. Për motivet e kësaj vrasjeje janë dhënën disa versione, kurse më i shpeshti që ka qarkulluar kishte të bënte me mospajtimet e prindërve dhe vajzës rreth martesës së kësaj të fundit me një

Ndërsa, jehona e vrasjes tjetër makabre, e kryer nga polici Enver T. në afërsi të Prilepit, ende është aktuale në opinionin publikë, jo vetëm për motivet, por edhe për mënyrën e kryerjes së krimit. Në fakt trupi i viktimës Bekir O. kisht përfunduar në gjendje të karbonizuar, për arsye se vrasësi pasi e kishte vrarë, në fund edhe e kishte djegë trupin e të ndjerit.Sipas psikiatrit Kadri Haxhihamza, çdo rast i vrasjeve ka spekifikat e vet. Ai është i mendimit se motivet e vrasjeve janë të shumta, por më të shpeshta ndërlidhen me xhelozinë dhe dashurinë, me borxhet, dhe me problemet tjera sociale. Krimi, sipas tij, është një akt i menjëhershëm që patjetër të shpijë në mjegullim të vetëdijes së njeriut, shoqëruar me veprim impulsiv, e që përfundon me epilog tragjik. Psikiatri Haxhihamza përjashton motivin e urrejtjes etnike në rastin e vrasjes së Almirit të vogël nga Kumanova, ku vrasësi ka qenë i etnisë joshqiptare. Ai konsideron se te ne nuk ekzistojnë rrethana që vrasjet të kiualifikohen me motive etnike apo religjioze. Sipas psikologëve, çrregullimi i personalitetit të njeriut mund të shkaktojë problem në rrethin shoqëror.

"Nëse shqyrtohet nga aspekti mjekësor-psikologjik, vrasja konsiderohet si një çrregullim personaliteti, por nëse ajo është e qëllimshme, mund të konsiderohet edhe si sëmundje. Çrregullimi i personalitetit definitivisht ka edhe etiopatogjenezen e saj, ndërkaq kjo përshkohet me kompleksivitetin e zhvillimit të karakteristikave dhe pjesëve apo dimensioneve të personalitetit", thotë për gazetën KOHA, profesori universitar i psikologjisë Arafat Shabani. Për psikologun Lulzim Murtezani, njerëzit me çrregullime mendore duhet të merren parasysh dhe të trajtohen nga mjeku apo psikologu.

"Përgjithësisht shumë vrasje të kryera ndaj një personi, dhe veçanërisht vrasjet ndaj një grupi të njerëzve (gjenocid), kanë vulën e çrregullimeve psikike. Sa për ilustrim një person që vuan nga një psikozë e rëndë e quajtur Skizofreni, papritmas mund të gjuaj me revole drejt personit tjetër pavarësisht e ka mik apo kalimtar i rastit. Një psikopat, gjatë kohë ndjek viktimën e tij, dhe me përsosmëri të rrallë, godet atë duke e lënë të vdekur, madje thua se kjo nuk mjafton, vazhdon ta torturojë trupin e tij të pa jetë, madje edhe duke e djegur", nënvizon për gazetën tone profesori universitar i psikologjisë Murtezani. Tipat të diagnostikuar me çrregullime mentale si të rrezikshëm për shoqërinë dhe veten, në gjendje të krizës nervore, nuk marrin në konsideratë pasojat ndaj të tjerëve dhe shumë afër janë të vrasin dhe lëndojnë të tjerët.

Akti i vrasjes pa asnjë shqetësim mendor, për psikologun Shabani, konsiderohet si një papjekuri kognitivo-emocionale, ku rrënjët i ka në strukturat e zhvillimit dhe ndërtimit të percepcioneve të gabuara dhe patologjike ndaj fenomeneve dhe situatave që e rrethon njeriun. Ndërsa, për psikologun Murtezani, sa më shumë që individët kanë qasje të lirë ndaj mjeteve vrasëse (revolver dhe armë tjera), probabiliteti është më i lartë të kryejnë aktin e vrasjes dhe lëndimit të tjerëve.

Sa i përket vrasjeve me motive etnike, psikologu Lulzim Murtezani vlerëson se ato kanë qenë të pranishme edhe në të kaluarën jot ë largët, kur politikat gjenicidale janë të orientuara në zhdukjen e komuniteteve të tëra etnike, siç ka ndodhur, bie fjala, me vrasjen e miliona hebrenjve gjatë holokaustit. Ose vrasjet e civilëve shqiptar nga paramilitarët serb në regjimin e Millosheviqit- vetëm pse ishin shqiptar.

"Individualisht, nuk përjashtohet mundësia që dikush të vras dikë edhe me motive etnike, por kështu ndodh vetëm te individë që në fakt kanë probleme të rënda psikike.

Energjia e shkatërrimit ekziston brenda njeriut (te dikush më pak e te dikush më shumë), dhe kjo ka qenë në ta kaluarën dhe ashtu do të jetë edhe në të ardhmen. Por, në shoqëri demokratike, ku sundon ligji dhe barazia, numri i vrasjeve është më i vogël sepse energjia destruktive zvogëlohet te njerëzit duke qenë të angazhuar me sport, punë dhe aktivitete rekreative", nënvizon Murtezani.

Ndërsa, për psikologun Shabani, nëse varfëria dhe problemi etnik paraqiten ose konsiderohen si shkaqe për aktin e një vrasjeje, këto janë vetëm pretekste si arsyetim ose qëllim në vete për mos pjekurinë e personalitetit, ku segmenti kryesore është jo ndërtimi i vlerave të shëndosha, të realta dhe objektive për një kontekst jetese.

Këshilli për ndarje të çmimit shtetëror 'Mito Haxhivasilev Jasmin' publikon:

K O N K U R S
për ndarje të shpërblimit shtetëror 'Mito Haxhivasilev-Jasmin' në vitin 2018.

Me shpërblimin shtetëror "Mito Haxhivasilev-Jasmin" jepet mirënjohje për të arriturat në fushën e publicistikës dhe gazetarisë.

Shpërblimi shtetëror u ndahet individëve, grup krijuesish, ekipeve, institucioneve, shoqatave dhe shoqërive tregtare dhe organizatave të qytetarëve.

Shpërblimi shtetëror sipas kushteve të përcaktuara në konkurs mund t'u ndahet edhe shtetasve të huaj, grup krijuesish, ekipe dhe institucione nga jashtë.

Individit të shpërblyer i ndahet: diplomë dhe shumë të hollash.

Secilit anëtar të grupit ose ekipit të shpërblyer të krijuesve u ndahen diploma dhe pjesë të barabarta të shumës së parave.

Institucionit, shoqatës tregtare ose shoqërisë të qytetarëve të shpërblyera u ndahen diplomë dhe pllaketë.

Shuma e të hollave të shpërblimit shtetëror 'Mito Haxhivasilev-Jasmin' arrin *pesë (5) rroga mujore mesatare* në Republikën e Maqedonisë të paguara tre muajt e fundit të vitit aktual.

Shpërblimi shtetëror 'Mito Haxhivasilev-Jasmin' sipas rregullit, ndahet çdo vit.

Në një vit mund të ndahen më së shumti deri në *dy (2) shpërblime*.

Iniciativë për ndarjen e shpërblimit shtetëror 'Mito Haxhivasilev-Jasmin' mund të parashtrojnë: institucionet, shoqatat tregtare, shoqëritë qytetare dhe qytetarët.

Parashtruesit e iniciativës për ndarjen e shpërblimit shtetëror duhet në detaje të arsyetojnë iniciativën. Në tekst duhet të jenë të përmbajtura edhe: të dhëna të sakta biografike, adresë të saktë banimi (adresa-rruga, numri, vendi, qyteti, shteti), të dhëna për rezultatet e arritura në fushën në të cilën është arritur e realizuara dhe të dhëna të tjera të cilat llogariten se do të kontribuojnë në vlerësim.

Parashtruesi i iniciativës duhet të vendosë emrin dhe mbiemrin e plotë, titullin, firmën, adresën dhe numrin e telefonit.

Teksti i iniciativës (i kompletuar) të dorëzohet në 15 kopje, ndërsa punimet (librat, publikimet etj) trajtohen si shtojca dhe duhet të dorëzohen në dy (2) kopje.

Iniciativat duhet të dorëzohen në adresën në vijim:

Ministria e kulturës e Republikës së Maqedonisë – Këshilli për ndarje të shpërblimit shtetëror 'Mito Haxhivasilev-Jasmin', rr. 'Gjuro Gjakoviq' nr. 61 – Shkup, Republika e Maqedonisë.

Konkursi zgjatë prej ***01.10 deri më 31.10.2018.***

Iniciativat dhe propozimet e pakompletuara (punimet, librat, publikimet etj) të dorëzuara pas afatit të përcaktuar për pranim në konkurs nuk do të merren parasysh nga Këshilli.

Këshilli për ndarje të shpërblimit të 'Mito Haxhivasilev-Jasmin'

FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË

SH P A LL J E

PASQYRË E AKSIONEVE NË PRONË TË FONDIT QË DO TË OFROHEN PËR SHITJE NË BURSËN E MAQEDONISË PËRMES ANKANDIT PUBLIK BURSAR NË TRE DITË RRESHT TË TREGËTIMIT, DUKE FILLUAR NGA 17.10.2018

SHITJA E AKSIONEVE PRIORITARE

Numër rend.	Shoqëria aksionare	Vendi	Numri i aksioneve për shitje	Vlera nominale e shoqërisë në EURO	Vlera nominale e kapitalit për shitje (EURO)	Pjesëmarrja e kapitalit për shitje në vlerën e shoqërisë në %	Çmimi fillestar shitës i një aksioni në EURO
1	SHA TOPOLA	Shkup	116	42,728	506	1.18%	0.04
2	AGD GRADBA PRILEP	Prilep	14	136,771	3,579	2.62%	2.00
3	POLET SHA	Shkup	6,442	219,579	32,937	15.00%	0.04
4	MAKEDONSKA KNIGA SHA	Shkup	1,373	611,454	70,200	11.48%	0.40
5	ZUS SHA	Shkup	17,488	2,822,740	357,659	12.67%	0.16
6	MEBEL SHA SHTIP	Shtip	18,100	345,122	46,272	13.41%	0.02
7	SHA 29 NOEMVRI	Shkup	213	817,991	50,095	6.12%	12.20
8	FERMA E DERRAVE MAK MESO SHA	f.Tarinci	1,757	1,539,530	89,818	5.83%	0.40
9	ZHIVINO KOMERC SHA	Shtip	24,623	3,201,976	125,895	3.93%	0.04
10	ADONEKS SHA	Shkup	478	496,857	15,878	3.20%	0.26
11	SHA OTEKS	Ohër	14,320	15,423,731	451,916	2.93%	0.25
12	SHA PESHNA	Makedonski Brod	98	234,632	5,011	2.14%	0.40
13	METROPOLITEN SHA	Shkup	679	386,296	3,472	0.90%	0.04
14	ARCELORMITTAL SHKUP (HRM) SHA	Shkup	1,197,373	61,011,862	6,118,576	10.03%	0.41

Aksionet do të ofrohen për shitje përmes Bursës së Maqedonisë në tre ditë rresht të tregëtimit duke filluar nga 17.10.2018. Shitja e aksioneve do të bëhet sipas modelit "në pjesë" nëpërmjet më shumë transaksioneve. Pagesa do të bëhet në para të gatshme dhe në denarë.

FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË

www.piom.com.mk

Në bazë të nenit 110-e të Ligjit për Mbrojtje sociale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 70/09, 36/11, 51/11, 166/12, 15/13, 79/13, 164/13, 187/13, 38/14, 44/14, 116/14, 180/14, 33/15, 77/15, 104/15, 150/15, 173/15, 192/15, 30/16, 163/17, 51/18), ndërsa në lidhje me nenin 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/14, 199/14, 27/16) dhe nenit 22 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 62/05, 106/08, 161/8, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), Drejtori i Institucionit publik qendra ndërkomunale për punë sociale Kriva Pallankë publikon:

SHPALLJE PUBLIKE 3/2018
Për punësim të tre (3) realizuesve për kohë të pacaktuar në Institucionin publik qendra ndërkomunale për punë sociale Kriva Palkankë

IP qendra ndërkomunale për punë sociale Kriva Pallankë publikon shpallje për punësim të tre(3) realizuesve për kohë të pacaktuar për pozitat në vijim

1. **SOZ0303A06001 – Punëtor i diplomuar social** – Nëpunës profesional të nivelit të gjashtë, 1 (një) realizues, në Shërbimin për shërbime të mbrojtjes sociale.

Kushtet e posaçme

- Për nivelin A6 të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar (Punë sociale dhe politikë sociale) pa përvojë pune.
- Njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë (diplomë, dëftesë ose certifikatë përkatëse)
- Njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në BE, Angleze, Frënge, Gjermane (diplomë, dëftesë ose certifikatë përkatëse)

2. **SOZ0303A06001 – Punëtor i diplomuar social** – Nëpunës profesional të nivelit të gjashtë, 1 (një) realizues, në Shërbimin për shërbime të mbrojtjes sociale.

Kushtet e posaçme

- Për nivelin A6 të arritura së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar (Punë sociale dhe politikë sociale) pa përvojë pune.
- Njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë (diplomë, dëftesë ose certifikatë përkatëse)
- Njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në BE, Angleze, Frënge, Gjermane (diplomë, dëftesë ose certifikatë përkatëse).

3. **SOZ0303A05009 – Defektolog** – nëpunës profesional i pavarur i nivelit të pestë. 1 (një) realizues, në Shërbimin për shërbime të mbrojtjes sociale.

Kushtet e posaçme

- Për nivelin A5 të arritura së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar (Defektologji) dhe së paku dy vjet përvojë pune në sferën e mbrojtjes sociale.
- Njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë (diplomë, dëftesë ose certifikatë përkatëse)
- Njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në BE, Angleze, Frënge, Gjermane (diplomë, dëftesë ose certifikatë përkatëse).

Të gjithë kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim të përcaktuara me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Kriva Pallankë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Në mënyrë aktive të njeh gjuhën maqedonase;
- Të jetë i moshës së rritur;
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, dhe
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë dhe detyrës.

Të drejtë për pjesëmarrje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët përmbushin kushtet për konkurrim. Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të parashtrojnë dëshmitë për përmbushje të kushteve në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

Kandidatët duhet të parashtrojnë dokumentet në vijim:

- Certifikatë të shtetësisë jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj;
- Certifikatë të mjekut për aftësinë e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- Vërtetim se nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Dëshmi – Diplomë/Certifikatë për arsim të mbaruar;
- Dëshmi për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- Dëshmi për njohje aktive të një prej tri gjuhëve më shpesh të përdorura në BE, Angleze, Frënge, Gjermane
- Biografi të shkurtë
- Letër motivimi

Orari i kohës së punës, orët e punës gjatë javës: 40, ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 08:30 deri në ora 16:30. Shuma në të holla e neto pagesës fillestare është 23.197,00 denarë (ose sipas shifrës dhe titullit të vendit të punës). Me kandidatët e zgjedhur do të lidhet marrëveshje për punësim për kohë të pacaktuar. Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve me dokumentet e nevojshme është pesë (5) ditë pune duke konsideruar nga dita e ardhshme e ditës së publikimit të shpalljes (duke mos konsideruar ditën e publikimit të shpalljes). Kushtet e theksuara në shpallje kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes. Kandidatët obligohen fletëparaqitjen me dokumentet ta plotësojnë në tërësi, në mënyrë precize dhe me të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike pas përfundimit të së njëjtës do të informohen për zgjedhjen përmes formës me shkrim në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes. Fletëparaqitjen së bashku me dokumentet e nevojshme kandidatët duhet ta parashtrojnë në arkivin e IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Kriva Pallankë ose përmes postës në adresën në vijim: rr. "Nikolla Teslla" pn Kriva Pallankë (me shenjë për shpallje publike)

Kontakt telefoni: 075-451-037.

Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit jo të plota dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

IP qendra ndërkomunale
për punë sociale Kriva Pallankë

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, Vendimit për nevojën për punëtorë nr. 04-988/1 të datës 17.08.2018, nenit 23 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe nenit 34 të Statutit të NP Komunalec, Kavadar ndërsa në pajtim me Rregulloren për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës, Drejtori i ndërmarrjes, publikon

SHPALLJE
Për pranim të punëtorëve

I . NP Komunalec – Kavadar ka nevojë për pranim të punëtorëve për kohë të caktuar prej 6 (gjashtë) muajve edhe atë për vendet e punës në vijim:

1. **Këshilltar** për kontabilitet material në departamentin për financa, 1 (një) realizues, shifra e vendit të punës KDR 01 02 V01 004, me neto pagesë fillestare prej 25.000,00 denarë, 1 (një) realizues
2. **Drejtues – manipulues** në Departamentin për kanalizim pjesa burimore dhe ujërave, Sektori për ujësjellës, shifra e vendit të punës KDR 03 05 V02 004, me neto pagesë fillestare prej 15.200,00 denarë, 1 (një) realizues
3. **Punëtor i përgjithshëm** në Departamentin për kanalizim pjesa burimore dhe ujërave, Sektori për ujësjellës, shifra e vendit të punës KDR 03 05 V02 031, me neto pagesë fillestare prej 15.200,00 denarë, 1 (një) realizues
4. **Pastrues** në Departamentin për higjienë (shërbyese) publike, Sektori për Higjienë Komunale, shifra e vendit të punës KDR 03 05 V02 013, me neto pagesë fillestare prej 15.200,00 denarë, 1 (një) realizues

Kandidatët si dëshmi për përmbushjen e kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj duhet të parashtrojnë dokumentet në vijim:

- Certifikatë të shtetësisë,
- Certifikatë të mjekut për aftësinë e përgjithshme shëndetësore,
- Vërtetim nga gjykata se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të presionit ose detyrës

dhe kushtet e posaçme në vijim:

- Kandidati me numër rendor 1 të posedojë Kualifikime profesionale – niveli i kualifikimeve VI A sipas Kornizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi të fituara sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – Shkencat ekonomike dhe
  Së paku tre vjet përvojë pune në profesion

Kandidatët me numër rendor 2, 3 dhe 4 duhet të përmbushin kushtet e posaçme në vijim:

- Të kenë së paku nivelin kualifikimeve të shkallës I të arsimit ose arsim fillor.

Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune, duke konsideruar nga dita e publikimit të shpalljes në tabelën për shpallje të ndërmarrjes dhe në shtypin ditor në tri gazeta ditore prej të cilave një në gazetën që publikohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve që e flasin gjuhën zyrtare ndryshe nga gjuha maqedonase.

Kandidatët fletëparaqitjet me të gjitha dokumentet duhet t'i parashtrojnë në adresën:

NP Komunalec Kavadar, rr. "Industriska" pn, Kavadar, personalisht në arkiv ose përmes postës.

Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit dhe të paplotësuara nuk do të merren parasysh.

NP Komunalec Kavadar
Drejtor
Gjorgji Pop Icov

SHKOLLA E XHEPÇISHT ME PROBLEME PESË VITE PAS INAUGURIMIT

MËSIM NËN PIKAT E SHIUT

Edhe mësimdhënësit thonë se shpeshherë i largojnë nxënësit nga pjesët ku pikon klasa, por ka patur raste kur edhe i kanë lëshuar në shtëpi fëmijët, megjithëse kanë marrë vërejtje nga ana e autoriteteve përgjegjëse se nuk guxojnë që fëmijët t'i largojnë nga procesi mësimor

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 27 shtator - Shkolla fillore periferike "Gjergj Skënderbeu" në fshatin Xhepçisht, gjatë reshjeve të shiut pikon nga pullazi nëpër mësonjtore. Ndonëse bëhet për një objekt, i cili është inauguruar para 5 viteve, megjithatë objekti më shumë se 20 vite nuk ishte lëshuar në përdorim. Përgjegjësi i shkollës, Imri Abdylamiti, thotë se këto probleme shfaqen gjatë kohës kur ka të reshura.

"Ky problem po na ndjek katër apo pesë vite me radhë. Me kalimin e kohës, komuna ka bërë intervenime, por ato kanë qenë afatshkurtra, dhe ky problem neve po na përcjell çdo vit shkollor. Tash me reshjet e para kur do të vijnë, jemi të shqetësuar se mësonjëtoret do të pikojnë. Po ashtu kalon edhe nëpër rrjetin elektrik dhe paraqet rrezik për ndonjë problem më të madh për jetën dhe shëndetin e nxënësve. Ne si trup i shkollës kemi bërë kërkesë deri tek komuna, ata kanë intervenuar, por nuk kanë qenë të mjaftueshme. Në takimin e fundit, na kanë premtuar se ky problem është përcjellë edhe në Ministrinë e Arsimit dhe jemi me shpresë se një ditë do të merren masa", tha përgjegjësi Imri Abdylamiti. Në ndërkohë, edhe mësimdhënësit thonë se shpeshherë i largojnë nxënësit nga pjesët ku pikon klasa, por ka patur raste kur edhe i kanë lëshuar fëmijët, por kanë marrë vërejtje nga ana e autoriteteve përgjegjëse se nuk guxojnë që fëmijët t'i largojnë nga procesi mësimor.

"Ky është një problem delikat, do të thotë edhe të rënda, sepse krahas asaj që jam arsimtare, po ashtu jam edhe prind dhe kam fëmijët e mi që mësojnë në këtë shkollë, të cilët duhet që të larohen gjatë orëve kur ka reshje nga vendi ku pikon, pra nga klasa, sepse ky është një problem i madh dhe mund të ndodh një katastrofë e madhe. Mund të shkaktohet zjarr dhe pasojat eventuale nuk mund të përmirësohen", tha Samira Idrizi, arsimtare në këtë shkollë.

Në ndërkohë, debati për problemin e shkollës në fshatin Xhepçisht u hap në seancën e Këshillit të Komunës së Tetovës, kur këshilltarët kërkuan nga përgjegjësi për arsim që të merren masa për këtë problem. Nga ana e Komunës së Tetovës nënvizuan se janë bërë intervenime të kohëpaskohshme, por për investime kapitale, përgjegjëse është Ministria e Arsimit.

"Ne kemi njohuri për situatën në këtë shkollë. Kemi bërë disa herë intervenime, ndërsa për investime në infrastrukturën shkollore, përgjegjëse është Ministria e Arsimit dhe Shkencës, e cila edhe i planifikon investimet kapitale", tha Ahmed Qazimi, udhëheqës i dikasterit të Arsimit në Komunën e Tetovës. Ai sqaroi se në këtë shkollë është planifikuar që të vendoset sistemi fotovoltaik dhe pikërisht për këtë janë duke u zhvilluar bisedime që të rregullohet edhe pullazi.

RAPORT I STACIONIT POLICOR

Krimi në Kumanovë shënon rritje

Më i zakonshëm është krimi klasik që mbizotëron me 88 për qind të numrit të përgjithshëm të krimeve. Krimi ekonomik është rritur me 1.7 herë. Një rritje e madhe prej 75% shënohet në tregtinë e paligjshme

Koha Remzije BILALLI

Kumanovë, 27 shtator - Rritje prej 19.7 për qind e krimit është regjistruar në Komunën e Kumanovës në gjysmën e parë të vitit, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, tregon raporti i Stacionit policor i cili u prezantua para Këshillit të komunës së Kumanovës në seancën e fundit. Zvogëlimi prej 5.2% vërehet për shkelje të rendit publik dhe paqes, ndërsa për 12.1% numri i aksidenteve të trafikut është në rritje. Gjatë gjysmës së parë të këtij viti janë regjistruar 686 vepra penale, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitin 2017 ku janë regjistruar 573 vepra. Ndërsa janë paraqitur gjithsej 363 kallëzime penale, që është një rritje prej 280 në krahasim me vitin e kaluar. Nga 383 autorë, vetëm 33 janë fëmijë që kanë kryer 34 krime, e që janë katër më shumë se në vitin e kaluar. Më i zakonshëm është krimi klasik që mbizotëron me 88 për qind të numrit të përgjithshëm të krimeve.

Krimi ekonomik është rritur me 1.7 herë, gjë që është ndër krimet më të vështira për t'u zbuluar. Në këtë kategori, janë regjistruar 59 vepra penale, për dallim nga 22 të vitit të kaluara. Një rritje e madhe prej 75% shënohet në tregtinë e paligjshme, ku mbizotërojnë prodhimi dhe lëshimi i paautorizuar i barnave narkotike, substancave psikoterapie dhe prekursorëve.

Në fushën e transportit rrugor, situata është vlerësuar si e favorshme duke pasur parasysh faktin se në gjysmën e parë të këtij viti kanë ndodhur 223 aksidente rrugore në rrugët dhe rrugët publike në qytet, ose 12.1% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, sipas raportit policor. 623 shoferë u përjashtuan nga trafiku për shkak të shkeljeve të trafikut rrugor dhe 141 leje shoferi u konfiskuan. Në gjashtë muajt e parë të këtij viti, 776 automjete u konfiskuan nga merimanga, ndryshe nga viti i kaluar kur ky numër ishte modest dhe arrinte vetëm 178 automjete të pasagjerëve.

DIBRA BALLAFAQOHET ME MUNGESË UJI

Banorët dhe Komuna fajësojnë njëri-tjetrin

Shkup, 27 shtator - Që nga fillimi i sezonit të verës dhe që nga ardhja e mërgimtarëve, qytetarët e Dibrës po ballafaqohen me mungesën e ujit, nga ora 13 deri në orën 17. Kjo ka ndikuar në përkeqësimin e gjendjes më shumë si në pastrim ashtu edhe në gjërat tjera më elementare. Qytetarët fajin ia hedhin Komunës duke thënë që me ndalimin e ujit Komuna po e furnizon fabrikën "MAYA", gjë që u refuzua kategorikisht nga Komuna e Dibrës, duke ua hedhur fajin qytetarëve që po e keqpërdorin ujin pasi që po e shfrytëzojnë për vaditjen e kopshteve. "Fabrika "MAYA" ka burimin e vet të ujit, do me thënë në bazë të koncesionit që kanë marrë ajo shfrytëzon burimin e vet të ujit, dhe atë që kanë konstatuar banorët nuk është e vërtetë, ndërsa sa i përket ndaljes së ujit është e vërtetë dhe ka orar të reduktimit të ujit sidomos gjatë sezonit të verës. Kjo vjen si pasojë e shfrytëzimit të pakontrolluar nga ana e qytetarëve, pasi që vetë qytetarët e përdorin për vaditjen e kopshteve, dhe kjo lirisht mundë të verifikohet në periudhën kur ka reshje të shiut brenda dy tre ditëve gjatë verës në atë kohë nuk ka mungesë të ujit, dhe kjo vërteton se uji i pijshëm përdoret edhe për vaditje të kopshteve. Një ndër arsyet është kjo, por nuk mundë të themi që nuk ka dhe keqpërdorime tjera, por numër një është kjo arsye, nuk është se ka mungesë të sasisë së ujit të pijshëm, pasi në bazë të të gjitha llogarive me normën ndërkombëtare dhe nacionale, sasia e ujit që vjen në rezervuar i plotëson të gjitha nevojat, por ka mangësi në keqpërdorim", tha sekretari i Komunës së Dibrës, Gazmend Cami. Sipas disa analizave, uji i Dibrës që vjen nga burimi i lumit Rasoçka në malin Bistra është më cilësori në Maqedoni dhe i treti në Evropë. Qyteti furnizohet me 160 litra në sekondë. Qytetarët apelojnë deri te autoritetet lokale që ky problem të zgjidhet sa më shpejtë pasi po vështirësohet jeta e tyre. *(Q.A)*

Hem tebdil, “hem vampir, hem lugat!”

Nga
Fadil LUSHI

Miku im i nderuar dhe i paanshëm! Në këtë shkrim timin “nuk do t’i referohem shpjegimit të Fjalorit tonë” sa u përket shprehjeve të lartpërmendura, jo se janë “figura të besimeve të kota”, jo se nuk janë të sakta, përkundrazi “do t’u referohem provave a fakteve që vërtetojnë prezencën” e lugetërve, vampirëve nacionalistë dhe tebdilëve “të moderuar”..., ndërkaq lidhshmërinë e tyre me moralin e dyfishtë të këtij opinioni do ta parashtroj në paragrafët në vijim.

Në shtetet skandinave thonë se mishshitësit nuk e hanë suxhukun, ndërkaq politikanët fjalimet e tyre, të dala si lajm nëpër gazeta, fare nuk i lexojnë! Që të dy palët e dinë shumë mirë se si janë përgatitur ato, me “ç’zarzavate” janë gatuar, ku janë përgatitur dhe për kë janë dedikuar! Sot, të heshtësh a të mos heshtësh, kjo (s)është çështja, të shkruash a të mos shkruash me e pa tamam, askujt nuk i plas fare, ta bësh a të mos e bësh punën me “axhele” dhe me ndërgjegje të pastër, dije se njerëzit që i ke përreth kanë me të konsideruar si të marrë, të flasësh me zë të lartë e të çjerrë për katrahurën që (nuk) na ka kapur për fyti dhe për..., është njësoj sikur të mbulosh diellin me shoshë, sot të luash rolin e njeriut të sinqertë, lëre që është tragjikomike, por edhe marrëzi..., sot të ngresh krye kundër pushtetit të “mbretit” ose kundër një autoriteti të pamerituar, është njësoj si ajo puna e shpendit ekzotik – strucit, i cili, për t’i shpëtuar rrezikut që i kanoset, fut kokën në rërë, sot të bësh moralin a sjelljen e ndershme kjo nuk çon peshë, sepse asnjeri nuk të dëgjon dhe nuk të bën hesap..., paçka se ne ndërtojmë shkrimin a vështrimin me “surrat të dyfishtë”, kur kjo askujt nuk i hyn në punë, sidomos sot kur gjithsecilit i ka ardhur në majë të hundës..., paçka se ka njerëz të cilët për kokërr të qejfit, po edhe për shtatë palë qejfe të tjera, do të sajojnë ndjenjën e hakmarrjes a armiqësisë kundrejt të tjerëve që mendojnë ndryshe, paçka se njerëzit shtojnë dashurinë e dikush tjetër shton çallëmin..., paçka se skamnorit i shtohen dertet, e ca të tjerëve u rritet mendja, paçka se asnjëri prej nesh nuk shqetësohet me “gjymtimet e pasaportës së arsimit tonë të lartë, një pasaportë që nuk të mundëson të lëvizësh përtej kufijve administrativë të Gadishullit Ilirik”, paçka se gjymtimet tona i diktojnë a i hetojnë jabanxhinjtë pavarësisht se ne i kemi para hundëve tona..., të cilët ose nuk i shohim, ose nuk duam t’i shohim ose, në instancë të fundit, i heshtim si të tilla..., paçka se bëmat tona, arritjet tona i vlerësojnë të huajt, pavarësisht se janë pronë jona. ”Të heshtësh, të shkruash, të flasësh, të luash rolin..., të ngresh krye..., të bësh moralin..., të bësh punën..., e të tjera të bësh”, mua ma kujton atë çudinë e mbretëreshës së llastuar të Danimarkës, njëqind vjet më parë, kur këshilltari i saj i kishte thënë se populli kishte dalë në demonstratë dhe kërkonte bukë, ajo ishte përgjigjur e habitur: “Duan bukë!? Po pse nuk hanë biskota!”

A mos vallë edhe te ne ka njerëz që prej “mbretëreshës rrospi” (nuk) kërkojnë bukën e gojës, a mos vallë në mungesë të bukës (nuk) do të hanë domate, a mos vallë ata që kanë më shumë se ç’u duhet do të vazhdojnë të bëjnë sehirxhiun, do të bëjnë zakonin, do të bëjnë intrigën, do të bëjnë aksham- pazarin me mallin e “miletit pa brekë” (siç do të thotë Mitrush Kuteli), do të bëjnë tellallin, do të bëjnë zurnaxhiun, do të bëjnë daulltarin toptan në emër të popullit fukara..., a mos vallë ne (nuk) do të kemi nevojë për njeriun që do të kandidohet për president shteti (jo) konsensual, i cili pasi vë bythën në kryeminderin e huqumatit, kur i teket del TEBDIL në çarshi e na thotë: “Mos keni nevojë për dajakun e radhës, a mos keni nevojë që unë ta firmos Ligjin për gjuhën tuaj që e ka vlerën e monedhës njëzetqindarkëshe, a mos keni nevojë që të ikni që këtej shtetit tim antik a qymezit tim biblik, a mos vallë keni nevojë për atë parullën fashistoide - përçaj e sundo..., a mos keni nevojë që t’u pres biletën për një drejtim..., a mos keni nevojë t’ua përsëris thirrjet raciste - Shqiptar i mirë është shqiptari i vdekur..., pllaninari..., indijanci...,”

Sot e gjithë ditën e Perëndisë, edhe përtej mungesës së vlerave mendore e shpirtërore, edhe përtej eksodit të të rinjve nga vendi, edhe përtej rrëmujës ekonomike, juridike, politike, arsimore po edhe kulturore, edhe përtej zaptimit të institucioneve shtetërore, përfshi edhe ato fetare, nga ana e pushtetit, edhe përtej mungesës së llogaridhënies, ne parapëlqejmë të heshtim, ne parapëlqejmë të mbyllim sytë e gojën karshi pranisë së shtresave të privilegjuara të cilët përditë e më shumë, me pa të drejtë shtojnë pasurinë e tyre, ne me a pa të drejtë ua hapim rrugën kalorësve të vonuar, pseudo-patriotëve, provincialistëve, vatanlive, kombëtarëve të rrejshëm dhe çetave të kreshnikëve të rremë ta nëpërkëmbin lavdinë e kësaj toke, të shkelin mbi gjakun e dëshmorëve të luftës, të harrojnë kontributin e ish të përndjekurve politikë, a mos vallë ne, me a pa sebep, me a pa hiri, VAMPIRIT prej NACIONALISTI i mundësojmë të fusë hundët në kështjellën a arsimit tonë për të na mësuar sesi duhet anashkaluar këtë institucionin tonë të shenjtë..., a mos vallë ne kemi nevojë për këshillat e tyre sesi duhet të jemi të pandërgjegjshëm dhe të papërgjegjshëm karshi krijimit të sindromës së analfabetit funksional, a mos vallë kemi nevojë për urdhrat e tyre sesi nuk duhet qortuar mësuesin tonë prej shqiptari pse ai nuk bën kujdes me nxënësit për drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin..., pavarësisht se nuk është gjuhëtar dhe pavarësisht se është mësues!

Miku im i dashur! Pa më thuaj a mos vallë nuk të ka ikur fiqiri te pushteti gjyqësor për të parë se në ç’derexhe është katandisur!

A mos vallë nuk të duket se në kërthizë të gjyqësorit ka vënë bythën LUGATI!..., a mos vallë gjyqësori “nuk të duket si ai varri i hapur” ku duken eshtrat e ushtarit të panjohur, i cili dikur moti ra “shehit” a dëshmor për çlirimin e tokave të huaja..., ky gjyqësori, a nuk të duket njësoj si ajo tava e ndryshkur dhe e palarë e shtëpiakes prej dembeli, a nuk të duket si ajo banda frymore që detyrohet t’i bindet verbërisht diktatit të dirigjentit intrigant..., a nuk dëgjove se ç’dënim iu dha vrasësit të Almirit të vogël 4 vjeç, a nuk kishin të drejtë prindërit e tij të thonë: “Kjo nuk është drejtësia që ne duam për Almirin tonë”.

A mos vallë sopotasit me në krye plakun NN, nuk kanë të drejtë të thonë: “Kjo nuk është drejtësia që duam”..., nëse kjo drejtësi është drejtësi, atëherë pse mbyllën gojën karshi dhënies së dëmshpërblimit! Vëllaçko! Nëse e teprova, më fal.

Burrështetasi amerikan, Benxhamin Franklin, shumë kohë më parë kishte thënë: “Te vetmet gjëra të sigurta në këtë botë janë taksat dhe vdekja!”.

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS

Koha
Epërditshme informative
www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:“Adria Media Ballkan” - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 27 shtator | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Redaktor përgjegjës: **Emin AZEMI** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Angela Merkel në fund

Nga
Ines POHL

Një ndryshim personeli të martën tregoi se kancelarja gjermane, Angela Merkel nuk organizon dot më mazhoranca as brenda radhëve të saj. Rrezik për fund të shpejtë të kësaj qeverie

Kryetarët e grupeve parlamentare quhen të suksesshëm atëherë, kur opinioni nuk merret shumë me punën e tyre. Në sistemin partiak gjerman, ata janë përgjegjës për t'i organizuar kreut të partisë mazhorancat e deputetëve të partisë së vet. Nëse kryetarja apo kryetari i partisë është edhe kancelare apo kancelar, atëherë ata kujdesen, që këta ta bëjnë punën e tyre pa shumë zhurmë. Teorikisht.

Por çështja është se aktualisht në qeverinë gjermane asgjë nuk zhvillohet pa zhurmë. Edhe negociatat për krijimin e qeverisë u shoqëruan nga intrigat, dorëheqjet dhe rreziku i përhershëm i zgjedhjeve të reja. E gati në të njëjtën ditë, një vit pas zgjedhjeve të Bundestagut, duket se është vetëm çështje kohe shpërbërja e koalicionit dhe Gjermania do të fillojë sërish të kërkojë një qeveri të re.

REVOLUCION NË PALLAT

Jo vetëm pse partitë qeverisëse grinden me njëra-tjetrën si në pazar duke e humbur besueshmërinë tek popullata me luftërat për pushtet. Tani Angela Merkelit i ka ikur nga dora edhe mazhoranca në radhët e veta. Moszgjedhja e të besuarit të saj prej vitesh dhe kryetarit të fraksionit, Volker Kauder është një revolucion në pallat, që mund të përfundojë në një skenar: Zgjedhje të reja pa Angela Merkelin, që për 13 vjet përcaktoi fatet e Gjermanisë dhe Europës. Fakti që zgjedhja e politikanit gati të panjohur, Ralph Brinkaus u bë e njohur pikërisht në atë moment, kur Donald Trump sërish e sulmoi verbalisht Gjermaninë hedh një dritë të çuditshme mbi Gjermaninë si fuqinë më të madhe ekonomike europiane. Shumë deputetë të parlamentit aktual gjerman duket se nuk e kanë kuptuar ende seriozitetin e momentit. Ata u zgjodhën nga qytetaret e qytetarët e këtij vendi për t'u angazhuar për të mirën e Gjermanisë.

Dhe jo për ta pezulluar me javë qeverisjen, për t'u grindur për vogëlsira, për personelin e me këtë duke ndihmuar vetëm të forcohet AfD.

ÇMONTIM I PERSONALITETIT TË VETËM TË BESUESHËM

Nga dita e parë, kësaj qeverie i mungonte një projekt i përbashkët politik, sidomos personalitete aktive, që kanë dimensionin e drejtimit të Gjermanisë në kohë të vështira. Personaliteti i vetëm i i besueshëm ishte Angela Merkel, deri në të martën historike (25.09) e cila e mbulonte dhe tejkalonte përçarjen e thellë në koalicionin qeveritar dhe në radhët e veta. Kjo tani ka marrë fund. Deputetët e CDU dhe CSU-së nuk refuzuan vetëm Volker Kauderin, si kryetar grupi parlamentar të CDU/CSU-së. Ata e denigruan publikisht kancelaren në këto kohë ta pasigurta. Me këtë tani çështja nuk shtrohet më, se a po vjen fundi i Angela Merkelit, por se sa shpejt do të vijë ai. Një zhvillim që meriton vëmendje! Jo vetëm, sepse po gëzohen AfD dhe Donald Trump gëzohen.

(DW)

Ndarja e Kosovës, nënshtrimi para një ideje raciste

Nga
Andi BUSHATI

Si Serbia dhe si Kosova, janë shtete që së paku publikisht kanë si busull në politikën e jashtme anëtarësimin një ditë në BE. Pra pranimin në një familje që e ka lënë pas krahëve ekzaltimin e idesë të shteteve etnikisht të pastra për të përqafuar të tjera vlera

Një nga argumentet e fortë të atyre që predikojnë zgjidhjen e ndryshimit të kufijve është edhe «fati» i popullsive që banojnë në mizerie, në margjina të dy shteteve, pra serbëve të veriut në Kosovë dhe shqiptarëve të Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës. Si mund të lejohen ata të jetojnë në atë gjendje? Si mund të vazhdojnë të jenë qytetarë të dy shteteve që nuk i duan? Si mund të mbeten ata njerëz pengje të një konflikti që ka ngrirë prej dy dekadash? - është thelbi i përgjërimit të tyre.

Si ilaç për këtë, ata propozojnë shkëmbimin e territoreve, lëvizjet e popullsive dhe shëmtinë e një spastrimi etnik pa luftë. Sepse kjo është në fakt ajo që do të ndodhë. Po të lexohej me vëmendje një speciale e gjatë që gazeta franceze "Le Monde" i kishte kushtuar kësaj teme, aty dallohen lehtësisht simptomat e asaj që pritet të ngjajë. Le Monde publikon planin. "Serbia ne na konsideron si të huaj, pse duhet të qëndrojmë në një vend që nuk na do?", i pohonte gazetarëve të "Le Monde" Shaip Kamberi, kryebashkiaku i Bujanovcit. "Nëse ndryshohen kufinjtë Graçanica do të zbrazet", paralajmëronte Zivojin Rakoceviç, i cili thoshte: "Kjo do të sjellë padyshim një spastrim etnik".

Nuk ka dyshim se nëse kjo gjë arrihet një ditë, Kosova pothuajse do të shpopullohej nga Serbët dhe po ashtu edhe Serbia, nga ata pak shqiptarë që kanë mbetur. Pra formula magjike e atyre që mbështesin idenë e Thaçit dhe Vuçiçit barabitet me lumturinë që arrihet duke jetuar brenda kufijve të kombit tënd.

Kjo zgjidhje etnikisht e pastër, sipas tyre, nuk do të lehtësonte vetëm fatet e disa mijëra vetëve që jetojnë në zonat kufitare. Ajo do të na dhuronte një paqe afatgjatë, një njohje reciproke, dhe në mos çmime Nobel për arkitektët e marrëveshjes, gjithsesi një pozitë më të mirë ndërkombëtare për Kosovën dhe Serbinë. Por vetëm se e gjithë kjo fabul ka një problem. Aspak të vogël. Si Serbia dhe si Kosova, janë shtete që së paku publikisht kanë si busull në politikën e jashtme anëtarësimin një ditë në BE. Pra pranimin në një familje që e ka lënë pas krahëve ekzaltimin e idesë të shteteve etnikisht të pastra për të përqafuar të tjera vlera. Jo më kot, Michael Roth ministri për Europën i një vendi si Gjermania, që ka dalë me shpatë në dorë kundër kësaj marrëzie, deklaronte pak kohë më parë se "e ardhmja e vendeve të Ballkanit Perëndimor është multietnike, multifetare dhe multikulturore".

Të pranosh se nuk e arrin dot këtë objektiv, se nuk je në gjendje të respektosh të drejtat qytetare të pakicave, se nuk përparon dot si shtet pa nxjerrë jashtë "të huajt", se nuk bëhesh funksional po nuk shkove drejt pastërtisë etnike, se nuk je në gjendje të kontrollosh ekseset e politikave nacionaliste në një mjedis multietnik, kjo është para së gjithash një boomerang. Në mënyrë indirekte kjo do të thotë se je një shtet apo një vend, që ndryshe nga sa pretendon, je i papërgatitur kulturalisht për të shkuar drejt BE-së. Madje edhe më keq akoma, të pranosh konceptin se e vetmja zgjidhje për të qenë në paqe, të qetë dhe për të përparuar qënkësh të qenët një komb etnikisht i pastër, do të thotë të biesh në kurthin e mbartësve të ideve raciste që e shohin këtë pjesë të Ballkanit Perëndimor si të paaftë për të absorbuar vlerat e Europës së qytetëruar.

Qoftë edhe për këtë, - përpos faktit se mund të hapë kutinë e Pandorës dhe të shkaktojë një reaksion zinxhir në Ballkan, - ideja e Vuçiçit që ndoshta nga halli e ka përqafuar edhe Hashim Thaçi, është një tezë që duhet kundërshtuar. Sepse ndërkohë që predikon, arritjen e paqes përmes dialogut, ajo rrënon dhe minon bashkëjetesën, sepse ndërkohë që shet një përparim drejt BE, ajo i jep argumente të gjithë atyre që na shohin si të padenjë për të qenë në atë familje, sepse ndërkohë që ekzalton vlerat e kompromisit dhe marrëveshjes, ajo është në fakt simboli i pamundësisë së tyre. Dhe pikërisht për këto, ajo nuk mund të jetë as një premisë për paqe afatgjatë.

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

NGA RUSËT TEK FILISTEJTË DHE BASKËT

20 POPUJT MË MISTERIOZË NË BOTË

Pavarësisht gjithë përpjekjeve dhe vështirësive të historianëve dhe etnografëve, historitë e këtyre popujve ende ruajnë shumë sekrete...

1. Rusët. Po, ata janë misteriozë! Shkencëtarët ende nuk mund të pajtohen për origjinën e tyre dhe t'i përgjigjen pyetjes, se kur rusët u bënë "rusë". Ata nuk e dinë se nga buron vetë kjo fjalë. Prejardhja e rusëve është kërkuar në mesin e Normanëve, Scythianëve dhe Sarmatianëve, Uendëve, dhe madje edhe Usunëve të Siberisë Jugore.

2. Majat. Ne nuk e dimë se nga erdhën këta njerëz dhe ku u zhdukën. Disa shkencëtarë besojnë se ata janë të lidhur me Atlantidën legjendare, të tjerë mendojnë se paraardhësit e tyre ishin egjiptianët. Majat krijuan një sistem efikas bujqësor, dhe kishin njohuri të thella mbi astronominë. Kalendari i tyre përdorej nga popujt e tjerë të Amerikës Qendrore. Majat aplikuan sistemin hieroglifik të të shkruarit, i cili është deshifruar pjesërisht. Qytetërimi i tyre ishte shumë i zhvilluar, por edhe shumë dekadent, në momentin kur mbërritën konkuistadorët. Sot duket se Majat erdhën nga hiçi dhe u zhdukën drejt hiçit.

3. Laplanderët. Enthnos, që quhet edhe Lapps, është të paktën 5000 vjeçar. Shkencëtarët ende kanë mosmarrëveshje mbi origjinën e tyre, disa thonë se ata janë Mongoloidë, të tjerë këmbëngulin se janë paleo-evropianë. Gjuha e tyre besohet se i përket grupit të gjuhëve Fino-Ugrike, por ata kanë dhjetë dialekte të gjuhës Lappish - të ndryshme mjaftueshëm, për t'u quajtur të pavarur. Ndonjëherë ata me zor kuptojnë edhe njëri-tjetrin!

4. Prusianët. Origjina e tyre në vetvete është gjithashtu një mister. Është përmendur së pari në shekullin e IX, në shënimet e një tregtari anonim dhe më vonë në kronikat polake dhe gjermane. Gjuhëtarët gjejnë analogji në gjuhë të ndryshme indo-evropiane dhe besojnë se origjinën e shohin tek sanskritishtja, kur purusa domethënë "njeri". Nuk dihet shumë në lidhje me gjuhën e tyre. Autoktoni i fundit vdiq në vitin 1677, ndërsa murtaja e viteve 1709-1711 vrau prusianët e fundit në vetë Prusinë. Në shekullin XVII filloi historia e Prusianizmit dhe Mbretërisë Prusiane, banorët e të cilës kishin pak gjëra të përbashkëta me prusianët origjinalë baltikë.

5. Kozakët. Prejardhja e tyre është gjithashtu e paqartë. Atdheu i kozakëve mund të jetë në Kaukazin Verior, ose në Detin Azov, ose në perëndim të Turkestanit... Gjenealogjinë e tyre mund të shkojë sërish tek Skithianët, Alanët, Çerkezët, Khazarët, Gotët, apo Brodnikët. Çdo version ka mbështetësit e vet me argumente respektive. Kozakët e sotëm përfaqësojnë një komunitet shumëetnik, por atyre u pëlqen të theksojnë se janë një popull i veçantë.

6. Parsi. Parsi - një grup etnofetar pasuesish të Zoroastrizmit në Azinë Jugore, e kanë origjinën nga Irani. Sot popullsia e tyre arrin në më pak se 130 mijë njerëz. Parsi kanë tempujt e tyre dhe të ashtuquajturat "kullat e heshtjes" për të varrosur të vdekurit (kufomat çukiten nga shpendë grabitqarë). Ata shpesh herë janë krahasuar me çifutët, të cilët gjithashtu ishin të detyruar që të linin atdheun e tyre dhe të cilët ndjekin përpikmërisht kultet e tyre. "Lidhja e Iranit" në Indinë e fillimshekullit XX propagandonte kthimin në shtëpi të Parsive, që ngjante shumë me sionizmin e hebrenjve.

7. Hutsulsët. Është ende e diskutueshme se çfarë kuptimi ka fjala "Hutsul". Disa shkencëtarë mendojnë se etimologjia e fjalës është e lidhur me fjalën moldave "Götz" ose "gutz" ("bandit"), të tjerët besojnë se në origjinë është fjala "kochul" ("bari"). Hutsulsët janë quajtur ndonjëherë malësorë ukrainas. Ata kanë tradita të forta mashtrimi dhe kanë shtrigat e tyre shumë të respektuara, të bardha e të zezë.

8. Hitejtë. Shteti i Hitejve ishte shumë i fuqishëm në hartën gjeopolitike të botës së lashtë. Këta njerëz ishin të parët që krijuan një kushtetutë, që përdornin karroca me kuaj dhe nderonin shqiponjën me dy krerë. Por ne nuk dimë shumë rreth tyre. Ata kishin mbretër, por ne nuk mund të jemi të sigurt se kur, me saktësi. Kronologjia nga Hitejtë është e njohur nga burimet e fqinjëve të tyre, por kjo nuk i përgjigjet pyetjeve se ku u zhdukën. Një shkencëtar gjerman, Johann Lehmann ka shkruar në librin e tij që ata ishin zhvendosur në veri dhe u asimiluan prej fiseve gjermanike. Por ky është thjeshtë një tjetër version.

9. Sumerët. Duhet të jetë një nga popujt më misteriozë në botën e lashtë. Ne nuk dimë asgjë për origjinën dhe gjuhën e tyre. Një numër i madh i homonimesh lejon të supozojmë se ajo ishte një gjuhë politonike (si gjuha kineze moderne), kjo do të thotë se kuptimi i asaj që thuhej, varej nga toni. Sumerët ishin mjaft të avancuar - u bënë të parët në Lindjen e Afërt që përdorën një rrotë, krijuan një sistem të ujitjes dhe shkrimin e tyre të veçantë. Përveç këtyre, ata ishin mbresëlënës në matematikë dhe astronomi.

10. Etruskët. Ata erdhën në histori në mënyrë të beftë, ashtu sikurse dhe u zhdukën. Arkeologët bien dakord që ata jetonin në veriperëndim të gadishullit Apenin dhe krijuan një qytetërim tepër të zhvilluar atje. Ata themeluan qytetet e para italiane dhe ndoshta numrat romakë janë meritë e tyre. Ata ndoshta mund të jenë rivendosur në lindje dhe kanë qenë themeluesit e etnosit sllav. Gjuha e tyre ka shumë të përbashkëta me ato sllave. Të paktën kështu thotë një nga versionet.

11. Armenët. Origjina e armenëve është një mister gjithashtu. Ka shumë versione. Disa shkencëtarë i lidhin armenët me popullin e shtetit të lashtë Urartu, por komponenti gjenetik i Urartianëve është i pranishëm në kodin armen, ashtu si edhe komponentë gjenetikë të Hurrianëve dhe libianëve, për të mos përmendur proto-armenët. Versione grekë të origjinës ekzistojnë gjithashtu, sipas "Hipotezës së Hajasas"(teoria sipas së cilës shteti Hajasa është atdheu i armenëve). Shumica e shkencëtarëve këmbëngulin tek migrimi i përzierë, si hipotezë për etnogjeninë armene.

12. Ciganët. Sipas hulumtimeve gjuhësore dhe gjenetike, paraardhësit e ciganëve u larguan nga territori i Indisë në sasi që nuk tejkalonte 1000 njerëz. Sot ka rreth 10 milion ciganë në botë. Në mesjetë evropianët besonin se ciganët ishin egjiptianët. Fjala "evgjit" në vetvete është një derivat nga "egjiptian". Letrat tarot, konsideruar copëza e fundit e kultit të perëndisë egjiptiane Thoth, u sollën në Evropë nga romët. Ata jo më kot quheshin "Fisi i Faraonit". Evropianët tronditeshin prej traditës cigane të balsamosjes së të vdekurve dhe varrosjes në krip-

Atdheu i kozakëve mund të jetë në Kaukazin Verior, ose në Detin Azov, ose në perëndim të Turkestanit... Gjenealogjinë e tyre mund të shkojë sërish tek Skithianët, Alanët, Çerkezët, Khazarët, Gotët, apo Brodnikët. Çdo version ka mbështetësit e vet me argumente respektive

te, me çdo gjë që mund të kërkonte një jetë tjetër. Kjo traditë e tyre është ende gjallë.

13. Hebrenjtë. Një nga kombet më misterioze! Vetë ideja e hebrenjve, ka qenë më shumë kulturore se sa etnike. Është konsideruar se hebrenjtë janë krijuar nga Judaizmi, jo e kundërta. Ka shumë mistere të lidhur me hebrenjtë. Në fund të shekullit të VIII B.C. 5/6 (10 nga 12 të të gjitha racave) e hebrenjve u zhdukën. Ku? Kjo është një pyetje e madhe! Ka një version, që Skithianët dhe Cimerianët ishin paraardhësit e finlandezëve, francezëve, belgëve, holandezëve, irlandezëve, uellsianëve - pothuajse të gjithë popujt e Evropës ...

14. Guankët. Guankët janë banorë vendës të ishujve Kanarie. Nuk dihet se si ata arritën në ishujt e Tenerifes - nuk kishin patur flotë, nuk dinin asgjë për lundrimin. Lloji i tyre antropologjik nuk korrespondon me rajonin ku ata jetonin. Shumë mosmarrëveshje janë shkaktuar nga piramidat drejtkëndëshe në Tenerife - atu u ngjajnë piramidave të Majave dhe Aztekëve në Meksikë. Askush nuk e di kur dhe pse ato janë ngritur.

15. Khazarët. Ajo që ne dimë për Khazarët është thënë nga fqinjët e tyre. Ata vetë nuk kanë lënë praktikisht asgjë. Shfaqja e tyre ishte e papritur, ashtu si edhe zhdukja. Historianët ende nuk kanë informacione të mjaftueshme në lidhje me Khazarian dhe gjuhën e folur nga ana e Khazarëve. Shumë versione, por nuk ka qartësi.

16. Baskët. Mosha, origjina dhe gjuha e baskëve janë një mister i historisë moderne. Gjuha baske, Euskara, besohet të jetë e vetmja gjuhë e mbetur para-indoevropiane që nuk i përket ndonjë grupi të gjuhëve që ekziston sot. Sipas hulumtimit të National Geographic bërë në vitin 2012 të gjithë baskët kanë një grup të gjeneve që janë shumë e shumë të ndryshme nga ato të popujve të tjerë rreth tyre.

17. Kaldeasit. Kaldeasit jetuan në fund të mijëvjeçarit II - fillim të mijëvjeçarit I para Krishtit në Mesopotaminë Jugore dhe Qendrore. Në 626-538 para Krishtit, një dinasti e Kaldeasve sundojnë Babiloni, ku themeloi Perandorinë Neo-Babilonase. Kaldeasit janë ende të lidhur me magjinë dhe astrologjinë. Në Greqi dhe Romën e lashtë priftërinjtë paganë dhe astrologët babilonas thirreshin Kaldeas. Ata parashikuan të ardhmen për Aleksandrin e Madh dhe pasardhësit e tij.

18. Sarmatianët. Herodoti i quante "kokë-pangolinë", M. Lomonosov besonte se ishin paraardhësit e sllavëve, fisnikët polakë mendonin se ishin pasardhësit e tyre të drejtpërdrejtë. Sarmatianët lanë shumë e sekrete. Ndoshta ata kishin matriarkat, disa shkencëtarë supozojnë se kokoshnika ruse u shpik nga Sarmatianët. Këta njerëz kishin një traditë të deformimit artificial të kafkës, që bëri që njerëzit të kishin koka në formë veze.

19. Kallashët. Popull i vogël që jeton në veri të Pakistanit, në malet Hindu Kush. Janë ndoshta populli më i bardhë i Azisë. Mosmarrëveshjet për ta nuk janë ndaluar asnjëherë. Vetë kallashët këmbëngulin se kanë lidhje me Aleksandrin e Madh. Gjuha e tyre është atipike nga pikëpamja e fonologjisë, ka një strukturë bazë të sanskritishtes. Pavarësisht përpjekjeve për islamizim, shumë prej kallashëve i përmbahen politeizmit.

20. Filistejtë. Ideja moderne e "Palestinës" e ka origjinën nga Filistia. Filistejtë janë popujt më misteriozë që përmenden në Bibël. Vetëm ata dhe Hitejtë e njihnin teknologjinë e prodhimit të çelikut dhe shënuan fillimin e EPokës së Hekurit. Sipas Biblës, filistejtë e kanë origjinën nga Ishulli i Kretës, ndonëse disa historianë i lidhin filistejtë me pellazgët. Origjina kretane e filistejve konfirmohet nga dorëshkrimet egjiptiane dhe zbulimet arkeologjike.

Nuk dihet se ku u zhdukën, me shumë gjasa u asimiluan prej popujve të Mesdheut Lindor.

KATËR PROVERBA ARABE QË DUHET TË NA BËJNË TË GJITHËVE TË REFLEKTOJMË

Proverbat arabe kanë gjithmonë diçka për të mësuar, ose nxisin reflektime të cilat vlen të analizohen në thellësi. Vlen të analizohen, si për shkak të influencës që kjo kulturë ka patur në histori, ashtu edhe për shkak se janë burim i pasur mësimesh të vyera. Mbani shënim dhe mos i harroni këto proverba arabe, në jetën tuaj të përditshme.

1. "Mos hapni gojë, nëse nuk jeni të sigurt se ajo që do të thoni, është më e mirë se sa heshtja juaj"

Na ndodh shumë herë që të pendohemi thellë, menjëherë pasi kemi thënë diçka. Nuk ka as nevojë për të ndjerë dëshirën e fortë për t'i bërë keq tjetrit. Shpesh herë bëjmë një koment pak të pëlqyeshëm, apo mjaftueshëm të keq, pa e filtruar më parë me zemër. Duhet që gjithmonë t'i filtrojmë komentet përmes zemrës sonë, sepse është ajo që do të na thotë nëse është një mesazh i dobishëm për atë që i drejtohet. Edhe pse nuk është e shëndetshme të mbajmë brenda pakënaqësi, nuk është më mirë që të mos frenohemi për të thënë gjëra që i lëndojnë të tjerët.

2. "Herën e parë që më fyen, është faji yt, herën e dytë është faji im"

Ky është një prej proverbave arabe që nuk duhet harruar asnjëherë, kur bëhet fjalë për marrëdhënie sentimentale. E vërtetë që në marrëdhëniet në çift nuk ka asgjë të shkruar dhe se gjithsecili duhet të marrë vendimet e veta. Megjithatë, nëse për shembull keni qenë viktima të mosbesnikërisë nga ana e partnerit, dhe vazhdoni ta falni dhe pranoni çdo herë, tashmë është faji juaj. Mesazhi që u jepni të tjerëve kur falni një tradhti, është se nuk vlerësoni veten. Nëse nuk jeni në gjendje të vlerësoni se sa vleni dhe cili është vendi juaj në botë, si mund të pretendoni që ta bëjnë të tjerët? Nuk do të thotë që nuk duhet të falni kurrë, sepse edhe ky gjest është i domosdoshëm për të ecur përpara. Megjithatë, është e domosdoshme edhe të dish të vësh kufij. Kur të tjerë shfaqin mungesë respekti kundrejt jush, gjëja më e mirë është të largoheni. Që ata të marrin atë që kanë nevojë, pa ju lënduar ju.

Është e sigurt që këto proverba arabe do të jenë të dobishme për të përballur sfidat e përditshme. Ndoshta i keni dëgjuar tashmë, por gjasat janë që jo gjithmonë i keni vënë në zbatim. Provojeni

3. "Një burrë që nuk buzëqesh, nuk duhet të hapë një dyqan"

Të gjithë duhet të ndjekin rrugët dhe ëndrrat e tyre dhe kjo është një nga proverbat arabe, që e shpreh më mirë këtë koncept. Ajo që kërkon të na thotë, është se duhet të bëjmë gjithmonë diçka që na sjell buzëqeshje në fytyrë. Jeta e përditshme do të jetë gjithmonë më emocionuese, nëse bëjmë atë që duam dhe nëse e duam atë që bëjmë. Natyrisht që do të kemi vështirësi. Por kapërcimi i tyre është shumë më i thjeshtë kur e duam vërtetë atë që po bëjmë. Nuk ka asgjë më të keqe se të kesh gjithmonë të bësh me dikë, që ka një shprehje të zymtë në fytyrë. Mos u bëni një prej këtyre tipave.

4. "Ndëshkoji ata që të kanë zili, duke u bërë mirë"

Në jetë do të kemi gjithmonë të bëjmë me njerëz që janë më se të prirur të na bëjnë keq. Në shumicën e rasteve, kjo ndodh prej faktit që ndjejnë zili për një prej tipareve tona, e si pasojë përpiqen të na sabotojnë emocionalisht. Është normale të ndihemi të prirur që të zemërohemi e t'ua kthejmë me të njëjtën monedhë. Megjithatë, kjo proverb arabe na kujton një fakt të sigurt: ndëshkimi më i keq për këta tipa është që të sillesh mirë me ta.

Nuk bëhet fjalë që të jemi hipokritë e t'i trajtojmë sikur të jenë miqtë tanë më të mirë. Thjeshtë mirësjellja i lëndon më shumë se çdo gjë tjetër. Nëse në këtë moment keni të bëni me një person toksik dhe përpiqeni ta shmangni me çdo kusht, provoni të jeni të mirësjellshëm. Do të shihni që do të zhduket nga jeta juaj kaq shpejt, saqë as nuk do e vini re. Dhe kujdes, bëhet fjalë të jeni të mirësjellshëm, jo të viheni në dispozicion të tyre. Nëse ju kërkojnë të bëni diçka që nuk doni, apo nuk mundeni ta bëni, thjesht thoni JO. Është e sigurt që këto proverba arabe do të jenë të dobishme për të përballur sfidat e përditshme. Ndoshta i keni dëgjuar tashmë, por gjasat janë që jo gjithmonë i keni vënë në zbatim. Provojeni.

Investimet kineze në vendet e Ballkanit Perëndimor po rriten nga viti në vit. Kritikët flasin për rrezikun e ndikimit politik të Pekinit. Por askush nuk thotë, se ku qëndron ky rrezik

KINA HYN NË BALLKAN, PO A PËRBËN RREZIK?

Kur në mediat perëndimore flitet për nevojën e një integrimi në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor, thirren në kujtesë rregullisht rreziqe të ndryshme. Të gjitha këto vende filluar me Maqedoninë në Lindje e Serbinë në veri, Bosnje-Hercegovinën, Kosovën, etj perceptohen si burimi i problemeve. Në të njëjtën kohë, Ballkani Perëndimor shihet edhe si skena e përplasjeve gjeostrategjike të të ashtuquajturve "global player" lojtarët globalë. Tek fuqitë tradicionale, BE apo Rusi është shtuar vitet e fundit edhe Kina, një aktor i angazhuar dhe aktiv. Në rajon kjo fuqi identifikohet me një fuqi aktive. Kina ndjek "interesa gjeostrategjike", kjo është frika e përbashkët, sidomos në Bruksel. Në një kohë që të gjitha rreziqet për paralajmërime mbeten të vagullta, vështirë se dikush e përcakton avantazhin politik konkret të Kinës në angazhimin e saj në Ballkanin Perëndimor.

• Treni i parë direkt i mallrave nga Kina në Vjenë, një tren që përshkon 9800 km në pjesën veriore të Rrugës së Re të Mëndafshit

KINA - NJË KAPITALISTE NË TREGUN BOTËROR

Ndryshe është diagnoza, kur bëhet fjalë për interesat ekonomike të Kinës në rajon. Në vitin 2013, presidenti kinez, Xi Jinping bëri publik strategjinë "one belt-one road" - i njohur si "Rruga e Re e Mëndafshit", që parasheh zhvillimin e disa projekteve infrastrukturore me synim transportimin e shpejtë dhe të lirë të mallrave nga Kina në tregjet e pasura perëndimore. Si një pjesë e rëndësishme në këtë tranzit janë edhe vendet e Europës Juglindore, saqë flitet herë pas here edhe për "Rrugën e Mëndafshit të Ballkanit".

Investimi i parë i madh në këtë drejtim u krye në Greqi. Në vitin 2009, COSCO, koncerni i madh kinez i anijeve dhe porteve investoi në portin e Pireut më shumë se 250 milionë euro, më vonë edhe 650 milionë të tjera për të siguruar shumicën e aksioneve në këtë port. Investimi më i suksesshëm, sepse sot Pireu renditet ndër 10 portet më aktive në Europë.

PROGRAM KONIUNKTUROR KINEZ

Ndërkohë firmat kineze investojnë në të gjitha vendet e Europës Juglindore në shuma miliardash dyshifrore. Duhen dalluar investimet direkte nga dhënia e kredive të leverdisshme, thotë Jens Bastian, analist i ekonomisë i pavarur dhe një nga njohësit më të mirë të investimeve kineze në Europnë Juglindore. "Me përjashtim të Greqisë dhe Serbisë, në të gjitha vendet e tjera bëhet fjalë për kredi me leverdi për qeveritë përkatëse."

Dhënia e këtyre kredive është e lidhur me kushte që krijojnë një "qark të mbyllur kreditimi". Bankat kineze e japin kredinë me kushtin që porositë t'i marrin firmat kineze. Ata sjellin punëtorë dhe materiale nga Kina për të ndërtuar një urë apo një autostradë si në Mal të Zi, Bosnje-Hercegovinë dhe Kroaci. "Ky është një lloj programi koniunkturor për ekonominë kineze që ka mbikapacitete", thotë Bastian.

QËLLIMI: TREGJET PERËNDIMORE

Interesat ekonomike kineze janë të qarta: Tregjet perëndimore. Në këtë kontekst vendet e Ballkanit Perëndimor marin rolin e një "porte që duhet hapur për të hyrë në Europë", sipas Bastian. Prandaj investohet në infrastrukturë, rrugë, ura, hekurudha, porte. Por vëllimi i këtyre investimeve nuk është shumë i madh. Jens Bastian thotë se "po të shohësh se sa investime të BE rrjedhin në programe të ndryshme kredish për Bosnje-Hercegovinën, Kosovën, Serbinë, Kroacinë apo Hungarinë, kuptohet se këto janë shuma disa herë më të mëdha se sa ato që do dhe është gati të investojë Kina."

Po aq i madh është edhe dallimi në shumat që investitorët kinezë japin për vendet e Ballkanit krahasuar me ato perëndimore. Firmat kineze kanë interes të madh për teknologjinë e zhvilluar, për këtë ato janë gati të fusin dorën thellë në xhep.

Nëse investimi kinez për portin e Pireut shkoi deri në 1 miliardë euro, vetëm për të blerë prodhuesin gjerman të robotëve, Kuka, në vitin 2016, kinezët ofruan 4,5 miliardë euro. Vetëm në Gjermani kinezët kanë investuar 13,7 miliardë euro, një vlerë rekord. Nga ana tjetër edhe investimet gjermane në Kinë shënojnë rekord. 70 miliardë euro.

KAPITALI KINEZ DHE PERËNDIMI VIGJILENT

Bëhet fjalë pra për investime klasike të kapitalit në një treg global. Të gjithë e investojnë paranë aty ku kanë interes. Dhe të gjithë kanë një synim: Të pozicionohen sa më mirë në tregun global për të shtuar sa më shumë përfitimin. Se ku investohet, në Kinë, në Gjermani apo në Europnjë Juglindore, kjo është e dorës së dytë. E vërteta është se vendet perëndimore më të forta kanë më shumë mundësi për të mbrojtur " sferat sensibël" të ekonomive të tyre. Kështu qeveria gjermane e bllokoi blerjen e prodhuesit të chip-avem Aistron nga investitorët kinezë

Qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë në këtë drejtim një pozicion më të pafavorshëm, sepse ato janë më shumë të varura nga investimet e Kinës, thotë Jens Bastian. "Kina kërkon në këtë rajon ata partnerë ekonomikë që kanë një pozicion të dobët ndërmjetësimi." Kjo i mundëson Pekinit të hapë rrugë të reja transporti me relativisht pak shpenzime, sipas Bastian.

Megjithatë mbetet e paqartë, nëse dhe çfarë agjende politike fshihet pas investimeve kineze. "Kina nuk ka interes, ndryshe nga Rusia, që të nxisë një ndryshim qeverish në këto vende", thotë Bastian. Duket se interesi kinez gjeostrategjik aktual ka vetëm natyrë ekonomike, si një pjesë tranziti për tregjet e pasura perëndimore. E fakti që Kina askujt në këto vende nuk i mban leksione për të drejtat e njeriut apo lirinë e medias më shumë mirëpritet nga qeveritë e disa vendeve të Ballkanit Perëndimor.(DW)

Liberalizimi i vizave , BE skanoi sundimin e ligjit

Grupi Punues për Vizat (COWEB) i Këshillit të Bashkimit Evropian ka qëndruar të martën dhe të mërkurën në Kosovë dhe ka vëzhguar nga afër progresin e institucioneve kosovare në sundimin e ligjit dhe të çështjeve të tjera që lidhen me liberalizimin e vizave, shkruan "Zëri".

Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, pas takimit të përbashkët me anëtarët e këtij grupi ka thënë se ajo e ka informuar delegacionin për angazhimet e deritashme për liberalizimin e vizave, si dhe për hapat e mëtejmë për këtë proces.

"Ne me përkushtim të plotë kemi kryer detyrat tona sa i takon liberalizimit të vizave, duke vënë prioritet nacional edhe procesin integrues", ka theksuar ministrja Hoxha, duke shtuar se pret që këtë vit të merret vendimi për lëvizjen e lirë të kosovarëve, shkruan më tutje "Zëri".

Në anën tjetër, zëvendëskryeministri i Kosovës Enver Hoxhaj ka thënë se opozita kosovare i ka thënë jo liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Në një postim në "Facebook", pas takimit me Grupin Punues nga Bashkimi Evropian, Hoxhaj ka thënë se sjellja e përfaqësuesve të opozitës ka qenë për keqardhje.

"Opozita sot hapur ka dalë kundër liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Është për keqardhje sjellja e përfaqësuesve të disa partive opozitare në takimin me diplomatët e shteteve anëtare (COWEB) që po e vizitojnë Kosovën për herë të parë. Liberalizimi i vizave nënkupton liri udhëtimi për të gjithë qytetarët e Kosovës, duke përfshirë edhe anëtarët e opozitës. Lajmi i mirë nuk do të vonojë me gjithë agjendat dashakeqëse të një pjese të politikës në Kosovë", ka shkruar Hoxhaj

MERKELI PA SHUMICË

PESË MUNDËSI SI MUND TË SHKOJNË PUNËT

Në plan ndërkombëtar Merkeli vazhdon të respektohet fort dhe të nderohet, por dobësia në Gjermani regjistrohet. Kësaj i shtohet që koalicioni i ri mund të kufizonte edhe hapësirën e saj të veprimit në politikën botërore

Angela Merkelit iu desh të pranojë një disfatë të hidhur. Grupi Parlamentar unionist e rrëzoi nga kreu kandidatin e Kancelares. Çfarë do të thotë kjo për qeverinë Merkel?

1. EDHE MË TEJ NJËSOJ - MERKELI QEVERIS SIKUR TË MOS KISH NDODHUR GJË

Angela Merkeli mund t'i besonte fjalët që tha kryetari i ri i Grupit Parlamentar unionist, Ralph Brinkhaus. Pas zgjedhjes së tij të papritur Brinkhaus tha: "Midis kancelares dhe meje nuk mund të fusësh as një fije letër". Edhe shumë mbështetës të Brinkhausit thanë se vërtet duan një ndryshim, por nuk i vënë pikëpyetje qeverisë Merkel. Kancelarja pra mund të bëjë sikur nuk ka ndodhur gjë. Që të mërkurën ajo u takua me Brinkhausin, për të diskutuar për bashkëpunimin konstruktiv. Nëse Merkeli i përpunon temat duke iu përmbajtur ngushtë marrëveshjes së koalicionit dhe për çështjet e kontestueshme i jep Grupit Parlamentar ndjesinë se e dëgjon, Brinkhausi, ashtu si më parë Kauderi mund t'i organizojë asaj shumicat e nevojshme.

2. VOTËBESIMI - MERKELI LUFTON PËR PUSHTETIN E SAJ

Merkeli mori nga Grupi Parlamentar konservator një "jo" për kandidatin e saj të preferuar. Që të mos kesh shumicë te njerëzit e tu, do të thotë të mos kesh shumicë të sigurtë as në parlament. Për të verifikuar nëse koalicioni i madh i CDU/CSU dhe SPD-së e mbështet ende atë, Angela Merkeli mund të kërkojë votëbesimin në parlament. Po të merrte një mbështetje të qartë ajo mund të tregonte: deputetët i kam pas vetes, disfata në Grupin Parlamentar unionist nuk ishte një revolucion anti-Merkel. Po ta humbiste votimin, Presidenti i Gjermanisë mund ta shpërbëjë parlamentin. Epoka e Merkelit do të merrte fund. Në rastin se e fiton votëbesimin, Merkeli mbetet kancelare.

3. GRINDJE NË KOALICION - GRUPI PARLAMENTAR ME BESIM NË VETVETE

Në të kaluarën deputetët e Grupit Parlamentar janë ndierë shpesh si marioneta të Zyrës Kancelarore. Tani ata duan të tregojnë pavarësinë dhe kompetencën e tyre. Me nisma ligjore vetjake dhe me kundërpropozime ndaj qeverisë ata mund të përpiqen të krijojnë profil. Kjo mund të rrezikonte jo vetëm stabilitetin e Kancelares, por edhe paqen e koalicionit me SPD. Volker Kauderi i ka propozuar në të kaluarën koalicionit shpesh kompromise dhe shpesh mendonte edhe për interesat e socialdemokratëve. Po të kërkojë tani Grupi Parlamentar nën Brinkhausin politikë të kulluar konservatore, kjo mund t'i zemërojë socialdemokratët dhe të çojë në fundin e parakohshëm të koalicionit.

4. TËRHEQJE - MERKELI JEP EDHE MË TEPËR PUSHTET

Nëse pas zgjedhjeve që priten në Bavari dhe në Hessen, Merkeli do të ndodhet edhe më shumë nën presion, për shkak të rezultateve eventuale jo të mira të konservatorëve, mund të dëgjohen kërkesa për dorëheqje. Merkeli do të kishte atëherë alternativën që në kongresin e CDU-së në dhjetor në Hamburg të mos kandidojë më për kryetare dhe të hapë rrugën për kryetarë të rinj partie. Pas kësaj ajo ose mund të vazhdojë të qeverisë e dobësuar fort, ose t'i japë fund ushtrimit të detyrës si Kancelare. Në të kaluarën Angela Merkeli ka theksuar herë pas here se e konsideron me vend, kur Kancelarja është edhe kryetare partie.

5. Lame Duck - Hapësira e veprimit të Merkelit në botë rrudhet

Në plan ndërkombëtar Merkelin e kërcënon ai fat, të cilin iu desh ta përjetojnë shumë drejtues shtetesh para saj: statusi i një "lame duck", i një njeriu të pafuqishëm. Një figure pra që është në largim dhe që nuk do të ketë për një kohë të gjatë më pushtet. Me dështimin në votimin e Kauderit është bërë edhe njëherë e qartë se baza e pushtetit të Merkelit lëkundet. Në plan ndërkombëtar Merkeli vazhdon të respektohet fort dhe të nderohet, por dobësia në Gjermani regjistrohet. Kësaj i shtohet që koalicioni i ri mund të kufizonte edhe hapësirën e saj të veprimit në politikën botërore. Në të kaluarën, Kancelarët gjermanë i zgjidhnin punët shumë herë me para. Politikani i ashpër për buxhetin, Brinkhaus mund t'i vërë Merkelit këtu kufij të ngushtë. Për Emmanuel Macronin, Jean-Claude Junckerin ose Tsiprasin ky mund të ishte një lajm i keq./*DW*

Arabia hap hekurudhën më të shpejtë që lidh Mekën dhe Medinën

Arabia Saudite ka përfunduar hekurudhën me një shpejtësi të madhe që lidh dy qytetet e shenjta islamike, Mekën me Medinën. Kjo u bë në përpjekje për të përmisuar bllokimin e trafikut për miliona pelegrinë myslimanë që vizitojnë vendin çdo vit, raporton Al Jazeera. Mbreti Salman ka lançuar 450 kilometrat e hekurudhës me shpejtësi të lartë "Haramain" që lidh dy qytetet nëpërmjet qytetit Jeddah në Detin e Kuq, të martën. Sistemi hekurudhor, i cili ka 35 trena të aftë për të udhëtuar me shpejtësi prej 300 km në orë, gjithashtu do të transportojë udhëtarët e rregullt duke shkurtuar kohën e udhëtimit midis qyteteve të shenjta nga më shumë se pesë orë në dy orë.

Mbretëria po rrit shpenzimet e saj infrastrukturore dhe po zgjeron hekurudhat e saj duke përfshirë një sistem metro prej 22.5 miliardë dollarë që është në ndërtim e sipër në kryeqytetin Riyadh, pasi ai kërkon të diversifikojë ekonominë e saj të varur nga nafta.

Sllovakia arreston të dyshuarit për vrasjen e gazetarit

Policia në Sllovaki arrestoi të dyshuar për vrasjen e një gazetari hulumtues dhe të së fejuarës së tij, shtatë muaj më parë.

Kryeministri sllovak, Peter Pellegrini, tha në një shkrim në Facebook se është është i lumtur për lajmin që "policia ka arrestuar të dyshuarit për vrasjen e dy të rinjve të pafajshëm" dhe tha se hetimi është "prioritet" i qeverisë së tij.

Jan Kuciak është gjetur i vdekur së bashku me Martina Kusnirovan në shtëpinë e tyre pranë kryeqytetit sllovak, Bratisllavë, në muajin shkurt.

Të dy kanë qenë 27 vjeç. Autoritetet kanë thënë se besojnë se vrasja ka pasur të bëjë me punën e Kuciakut si gazetar. Duke cituar burime brenda policisë, ueb-faqja e lajmeve Dennik N raportoi se janë arrestuar tetë persona, përfshirë vrasësin e dyshuar dhe bashkëpunëtorët e dyshuar.

Në mars, kryeministri i atëhershëm i Sllovakisë, Robert Fico ka dhënë dorëheqje, pas trazirave publike dhe protestave në rrugë si shkak i vrasjes së gazetarit dhe të dashurës së tij.

Trump pro zgjidhjes me dy shtete të konfliktit izraelito-palestinez

Presidenti amerikan, Donald Trump, u shpreh të enjten në favor të një zgjidhje me dy shtete të konfliktit izraelito-palestinez, duke u shprehur i bindur se palestinezët do të rikthehen në tavolinën e negociatave.

Gjatë një deklarate në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme vjetore në OKB në Nju-Jork, ai shtoi se "administrata e tij do të jetë në gjendje që të japë një plan paqeje për rajonin në dy, tre ose katër muaj".

Kjo është hera e parë që Donald Trump shprehet në favor të një zgjidhje me dy shtete të konfliktit izraelito-palestine

Në bazë të nenit 156, 157, 158, 159, 160 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 43/12, 145/12, 87/13, 39/14, 43/14, 10/15, 154/15, 192/15, 17/16, dhe 37/16) dhe Pëlqimit për punësim nga Ministria e financave nr. 18-10113/2 të datës 12.09.2018, Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 02-1331/1 të datës 27.09.2018 u. d Drejtori i IPSH Spitali i përgjithshëm Veles publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të 27 realizuesve – punëtor shëndetësor dhe bashkëpunëtor shëndetësor për kohë të pacaktuar

1. IPSH Spitali i përgjithshëm Veles ka nevojë për punësim të profileve në vijim për kohë të pacaktuar:
- 2 (dy) doktorë të medicinës specialistë të gjinekologjisë dhe obstetrikës,
- 1 (një) doktorë të medicinës specialistë të kirurgjisë së përgjithshme,
- 1 (një) doktorë specialistë të kirurgjisë digjestive,
- 1 (një) doktorë të medicinës specialistë të medicinës fizikale,
- 1 (një) doktorë të medicinës specialistë të psikiatrisë,
- 5 (pesë) doktorë të medicinës për dërgim në specializim në specializimet Kirurgjia abdominale, Pediatria spitalore, Gjinekologjia dhe obstetrika, Neurologjia dhe Radiologjia,
-10 (dhjetë) motra medicinale me PMP,
- 2 (dy) akushere me PMP,
- 1 (një) RTG teknolog me PSP,
- 1 (një) laborant me PMP,
- 1 (një) punëtor social dhe
- 1 (një) psikolog klinik.

2. Kandidatët duhet të përmbushin **kushtet e përgjithshme** të parapara me Ligjin për mbrojtje shëndetësore
- Të jetë shtetas i RM,
- Të jetë i moshës së rritur,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore dhe
- Të mos i jetë shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

3. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj nga pika 2 kandidatët për **doktorë të medicinës specialistë të gjinekologjisë dhe obstetrikës** duhet të përmbushin edhe **kushtet e posaçme** në vijim
- Arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – Fakulteti i mjekësisë
- Provim të dhënë profesional
-Certifikatë për provim të dhënë specialistik për gjinekologji dhe obstetrikë
- Licencë për punë
- Me dhe pa përvojë pune.

Orari javor i punës 40 orë dhe neto pagesa bazë për doktorin e medicinës specialistë të gjinekologjisë dhe obstetrikës është 32.977,00 denarë, parashihet punë me ndërrime dhe kujdestari.

4. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj nga pika 2 kandidatët për **doktorë të medicinës specialistë të kirurgjisë së përgjithshme** duhet të përmbushin edhe **kushtet e posaçme** në vijim
- Arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – Fakulteti i mjekësisë
- Provim të dhënë profesional
- Certifikatë për provim të dhënë specialistik për kirurgji të përgjithshme
- Licencë për punë
- Me dhe pa përvojë pune.

Orari javor i punës 40 orë dhe neto pagesa bazë për doktorin e medicinës specialistë të kirurgjisë së përgjithshme është 32.977,00 denarë, parashihet punë me ndërrime dhe kujdestari.

5. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj nga pika 2 kandidatët për **doktorë të medicinës specialistë të kirurgjisë digjestive** duhet të përmbushin edhe **kushtet e posaçme** në vijim
- Arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – Fakulteti i mjekësisë
- Provim të dhënë profesional
- Certifikatë për provim të dhënë specialistik për kirurgji digjestive
- Licencë për punë
- Me dhe pa përvojë pune.

Orari javor i punës 40 orë dhe neto pagesa bazë për doktorin e medicinës specialistë të kirurgjisë digjestive është 32.977,00 denarë, parashihet punë me ndërrime dhe kujdestari.

6. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj nga pika 2 kandidatët për **doktorë të medicinës specialistë të medicinës fizikale** duhet të përmbushin edhe **kushtet e posaçme** në vijim
- Arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – Fakulteti i mjekësisë
- Provim të dhënë profesional
- Certifikatë për provim të dhënë specialistik për medicinë fizikale dhe rehabilitim
- Licencë për punë
- Me dhe pa përvojë pune.

Orari javor i punës 40 orë dhe neto pagesa bazë për doktorin e medicinës specialistë të medicinës fizikale është 32.977,00 denarë, parashihet punë me ndërrime dhe kujdestari

7. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj nga pika 2 kandidatët për **doktorë të medicinës specialistë të psikiatrisë** duhet të përmbushin edhe **kushtet e posaçme** në vijim
- Arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – Fakulteti i mjekësisë
- Provim të dhënë profesional
- Certifikatë për provim të dhënë specialistik për psikiatri
- Licencë për punë
- Me dhe pa përvojë pune.

Orari javor i punës 40 orë dhe neto pagesa bazë për doktorin e medicinës specialistë të psikiatrisë është 32.977,00 denarë, parashihet punë me ndërrime dhe kujdestari

8. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj nga pika 2 kandidatët për **doktorë të medicinës** duhet të përmbushin edhe **kushtet e posaçme** në vijim
- Arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – Fakulteti i mjekësisë
- Provim të dhënë profesional
- Licencë për punë
- Me dhe pa përvojë pune.

Kandidatët për doktorë të medicinës nga ana e IPSH Spitali i përgjithshëm Veles do të dërgohen në specializim në një prej specializimet në vijim: Kirurgjia abdominale, Pediatria spitalore, Gjinekologjia dhe obstetrika, Neurologjia dhe Radiologjia

Orari javor i punës është 40 orë dhe neto pagesa fillestare për Doktor të medicinës është 25.969,00 denarë, janë paraparë puna me ndërrime dhe kujdestaritë

9. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj nga pika 2 kandidatët për **motër mendicinale** duhet të përmbushin edhe **kushtet e posaçme** në vijim
- Shkolla e mesme e medicinës – drejtimi motër medicinale/teknik (PMP – shkalla IV)
- Provim të dhënë profesional
- Me dhe pa përvojë pune.

Orari i plotë i punës – punë me ndërrime neto pagesa fillestare për motër medicinale është 16.440,00 denarë.

10. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj nga pika 2 kandidatët për **akushere me PMP** duhet të përmbushin edhe **kushtet e posaçme** në vijim
- Shkolla e mesme e medicinës – drejtimi akushere (PMP – shkalla IV)
- Provim të dhënë profesional
- Me dhe pa përvojë pune.

Orari i plotë i punës – punë me ndërrime neto pagesa fillestare për motër medicinale është 16.864,00 denarë.

11. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj nga pika 2 kandidatët për **RTG teknolog** duhet të përmbushin edhe **kushtet e posaçme** në vijim
- Arsim sipëror të mbaruar (VII/1) ose 180 kredi sipas SETK – teknolog i diplomuar i radiologjisë
- Provim të dhënë profesional
- Me dhe pa përvojë pune.

Orari i plotë i punës – punë me ndërrime neto pagesa fillestare për RTG teknolog është 22.510,00 denarë.

12. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj nga pika 2 kandidatët për **laborant me PMP** duhet të përmbushin edhe **kushtet e posaçme** në vijim
- Shkolla e mesme e medicinës – drejtimi laborant i medicinës (PMP – shkalla IV)
- Provim të dhënë profesional
- Me dhe pa përvojë pune.

Orari i plotë i punës – punë me ndërrime neto pagesa fillestare për Laborant me PMP është 16.440,00 denarë.

13. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj nga pika 2 kandidatët për **punëtor social** duhet të përmbushin edhe **kushtet e posaçme** në vijim
- Arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar – Fakulteti filozofik – punë dhe politikë sociale
- Me dhe pa përvojë pune.

Orari javor i punës është 40 orë dhe neto pagesa fillestare për punëtorin social është 22.510,00 denarë

14. Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj nga pika 2 kandidatët për **psikolog klinik** duhet të përmbushin edhe **kushtet e posaçme** në vijim
- Arsim sipëror të mbaruar me së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1, VII/2 të mbaruar – Fakulteti filozofik – psikologji – psikologjia klinike
- Me dhe pa përvojë pune.

Orari javor i punës është 40 orë dhe neto pagesa fillestare për psikologun klinik është 23.200,00 denarë

15. Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët për **Doktor të medicinës – specialistë të gjinekologjisë dhe obstetrikës, kirurgjisë së përgjithshme, kirurgjisë digjestive, medicinës fizikale dhe psikiatrisë dhe doktorët të medicinës** obligohen që të parashtrojnë dokumentet në vijim
- Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
- Biografi të shkurtë (CV)
- Diplomë me sukses mesatar
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë për fakultet të mbaruar të medicinës, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Licencë për punë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë për provim të dhënë specialistik (vetëm për **Doktor të medicinës – specialistë të gjinekologjisë dhe obstetrikës, kirurgjisë së përgjithshme, kirurgjisë digjestive, medicinës fizikale dhe psikiatrisë sipas vendit të punës për të cilin është paraqitur kandidati)**

16. Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët për **motër medicinale, akushere, RTG teknolog, laborant i medicinës, punëtor social dhe psikolog klinik,** obligohen që të parashtrojnë dokumentet në vijim
- Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
- Biografi të shkurtë (CV)
-Diplomë me sukses mesatar ose certifikatë/dëftesa për arsim të mbaruar të të gjitha viteve, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter (**për motër medicinale, akushere, laborant medicinal)**
- Diplomë me sukses mesatar për arsim sipëror të mbaruar në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter (**vetëm për RTG teknolog, punëtor social dhe psikolog klinik)**
- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë të mjekut jo më të vjetër se 6 muaj, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
- Certifikatë se nuk është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter
-certifikatë për provim të dhënë profesional, origjinal ose kopje të vërtetuar në noter (**motra mediocinale, akushere, RTG teknolog dhe laborant medicinal)**

17. Afati për paraqitje në shpalljen publike është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit.

18. Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i parregulluar nuk do të merret parasysh nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.

19. Pas selektimit të realizuar të kandidatëve të paraqitur nga pika 3, 4, 5, 6, 7 , 8, 11, 13 dhe 14 të cilët i përmbushin kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 paragrafi 2 i Ligjit për mbrojtje shëndetësore dhe për kandidatët e paraqitur nga pika 9, 10 dhe 12 të cilët i përmbushin kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet pjesa profesionale (test) në pajtim me nenin 160 paragrafi 3 i Ligjit për mbrojtje shëndetësore.

20. Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e tërësishëm të nevojshëm dhe telefoni për kontakt të dorëzohen deri në IPSH Spitali i përgjithshëm Veles rr. Samoborska pn Veles përmes postës ose në arkivin e IPSH Spitali i përgjithshëm Veles, me shenjë për Shpallje publike për punësim.

IPSH Spitali i përgjithshëm Veles

AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

АФПЗРР

www.ipardpa.gov.mk

KORRIGJIMI I THIRRJES PUBLIKE
nr 06/2018
për parashtrim të kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në zhvillim rural për vitin 2018

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural informon të gjitha subjektet e interesuara për parashtrimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në zhvillim rural për vitin 2018, se në Thirrjen publike 06/2018 në tabelën në pjesën I Lëndë e shpalljes, Shuma e përkrahjes për shpenzimet e pranueshme për shfrytëzues, ndryshon dhe është si në vijim:

"**Shuma e e përkrahjes për shpenzimet e pranueshme për shfrytëzues – 1.000.000 denarë"**

Në pjesën III Shuma e përkrahjes financiare, ndryshon dhe është si në vijim:

"Shuma e përkrahjes për shpenzimet e pranueshme për shfrytëzues për të gjitha nënpikat gjithsej është deri në 1.000.000 denarë."

Në pjesën IV Kushtet për shfrytëzim të mjeteve dhe dokumentacioni i cili parashtrohet, sipas Rregullores për kushtet e përafërta plotësuese për përkrahjen nga masat për zhvillim rural, shpenzimet e pranueshme dhe shuma e përkrahjes për shpenzimet e pranueshme për shfrytëzues për masën veç e veç. ("Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 124/11, 80/13, 72/14, 35/16 dhe 59/16), shtohet numër i ri i Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë dhe është si në vijim:

"**Rregullores për kushtet e përafërta plotësuese për përkrahjen nga masat për zhvillim rural, shpenzimet e pranueshme dhe shuma e përkrahjes për shpenzimet e pranueshme për shfrytëzues për masën veç e veç. ("Gazeta zyrtare e R. Maqedonisë" nr. 124/11, 80/13, 72/14, 35/16, 59/16 dhe 178/18)".**

Pjesët tjera të thirrjes publike 06/2018 të publikuar më datë 24.09.2018 mbeten të pandryshueshme dhe përmbajtja e saj e tërësishme mund të gjendet në ueb-faqen e Agjencisë www.ipardpa.gov.mk

Ky korrigjim ka validitet nga dita e publikimit të thirrjes publike që korrigjohet.

Në bazë të nenit 30 të Statutit të IPSH Klinika universitare për sëmundje të syve Shkup, si dhe nenit 156, 157,158, 159, 160,164-a, 164-b dhe 164-v të Ligjit për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e RM" nr. 43/2012, 145/12, 65/13, 87/13, 164/13, 39/14, 43/14, 132/14, 188/14, 10/15, 61/15, 154/15, 192/15, 17/16, 37/16), ud Drejtori i Klinikës publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim për kohë të pacaktuar

IPSH Klinika universitare për sëmundje të syve - Shkup ka nevojë për punësim të:

- 3 (tre) personave – doktor të medicinës për kohë të pacaktuar
- 4 (katër) personave – motër medicinale për kohë të pacaktuar

• 1. Dokumentet e nevojshme për të gjitha vendet e punës janë:
- lutje (me adresë të saktë të banimit dhe telefon), me vërejtje për cilin vend pune konkurron
- biografi të shkurtë (CV)

• Certifikatë të shtetësisë së RM (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
• Dëshmi për aftësi të përgjithshme shëndetësore (të mos jetë më e vjetër se 6 muaj) (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
• Dëshmi se nuk i është shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (të mos jetë më e vjetër se 6 muaj) (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

• Krahas dokumenteve nga pika 1 të shpalljes publike, kandidatët për **doktor të medicinës** duhet të parashtrojnë edhe:
- Dëshmi për fakultet të mbaruar të medicinës në të cilin do të shihet mesatarja e kandidatit. Është e nevojshme që tiketë së paku tetë të suksesit mesatar (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë për provim të dhënë profesional, (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Licencë për punë, (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- dëshmi për njohje të një prej gjuhëve të huaja me dorëzimin e një prej certifikatave të njohura ndërkombëtare ose certifikatave të përdorura ndërkombëtare: BULATS, CAE, IELTS, FCE, BEC, PET, KET, ILEC, TOEFL PBT, TOEFL CBT, TOEFL IBT për gjuhën angleze, gjegjësisht DELF, DALF, TCF, TEF, BULATS për gjuhën frënge, gjegjësisht Gete Certifikatë (Goethe-Zertifikat), TestDaF dhe BULATS për gjuhën gjermane ose certifikatë tjetër të njohur ndërkombëtare të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian ose organizatave të tjera ndërkombëtare të B2 nivelit të Kornizës së përbashkët referuese evropiane për mësim, ligjërim dhe vlerësim të gjuhëve (CEFR). njohja e gjuhës së huaj, përveç se me certifikata të njohura ndërkombëtare ose certifikata të përdorura ndërkombëtarisht, dëshmohet edhe me vërtetim për mbarim të ciklit të parë, të dytë ose të tretë të studimeve në një prej 200 fakulteteve më lartë të radhitura në Shanghai Ranking – ARWU (Academic Ranking of World Universities) të një prej tre gjuhëve më së shpeshti të përdorura të Bashkimit Evropian (angleze, frënge, gjermane), për të cilat studime kandidati posedon diplomë të nostrifikuar (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter) .
- Kandidatët të cilët kanë përfunduar ciklin e parë, të dytë ose të tretë të studimeve nga sfera e shkencave të medicinës në një prej 100 fakulteteve më të mirë të radhitura të Shanghai Ranking-ARWU (AcademikRankinking of World Universities) nuk duhet të përmbushin kushtet e posaçme nga pika 1.1 3 kësaj shpallje, dhe as për punësimin e tyre nuk realizohet procedura e selektimit të kandidatit. (dëshmi për cikël të parë, të dytë ose të tretë të studimeve nga sfera e shkencave medicinale në një prej 100 fakulteteve më lartë të ranguara të Shanghai Ranking-ARWU- origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Dëshmi për përvojën e punës nëse ka (të vërtetuar nga institucioni ku ka realizuar përvojën e punës)

• Krahas dokumenteve nga pika 1 e kësaj shpallje publike, kandidatët për **motër medicinale,** duhet të parashtrojnë edhe:
- dëshmi për arsim të mesëm të mbaruar (SHMM) për motër medicinale edhe atë Dëftesat prej 4 (katër) viteve ku është shënuar suksesi që është arritur në SHMM për secilin vit veç e veç, (në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë për provim të dhënë profesional, (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë për punë me programe kompjuterike për punë në zyrë, (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)

• Afati për paraqitje është 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes.

• Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i parregulluar nuk do të merret parasysh nga ana e komisionit për selektim të kandidatëve.

• Pas selektimit të realizuar të kandidatëve të paraqitur për doktor të medicinës dhe motër medicianle, të cilët i plotësojnë kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 dhe 164-v të Ligjit për mbrojtje shëndetësore.

• Dokumentet parashtrohen në Arkivin e Klinikës ose në adresën, IPSH Klinika universitare për sëmundje të syve – Shkup, rr. "Vodnjanska" nr. 17, Shkup, me shenjë "Për shpallje publike" me vërejtje për cilin vend pune konkurron.

Orari i punës prej 40 orëve në javë.

IPSH KLINIKA UNIVERSITARE
PËR SËMUNDJE TË SYVE SHKUP

Kriza e vetme e Gjermanisë është kriza e birrës

Nuk ka rëndësi se rritja ekonomike është në rekord e po ashtu edhe papunësia, në nivelin më të ulët në histori, pasi Gjermania është në mes të një krize; krizën e birrës. Gjatë dhjetë viteve të fundit, birra gjermane ka vuajtur hegjemoninë e konkurrencës daneze, si Carlsberg apo holandezëve të Heineken.

Këto të dhëna vijnë në ditën e parë të Oktoberfest ku 6 milionë persona parashikohet të konsumojnë rreth 600 milionë euro birra.

Arsyeja kryesore e rënie së birrës bionde gjermane është demografiko-kulturore, shkruan 'Scan'. Popullsia gjermane po plaket dhe 60-vjeçarët pa diskutim që nuk mund të konsumojnë të njëjtat sasi birre me një 40-vjeçar.

Madje edhe këta të fundit nuk janë në nivelet e 40-vjeçarëve të 20 viteve më parë. Pavarësisht kësaj, Gjermania vijon të jetë tregu i pestë në botë për nga konsumi i birrës. Rënia e konsumit të birrës në Gjermani ka filluar që prej vitit 1976. E që prej atëherë, trendi është i pakthyeshëm. Vetëm se së fundmi është bërë shumë më shqetësues si fenomen. Kompanitë që operojnë në sektor së fundmi kanë rritur dozën e shkurtimeve të punonjësve. Arsyeja e dytë e krizës së birrës gjermane është fragmentarizimi i tregut. Në Gjermani ka plot 6000 marka birre.

Edhe po të provosh nga një të ndryshme çdo ditë, do të duheshin 16 vite për t`i provuar të gjitha. Një arsye tjetër është ajo se, simboli i hegjemonisë gjermane dikur, birra, tashmë nuk është më e tillë. Birra gjermane nuk dominon më botën dhe Gjermania ka humbur betejën me Holandën, Belgjikën apo Danimarkën, me armën e saj më të fortë.

BRIGITTE MACRON

NËN BUZËQESHJEN E HESHTUR

Brigitte ishte ajo që inkurajoi Emmanuelin të kandidonte për postin më të lartë, në vitin 2017. "Ajo mishëron një përfaqësim jashtëzakonisht tradicional në rolin e grave", thotë Frédérique Matonti, një shkencëtar politik në Sorbonne që ka botuar një libër mbi seksizmin dhe politikën

Jeta e Brigitte Macron është vërtet shumë e çuditshme. Ajo lindi në vitin 1953 dhe vinte nga një familje që merrej me biznesin e çokollatave. Brigitte ishte më e vogla nga familja e saj, por ndryshe nga vëllai që merrej me biznesin e familjes dhe motra e cila ishte e martuar dhe kujdesej më shumë për bashkëshortin se veten, ajo ishte mësuese në një qytet të Francës, Amiens, dhe i kushtonte më shumë kohë vetes. Brigitte ishte një grua e martuar dhe kishte tre fëmijë, ndërkohë punonte mësuese. Gjatë punës si mësuese ndodhi ndryshimi i madh në jetën e Brigitte, ajo dashurohet me nxënësin e saj, 24 vjet më të vogël. Romanca e tyre për të tjerët ishte tabu, ngjalli censurë familjare, shqetësim për shoqërinë dhe opinion i keq. Por çifti arriti të finalizonte lidhjen e tyre me martesë në vitin 2007.

Burri i saj u zgjodh President i Francës, dhe Brigitte e la karrierën e saj si mësuese, për t'ju përkushtuar më shumë martesës dhe për t'u kujdesur më shumë për bashkëshortin e saj.-informon dritare.net Dhe si Zonjë e Parë, Brigitte, ishte element kryesor për imazhin që shfaqte bashkëshorti si President. Ajo ishte përkrah tij kur ai fitoi fitoren pas votimeve, dhe mbështeti suksesin e tij. Tani gratë e presidentëve janë kthyer në imazh kryesor, edhe në fokusin e popullatës së Francës, por jo vetëm.

Gratë shihen si aset i rëndësishëm gjatë fushatave elektorale, dhe për Brigitte Marcon duket se ka qenë e lehtë t'ja dalë me buzëqeshjen që tregon fytyra e saj e mbuluar nga flokët bionde. "Unë nuk ndihem si një zonjë e parë", tha ajo për revistën "Elle" vitin e kaluar, -"Franca zgjodhi Emmanuelin, jo mua".

Partnerja e Presidentit në njëfarë mënyre është përfaqësuese për Francën, ka përgjegjësi si Zonjë e Parë, duhet të merret me aktivitete bamirëse ose kulturore në shërbim të vendit. Që të dy janë kujdesur për imazhin që kanë në vend. "Unë nuk isha një vajzë shumë e sjellshme", tha Brigitte për "Elle". "Isha shpesh në paraburgim për mosmirënjohje". Fakti që Brigitte ishte rritur në një familje të pasur dhe Emmanueli, bashkëshorti i saj vinte nga një shtresë e ulët, shkaktoi reagime, se martesa e tyre ishte një mashtrim, që mbulonte jetën sekrete të Emmanuelit. Por ai iu kundërpërgjigj të gjithë atyre që mendonin se martesa me një grua 24 vjet më të madhe, mund të ndodhë vetëm nëse je "homoseksual" ose "zhigolo". Macron punësoi një publicist të mirënjohur francez, Mimi Marchand, për të kuruar imazhin e tyre dhe për të bërë kujdes nga paparacët.

Nga fotot e një takimi zyrtar me Presidentin Amerikan Donald Trump, Brigitte i komenton bashkëshortit të saj, "Je në një gjendje shumë të mirë fizike". Me kalimin e viteve, francezët kanë filluar të pranojnë këtë marrëdhënie të pazakontë, madje e respektojnë dhe nuk është tabu për ta. Tani të gjithë kanë filluar ta përqafojnë këtë ndryshim të çuditshëm që ka ndodhur dhe vazhdon të ndodhë, kur më parë as që mendohej. Dëshira për të sfiduar steriotipet ndaj moshës është primare për femrat në një vend si Parisi. Brigitte Macron ka sjellë shembullin më të mirë, për t'u dhënë kurajo dhe vetëbesim grave franceze. Ky shembull ka bërë historinë, ka inspiruar qindra vajza dhe gra nga Franca, por edhe më gjerë.

Brigitte tha: "Jam shumë e lumtur që gratë po flasin". Paradoksi është se, për aq sa Brigitte ka ndihmuar të sfidojë mendimet patriarkale franceze, ajo ka ndryshuar me një qasje tërësisht konvencionale, që nga pamja e saj dhe marrëdhënien që ajo ka me bashkëshortin. Kritikët e konsiderojnë atë si forca lëvizëse, ambicioze që shtyn para bashkëshortit të saj. Në fund të fundit, Brigitte deklaroi se ishte ajo që inkurajoi Emmanuelin të kandidonte për postin më të lartë, në vitin 2017.

"Ajo mishëron një përfaqësim jashtëzakonisht tradicional në rolin e grave", thotë Frédérique Matonti, një shkencëtar politik në Sorbonne që ka botuar një libër mbi seksizmin dhe politikën. Gjysëm shekulli pas kryengritjes së majit në vitin 1968, është parë një rebelim kundër normave konservatore shoqërore që e kanë bërë Francën, vendin e lëvizjes dhe çlirimit të grave. Ekzistojnë akoma vende ku rregullat e diktaturës, po vrasin dhe nuk lejojnë gratë të flasin e të jetojnë të lira, por histori të tilla po sjellin ndryshime shumë të rëndësishme, që nuk tolerojnë të jetojnë sfidat që kanë kaluar gjyshërit dhe stërgjyshërit e tyre, dekada më parë. *(The Ekonomist)*

ENCIKLOPEDIA BUXHOVIANE

RISHIKIM FUNDAMENTAL HISTORIOGRAFIK

Jusuf Buxhovi: "KOSOVA" II, MESJETA. Botoi "Jalifal Publishing"– Houston dhe "Faik Konica"– Prishtinë, 2015 Nga AGRON JAHA



Dy fjalë për veprën në tërësi

Me "Kosova" të profesorit të merituar të Historisë Iliroshqiptare (çdo gjë e arritur këtu vetëm me zgjuarsi, punë vetëmohuese e dritëpërçuese e Genius Ilyrici) - të nderuarit Jusuf Buxhovi, shqiptarët shënojnë fitoren e tyre të parë të madhe bashkëkohore në rrafshin kulturor ndaj falsifikimeve e keqinterpretimeve, anashkalimeve politike e fshehjeve të qëllimta të vërtetës objektive historike të korpusit kulturor ilir, korpus ky që ravijëzoi konturat e lëvizjes progresiste të qytetërimit evropian.

1

Korpusit trashëgues kulturor të Ilirothrakisë paraantike (albanofonisë ilirike), i cili më vonë do të shfaqet në formën e plotë të tij në regjistrat shkrimor historik si iliroromakiumi apo etnoetatizmi gjenealogjik dardano-romak, i kthehen si figuracioni simbolik i heroizmit trojan që nga Eneu, por edhe personalitetet e tij të lartësuara historike, si Konstandini e Justiniani.

Edhe vepra unikate në mbrotje të ilirokristianizmit e shkruar me gjakun e princit më të madh mesjetar evropian, kurorëzon rolin vendimtar për një Evropë me identitet të qartë kristiano-romak të faktorit ambi- dhe polivalent historik - Gjergj Kastriotit.

2

Të bësh një recension të një studimi kaq të thellë, siç është "Mesjeta" e J. Buxhovit, paraqet jo vetëm një obligim kolegial e kombëtar, por dhe një nder personal që më bën autori si dhe një sfidë sui generis (të llojit të veçantë). Për dy arsye:

- Për herë të parë kemi në historiografinë tonë një studim të thellë e të thuktë, por edhe të gjerë e larmishëm nga aspekti burimor, i cili i ofrohet lexuesit shqiptar pa asnjë lloj cenzure a diktati politik. Pra, ashtu siç e kërkon historiografia objektive, e paanshme.

Ndryshe nga vepra enciklopedike e Akademisë së Shkencave në Shqipërinë shtetërore "Historia e Popullit Shqiptar", e cila ende mbetet në binarët klasik të deskripcionit kronologjik, pa pasur impulse inovative në rrafshin shpjegues, Enciklopedia Buxhoviane ka guximin të rishikojë me një dioptri tjetërfare gjithë kompleksin e ndërtesës së deritanishme historiografike, duke hapur kështu rrugë deri më tash të panjohura në letrat historiografike brenda konceptimit dhe studimit sistematik allofil të historisë së Popullit Shqiptar. Së këndejmi do të ishte hap i duhur nga ana e Akademisë së Shkencave në Shqipëri që të bëj një shqyrtim kritik e tërësor të veprës reformative të Buxhovit, të bëj edhe të njohur veprën e tij në Shqipëri dhe të pranoj rezultatet e shënuara aty.

- Problemi tjetër është ai metodologjik. Duhet punë pioniere gjatë recensionit, pra edhe recensenti duhet të jetë kreativ dhe inovativ në qasjen e tij. Me një shkëputje mendore teorike nga metodologjia e deritanishme e konceptimit.

2.a.2 Vështrim holistik nga këndi filozofik-didaktik i veprës, risitë në qasjen metodologjike doktrinare të autorit. Specifika sui generis e studimeve ilire.

Buxhovi, si njohës i shkëlqyer i historikut të studimeve ilire që është, shtron dhe thumbon qysh në fillim të këtij libri me të drejtë dhe me gjuhë kritike-argumentative pozicionimin teorik të historiografisë së shek. të 19-të, e cila anashkalon rolin vendimtar të faktorit iliro-dardan në kuadër të orbis romarum. Nënvizon se brenda kësaj ngrehine shtetërore ata jo vetëm që posedonin me shtetësinë romake, civis romanes (kjo sidomos nga koha e Karakallës) apo romaios (nga koha e Theodeziut pas ndarjes së Perandorisë), por edhe ishin mbrojtësit kryesor të saj. Një status të tillë nuk arritën ta fitojnë popujt invadues në Ballkan e Itali asnjëherë: Gotët, sllavët, avarobullgarët etj.

3

Sllavët do t'ia dalin vetëm aty nga shekujt IX-X të krijojnë organizimet e tyre të para suprafisnore në formë të despotatit (fillimisht në Dioklea dhe më vonë në Rashën dardane), zhupanive apo të vetëshpallura perandori, si ajo bullgare (IX-XI).

Autori në kritikën e tij vazhdimisht ruan ekulibrin e linjës së vëzhguesit objektiv, duke spikatur një mori faktorësh objektiv që edhe faktikisht „larguan" temën dardane nga kronikat me rëndësi të kohës.

Perandoria Lindore Romake ishte e angazhuar sinkronisht në më shumë fronte, kjo pamundësonte objektivisht qartësimin e situatës me popullatat invaduese sllave (ndonëse në burimet romakolindore përmenden atykëtu edhe përpjekje për rivendosjen e sllavëve në drejtim të Azisë së Vogël! Vërejtja nga unë, A.J.), kështu që kishte filluar misionimet e organizuara për kristianizimin e këtyre popullatave.

Qëllimi ishte strategjik, që ata një ditë të i shërbejnë Perandorisë Lindore Romake Nga burimet romakolindore të kohës, sidomos nga vepra epokale e perandorit Konstandin Porfirogjeni „De administrando imperio – Corpus Fontium Historia Byzantine", mësojmë se popullatat sllavofone quheshin me antroponimin kolektiv - teonimin „pagan" apo të pafe. Por, siç do të shohim më vonë, këto struktura, sidomos gjatë dhe pas Kryqëzatave, do të kthehen kundër Perandorisë dhe do të dobësojnë sipas autorit së bashku me kryqtarët nga Perëndimi në mënyrë vendimtare strukturat shtetërore të Perandorisë Lindore Romake

Për shkak të problemeve të vazhdueshme që kishte Perandoria, sidomos me popullatat invaduese, dhe përfshirjes totale ilirodardane në të gjitha strukturat e Perandorisë (romanizimi etatist, Perandorisë Lindore Romake konsiderohej nga iliro-dardanët shteti i tyre, vërejtja nga studimet e mija të fundit mbi raportet shtetësi-etni në Perandorinë Lindore Rormake), ata sipas autorit nuk do të jenë më në qendër të vëmendjes.

Kronikat dhe në përgjithësi burimet shkrimore romako-lindore pas shek. të shtatë, do të tematizojnë problemet dhe vështërsitë e vazhdueshme të Perandorisë në ballfaqimin e saj me këta popuj invadues që nuk jetonin brenda Perandorinë Lindore Romake dhe nuk posedonin statusin e qytetarit romak.

Kjo „zhdukje" e popujve konstitucional nga kronikat romako-lindore (pra, e ilirodardanëve, greqishtfolësve, etj.) ka shërbyer fatkeqësisht edhe për anashkalimet dhe jo rrallë edhe për keqkuptime e qe besa edhe për shtrembërime të qëllimta në analizat dhe deskripcionet e historiografisë moderne nga shumë autorë të huaj e nganjëherë edhe vendor.

Këto shpjegime nga J. Buxhovi, paraqesin risi në këndkundrimin apo specifikën e studimeve ilire. Ato, me apo pa dashje, hapin një çështje shumë delikate, atë të interpretimit të burimeve historike. Qasja metodike, sipas së cilës „histori" është vetëm ajo që na e ofrojnë burimet direkte të shkruara, tregohet si e pamjaftueshme, sidomos në kuadër të analizave të proçeseve me diskontinuitet formal historik.

4

Prandaj, historiografi moderne dhe analitike apo analizë objektive historike, në unison konceptual me profesorin e nderuar Buxhovi, konsideroj jo vetëm punën me burimet historike, por edhe analizat retrospektive kulturore, apo figurativisht lidhjen e pjesëve nga kohë të ndryshme nga i njëjti zingjir tematik dhe kulturor, duke abstrahuar diskontinuitetin letrar dhe pranuar latencën („heshtjen") burimore si kategori historike valide.

Kjo përkon me thënien paradigmatike të autorit J. Buxhovi: „Subjektiviteti historik nuk krijohet vetëm nga pamja e jashtme, por edhe forcat e brendshme lëvizëse", qasje e cila përshkon shtratin argumentues dhe shpjegues të veprës.

Mendoj se këtu autori ka vendosur një guri të rëndë në themelin e ndërtesës së re të qasjes inovative doktrinare në konceptimin e historisë iliro-shqiptare, jo thjesht si një element i rëndësishëm i historisë romake, por si shtylla kurrizore e saj.

VJEN HUMBJA E PARË PËR SHKËNDIJËN

NUK MERITONIM FITOREN

Humbja 2:0 në Tetovë nga Pobeda, e para për Shkëndijën në shtatë xhiro të sezonit të ri në Ligën e Parë të futbollit të Maqedonisë bashkë me publikun ka lënë të dëshpëruar edhe stafin teknik të kuqezinjve

Koha Fisnik NUHIU

Shkup, 27 shtator - Kuqezinjtë pësojnë disfatën e parë në sezonin e ri në LPFM pasi munden 2:0 nga Pobeda në takimin e xhiros së shtatë. Edhe pse skuadra dukej në moment pozitiv me seri prej katër fitoreve të njëpasnjëshme në kampionat, mosefikasiteti para portës kundërshtare kushtoi humbje pasi ekipi nga Prilepi shënoi dy gola më pjesën e dytë. Shkëndija dominoi në pjesën e parë dhe humbi disa mundësi shënimi, ndërsa në vazhdim kur hodhi gjithçka në sulm në kërkim të golit kundërshtari shfrytëzoi hapësirat dhe ndëshkoi ashpër. Kirian Nabueze në minutën e 61 dhe Tanushev katër minuta para fundit ishin autor të golave për Pobedën e cila doli me tre pikë nga kjo përballje. Trajneri Osmani pranon se ekipi nuk ishte në nivel dhe në raport me performansën humbja ishte e pashmangshme. "Humbja si humbje sigurisht se dhemb, por konstatimi im dhe i stafit teknik është se me lojën që treguam sot nuk është se merituam rezultat tjetër. Që në pjesën e parë u vërejt se na mungoi ideja për të depërtuar drejt portës së Pobedës. Mungoi lëvizja e duhur para portës, ajo lëvizja pa top që na krijon ide dhe na jep kreativitet. Ky ishte problemi që solli humbjen", deklaroi trajneri Qatip Osmani. Për trajnerin Osmanin nuk do të ketë ndalesë, ai sëbashku me lojtarët e tij do të vazhdon me punë për të gjetur rrugën e kthimit. "Tani ndoshta na pret puna më e vështirë për të gjetur mënyrë të kthehemi në rrugën e duhur. Por besoj se Shkëndija ka mjaft lojtarë cilësorë dhe me përvojë që dinë të ballafaqohen me situata të krizës pas një disfate të këtillë", përfundoi Osmani. Në përballjet tjera të zhvilluara në stadiumin "Mladost" në Strumicë, Bellasica mundi me 1-0 skuadrën e Shkupit, falë realizimit të Baldovalievit në minutën e 7. Akademia Pandevi pësoi disfatë 0-2 nga Renova dhe u largua nga pozita e parë. Mjaftuan golat e Stojanovskit, në secilën pjesë të takimit, për të sjellë 3 pikë të mëdha për skuadrën nga Xhepçishti. Skuadra e Vardarit është lider i ri në futbollin vendor, pasi shfrytëzojë gabimet e skuadrave kundërshtare të kreut të tabelës. Në stadiumin "Boris Trajkovski" në Shkup, skuadra kuqezi mundi Sileksin nga Kratovë, falë golit të shënuar nga braziliani Xhufo. Makedonija Gjorçe Petrov regjistroi fitoren e parë në këtë sezon, duke shfrytëzuar formën e dobët të Rabotniçkit dhe arriti të triumfojë me 3-0. Stojçevski hapi rezultatin, para se Kirovski dhe Bozhinovski të vulosin fitoren e skuadrës nga Gjorçe Petrovi.

Në Maqedoni mbahet kampionati botëror në mundje për veteranë

Shkup, 27 shtator - Gjatë fundjavë nën organizimin e Federatës së Mundjes së Maqedonisë dhe në ndihmë të Agjencionit për Rini dhe Sport në qytetin e Shkupit, në sallën sportive Boris Trajkovski do të mbahet kampionati botëror në mundje për veteran. Në këtë kampionat janë paraqitur mundës nga 30 shtete ndërsa pritet të marrin pjesë mbi 300 garues. Republika e Maqedonisë ka organizuar shumë evenimente sportive dhe përvoja e mirë në organizimin e tyre është një garanci që ku eveniment të mbahet në nivelin më të mirë të mundshëm. "Është nder dhe kënaqësi që për herë të parë në Maqedoni organizohet kampionati botëror në mundje për veteran. Këtë vit kishim dy organizime ku patëm kampionatin evropian tani edhe kampionatin botëror. Organizimi i mirë bëri që të na jepet mundësia të organizojmë edhe këtë eveniment të madh botëror për veteran. Në emër tim falënderoj të gjithë nga Federata e mundjes në Maqedoni që u bashkëngjitën në organizimin tonë. Po ashtu falënderoj drejtorin të Agjencisë për Rini dhe Sport të cilët gjithmonë na ndihmuan ti kalojmë këto sfida pa problem dhe të jemi organizator. Dëshiroj ti bëj ftesë të gjithë dashamirëve të mundjes që të vijnë të ndjekin këtë eveniment të madh sportiv", deklaroi kryetari i Federatës së Mundjes, Betim Vrenezi. Kampionati botëror në mundje për veteran do të mbahet nga data 28 deri me 30 në sallën sportive Boris Trajkovski. *(F.N)*

Debutoi me Cityn, e pret Kosovën



E mërkura e 25 shtatorit 2018 do të mbetet në kujtesë të përhershme të Arijanet Muriqit. Portieri shqiptar gjatë kësaj mesjave debutoi me ekipin e parë të Manchester Cityt. Trajneri Pep Guardiola ia dha atij rastin të mbronte në ndeshjen e Cabaleo Cup ndaj Oxford Unitedit dhe e mbajti portën e tij të paprekur. Portieri i lindur dhe i rritur në Zvicër, me prindër shqiptarë nga Mali i Zi, ndihet i lumtur që iu dha rasti për të mbrojtur për kampionin anglez. Madje ai u shpreh se iu realizua njëra ëndërr. "Po ndihem mirë, ishte një lojë e mirë, të cilën e mbyllëm pa pësuar gol. Jam i lumtur që e bëra lojën e parë me ekipin e parë të Manchester Cityt. Ka qenë gjithmonë një ëndërr imja", ka thënë Muriqi për televizionin e Manchester Cityt. "Unë ushtroj çdo ditë fort. Jam i lumtur për këtë mundësi, trajneri besoi në mua të luaj në këtë kompeticion", vazhdoi ai. Gjatë verës Muriqi ishte huazuar në Holandë. Mirëpo më pas trajneri Guardiola vendosi ta kthente pas pak javësh pasi i nevojitej një portier dhe tash portieri i ri po ia shpaguan besimin trajnerit spanjoll. "Unë shkova në Holandë për tri javë dhe trajneri më thirri të kthehem dhe isha i lumtur që u ktheva. Këtu ndihem si në shtëpi", shton ai.

SHPRESON TË LUAJË MË SHUMË

Muriqi është mjaft ambicioz. Pas paraqitjes së parë pozitive ai shpreson që në të ardhmen e afërt t'i jepet prapë rasti të mbrojë për ekipin e parë të Cityt. "Shpresoj të luaj edhe në turnin tjetër të Kupës, por është vendim i trajnerit dhe të shohim", përfundoi ai.

E PRET DOKUMENTACIONIN NË KOSOVË

Arijanet Muriqi e zgjodhi Përfaqësuesen e Kosovës muajin e kaluar, duke hequr dorë nga Mali i Zi, të cilin e kishte përfaqësuar në grupmoshat e reja. Mirëpo atij i duhet të presë ende për t'u ftuar nga Kosova A. Në FFK i kanë thënë "Zërit" të enjten se për momentin janë në pritje të kompletimit të dokumentacionit të portierit, andaj nuk dihet ende nëse ai do të jetë pjesë e Verdhekaltërve për dy ndeshjet e tetorit në Ligën e Kombeve ndaj Maltës dhe Ishujve Faro.

KUSH ËSHTË ARO MURIQI?

Tabloidi britanik "The Sun" ia ka kushtuar një shkrim të veçantë portierit shqiptar me rastin e debutimit të tij me ekipin e parë të Cityt. Ky medium e ka përshkruar Muriqin si portier me perspektivë, i cili e ka bindur trajnerin Guardiola me aftësitë e tij. "Pasi Claudio Bravo do të mungojë një kohë të gjatë portieri i akademisë është bërë portieri i dytë te City. Është e qartë se Muriqi e ka impresionuar trajnerin Guardiola javët e fundit, duke e kaluar portierin e dytë të deritashëm Daniel Grimshaw", shkruan "The Sun". Muriqi i ka tri nënshtetësi të ndryshme. Ai është lindur në Zurich të Zvicrës, ndërsa është shqiptar me prindër nga Mali i Zi. Ai ka mbrojtur për ekipin U-21 të Malit të Zi, ndërsa në dy ndeshje është përjashtuar nga loja me karton të kuq. Në të parën kundër Bosnjë e Hercegovinës është përjashtuar pasi e kishte prekur topin me dorë jashtë 16-metërshit, ndërsa në të dytën ndaj Sllovenisë ai e kishte marrë të kuqin pasi e kishte qëlluar në kokë një kundërshtar.

Pasi dështoi ta fitonte një ftesë nga ekipi A i Malit të Zi 19-vjeçari e kishte shprehur dëshirën për të mbrojtur për Përfaqësuesen e Kosovës. Ai e kishte nisur karrierën në akademinë e futbollit të klubit Zurich, ndërsa më pas kishte lëvizur drejt rivalit Grasshoppers. Në korrik 2017 ai kishte nënshkruar kontratë trevjeçare me Manchester Cityn dhe menjëherë ishte huazuar te NAC Breda, ku e kishte zhvilluar vetëm një ndeshje me klubin holandez sezonin e kaluar.

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 dhe 3 , nenit 23 paragrafi 1, 4, 5 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 120/11, 10/12, 11/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16) nenit 82 të Ligjit për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 103/08, 33/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15 , 98/15, 145/15, 30/2016, 127/16 dhe 67/17) dhe Pëlqimit nga MASH nr. 12-10292/16 të datës 19.09.2018, drejtori i SHFK "Draga Stojanovska" f. Rakotincë – Sopishte, publikon

SHPALLJE
Për punësim për kohë të caktuar për vitin shkollor 2018/2019

1. Një (1) mësimdhënës të mësimit klasor për mësimin në gjuhën turke në SHP në f. Drzhillovë, me neto pagesë bazë prej 21.676,00 denarë, për kohë të caktuar për vitin shkollor 2018/2019, deri më 31.08.2019.

Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligjin për marrëdhënie pune kandidatët për mësimdhënës duhet të përmbushin edhe kushtet nga neni 80 dhe 81 i Ligjit për arsim fillor: të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë, të kenë të mbaruar arsim përkatës, të njohin gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik (për paralelet në gjuhën turke edhe gjuhën dhe alfabetin në të cilin realizohet mësimi) dhe të kenë të dhënë provim profesional për mësimdhënës, bashkëpunëtor profesional, gjegjësisht edukator.

Në shpalljen publike mund të paraqitet edhe personi pa provim të dhënë profesional dhe të lidhë marrëdhënie pune për kohë të caktuar deri në fund të vitit shkollor.

Orari i punës së mësimdhënësit në kuadër të javës pesëditore të punës realizohet në ndërrimin e parë me fillim në ora 08:00 në pajtim me Orarin e orëve për vitin shkollor 2018/2019.

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit të tekstit të shpalljeve në shtypin ditor.

Zgjedhja do të realizohet më së voni në afat prej 15 ditëve pas përfundimit të shpalljes.

Fletëparaqitja me CV dhe dëshmitë e nevojshme të dorëzohen deri në SHFK "Draga Stojanovska", f. Rakotincë – Sopishte në adresën rr. "1" nr. 2, f. Rakotincë – Sopishte.

SHFK "Draga Stojanovska"
f. Rakotincë – Sopishte

KLAN MACEDONIA

Televizioni kombëtar **KLAN Macedonia** shpall konkurs për pranimin e:

1) 1. Gazetarë-redaktorë për redaksinë në gjuhën shqipe Dhe maqedonase 30
2) Kameramanë.....9
3) montazhierë 6
4) regjisorë 6
5) IT 2
6) Realizatorë.....2

Kërkohet njohja e mirë e gjuhës shqipe dhe maqedonase. Njohja e gjuhës angleze do të konsiderohet përparësi.
Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet e parashikuara me ligj si dhe të tregojnë zotësi për vendet e punës për të cilat konkurrojnë.
Kushtet:

- Arsimim përkatës
- Përvoja do të merret si përparësi, por nuk është e detyrueshme
- Gatishmëri për të punuar në ekip
- Aftësi për të përballuar presionin e punës
- Njohje e punës me kompjuter
- Aftësi të mira komunikuese

Konkursi është I hapur nga data 28.09.2018 deri më 11.10.2018
Aplikimet I dërgoni në adresën:

Klan Macedonia
Rr. Ilindenska, nr. 4, lokal 18,Tetovë
Ose në email -adresën: arbenhalili82@hotmail.com

KORRIGJIM I KONKURSIT

Për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore në Universitetin e Tetovës, i shpallur më 26.09.2018 në gazetën ditore "Koha"

1. Në pjesën "FAKULTETI EKONOMIK", në pikën 4 shtohen fjalët "Ekonomia ndërkombëtare.
2. Në pjesën "FAKULTETI EKONOMIK", në pikën 5 fjalët "Ekonomia ndërkombëtare" fshihen.
3. Në pjesën "FAKULTETI EKONOMIK", në pikën 6 fjalët "Financat publike" zëvendësohen me fjalët "Financa ndërkombëtare".

Universiteti i Tetovës

Në bazë të nenit 17 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve për nxënës dhe aktiviteteve tjera të lira të nxënësve të shkollave fillore, Komisioni për realizimin e procedurës publikon:

SHPALLJE
për grumbullimin e ofertave për organizim të aktiviteteve të lira për nxënësit

1. Organi kontraktues (furnizues)
SHFK "Shën Kliment Ohridski" f. Drasllajca – Strugë, oudraslajca@yahoo.com
2. Ofertues – Secili subjekt i interesuar i vendit ose i huaj i regjistruar për kryerje të veprimtarisë në pajtim me lëndën e shpalljes.
3. Lëndë – Ekskursion treditor për nxënësit e klasës së 9 nëpër R. Maqedonisë, ekskursion njëditor për nxënësit e kasës së 3 në Manastir dhe 2 piknikëve njëditore në Skrebatno dhe Muzeu i ishullit të eshtrave në Ohër.
4. Kriteret për ndarje të marrëveshjes
-Ofertuesi të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në RM për kryerje të veprimtarisë përkatëse turistike (A-licenca) .
-Ka të realizuar së paku tri ekskursione për nxënësit dhe aktivitete tjera të lira në tri vitet e fundit.
-Përmbushë kushtet për udhëtim të grupit të nxënësve në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilët do të udhëtojnë grupi i fëmijëve.
-Çmimi më i ulët.

Në kushtet e ofertës nuk duhet të ketë zgjidhje alternative, kushtet duhet të jenë saktësisht të përcaktuara pa mundësi për të ndryshuar. Ofertat dhe dokumentet duhet të parashtrohen me vulë dhe nënshkrim nga ana e ofertuesit. Ofertat të cilat nuk do të nënshkruhen dhe vulosen nga ofertuesit dhe ofertat të cilat nuk do të përmbajnë të gjitha dokumentet e kërkuara do të konsiderohen si të pakompletuara dhe nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit. Dokumentacioni tenderues në të cilin në mënyrë më të detajuar janë theksuar përmbajtjet dhe kushtet, mund të merret çdo ditë pune në objektin e shkollës gjatë kohëzgjatjes së shpalljes prej ora 08:00 deri në ora 13:00, vetëm nga ana e personit të autorizuar të ofertuesit. Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit.

Ofertat të parashtrohen në adresë SHFK "Shën Kliment Ohridski" f. Drasllajca – Strugë me shenjë për Komision për ekskursionet.

SHFK "Shën Kliment Ohridski"
Komisioni për ekskursione

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1, nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015-teksti i pastruar) dhe nenit 142 paragrafi 1 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/2013), Drejtori i IPKÇF "Majski Cvet" Manastir publikon

SHPALLJE PUBLIKE
Për punësim për kohë të pacaktuar

1. **PEDAGOG MUZIKOR – një (1) realizues për kohë të pacaktuar**

- Kushtet e posaçme të nevojshme
-PSP – pedagog muzikor – me 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 dhe licencë valide për bashkëpunëtor profesional.
- pa përvojë pune
- licencë valide për bashkëpunëtor profesional
Orari i punës është 40 orë në javë, prej ora 7:30 deri në ora 15:30.
Neto pagesa bazë është 21.026,00 denarë.
Krahas kushteve të posaçme të theksuara kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme ligjore.
Kandidatët duhet të dorëzojnë:
- Lutje
- Diplomë (Certifikatë), (origjinal ose kopje të vërtetuar);
- Licencë valide (për bashkëpunëtor profesional)
- Certifikatë të shtetësisë së RM (jo më të vjetër se gjashtë muaj);
- Certifikatë të lindjes
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më të vjetër se gjashtë muaj).
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën do dënohet për vepër penale dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdese dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për vepër penale të grupit të veprave kudër lirisë gjinore (jo më të vjetër se gjashtë muaj).

Shpallja zgjatë tre (3) ditë pune nga dita e publikimit të saj.
Zgjedhja do të realizohet në afat prej dyzetepesë (45) ditëve, pas kalimit të afatit për paraqitje.

Dokumentacioni i kompletuar të dorëzohet në adresën: IPKÇF "Majski Cvet" – Manastir, rr. "Smilevski Kongres" pn, Manastir.
Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IPKÇF "MAJSKI CVET"
MANASTIR

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1, nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/2015-teksti i pastruar) dhe nenit 142 paragrafi 1 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM nr. 23/2013), UD Drejtori i IPKÇF "Majski Cvet" Manastir publikon

SHPALLJE PUBLIKE
Për punësim për kohë të pacaktuar

1. **Përkëdhelës – një (1) realizues për kohë të pacaktuar**

- Kushtet e posaçme të nevojshme
- PMP – arsim të mesëm katërvjeçar dhe licencë valide për përkëdhelës
- pa përvojë pune
- licencë valide për përkëdhelës
Orari i punës është 40 orë në javë, të cilat janë të shpërndara në 35 orë për punë drejtpërdrejtë me fëmijë, ndërsa koha tjetër për aktivitete të tjera prej ditës së hënë deri ditën e premte; orari i punës është me shkallë në kuadër të orarit të punës prej ora 5:30 deri në ora 18:00.
Neto pagesa bazë është 15.477,00 denarë.
Krahas kushteve të posaçme të theksuara kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e përgjithshme ligjore.
Kandidatët duhet të dorëzojnë:
- Lutje
- Diplomë (Certifikatë), Dëftesë për arsimin e mbaruar përkatës (origjinal ose kopje të vërtetuar);
- Licencë valide (për edukator ose përkëdhelës)
- Certifikatë të shtetësisë së RM (jo më të vjetër se gjashtë muaj);
- Certifikatë të lindjes
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më të vjetër se gjashtë muaj).
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilën do dënohet për vepër penale dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdese dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për vepër penale të grupit të veprave kudër lirisë gjinore (jo më të vjetër se gjashtë muaj).

Shpallja zgjatë tre (3) ditë pune nga dita e publikimit të saj.
Zgjedhja do të realizohet në afat prej dyzetepesë (45) ditëve, pas kalimit të afatit për paraqitje.
Dokumentacioni i kompletuar të dorëzohet në adresën: IPKÇF "Majski Cvet" – Manastir, rr. "Smilevski Kongres" pn, Manastir.
Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

IPKÇF "MAJSKI CVET"
MANASTIR

Lajmërim

NBI Lidia Dimkovska – Lide Farm nga Kumanova me seli në rr. ZH. J.Shpanac 2/30 Kumanovë, ka ndërprerë punën.

GJASHTË MUAJ PA GOL

Alexis Sanchez nuk ka arritur të adaptohet te Manchester Unitedi as pas tetë muajsh të kaluar në "Old Trafford". Pavarësisht se kiliani dukej në formë gjatë verës në përgatitjet e sezonit të ri, sulmuesi ka dështuar të tregojë paraqitje të mira në fillimin e këtij edicioni. Ish-lojtari i Arsenalit nuk ka shënuar gol në Premierligë qysh prej fundit të marsit

Alexis Sanchez do të përfaqësonte provën e vërtetë, që është më së miri të mos merren parasysh përgatitjet parasezonale. Ai ishte shkëndija e vetme e Manchester Unitedit në turnin parasezonal në Amerikë, duke e treguar veten pas problemeve me vizën, duke iu bashkuar stërvitjeve dhe duke dhënë paraqitje premtuese. Kilianit iu falën momentet zhgënjyese të muajve të parë, duke u arsyetuar se erdhi në mes të sezonit dhe që pritjet ishin të mëdha për të. Parapërgatitjet në Amerikë ishin pozitive për të. Njerëzit tashmë po e shihnin sulmuesin si të përkushtuar ndaj ekipit. Jose Mourinho u kthye nga Amerika i sigurt që sulmuesi me pagë javore prej 500 mijë funtesh do të fillonte produktivitetin e tij. Para së gjithash dy golat e tij në 12 ndeshjet e para si titullar nuk ishin fillimi i pritur nga ai. Por, ajo që pasoi duhet ta shqetësojë Mourinhon. Sanchez, që dukej aq i gjallë dhe me aq entuziazëm para disa javësh, tani ka humbur. Ai nuk e ka mbyllur një 90-minutësh që prej 10 gushtit dhe Chris Smalling ka shënuar tri gola që prejse Sanchez ka shënuar për herë të fundit në Premierligë, në fund të marsit. Zëvendësimi i tij pas një ore lojë në barazimin 1:1 ndaj Wolverhamptonit flet shumë për problemet e tij. Një vendim aspak i befasishëm, duke parë që Sanchez dhuroi 16 herë topin dhe kishte vetëm një goditje. Madje kjo një gjuajtje e lirë në një zonë të rrezikshme, që përfundoi në tribuna. E gjithë kjo nuk i befason personat që e ndjekin Manchester Unitedin dhe prej kohësh ka pasur murmuritje në mesin e tifozëve. Dhe kjo pa dyshim që nuk ka ndodhur për shkak se ai ishte i zënë. Sanchez nuk ishte në Kupën e Botës, nuk luajti për Kilin këtë muaj dhe kishte pushim ndaj Young Boysit. Ai duket sikur e ka lëshuar edhe këtë iniciativë, duke regjistruar më pak goditje për ndeshje (2.43) që prejse luan në Angli. Mesatarja prej 1.08 goditjesh në drejtim të portës është qesharake për një lojtar që i është dhënë aq shumë durim dhe liri nga trajneri, shpeshherë në dëm të Marcus Rashfordit dhe Anthony Martialit. Driblimet që ka provuar (3.24) dhe ato të kompletuarat (1.35) këtë edicion janë larg shifrave që ai regjistroi në edicionin e tij të parë në Angli. E njëjta vlen edhe për numrin e prekjeve të topit. Pavarësisht kësaj Paul Pogba i del në mbrojtje atij. "Ajo që duhet ta dini për Alexisin është se ai është një punëtor i madh. Ai stërvit mirë, ai gjithmonë mundohet që ta ndihmojë ekipin, të flasë me ekipin dhe gjithçka. Ai do të mësohet", ka deklaruar Pogba. Sa kohë i duhet një njeriu që fiton 20 milionë funte në vit të mësohet me dinamikën e ekipit të ri? "Kur luani për një kohë të gjatë me një skuadër tjetër dhe ju luani stil të ndryshëm të lojës në atë ekip duhet të keni pak kohë që të adoptoheni. Nuk është se ai po luan keq. Ne e dimë se Alexis Sanchez mund të sjellë shumë dhe jam i sigurt që do ta bëjë. Jam i sigurt që do ta bëjë. Por, ai nuk është duke luajtur keq dhe ai vazhdon të mbetet pozitiv, kështu që është një gjë e mirë që duhet ta mendojmë", shprehet Pogba. Sigurisht ka diçka që duhet t'i mbajë të lidhur Unitedin, Mourinhin dhe Sanchezin, i cili ka realizuar vetëm një asistim deri më tani. Diçka e pazakontë te Unitedi është se kur kritikat sjellin vetëdijesim te lojtarët ata fillojnë të rigjejnë veten. Kështu që prisni që ai të realizojë "hat-trick" kundër West Hamit të shtunën. Manchester City do të ketë pasur vëmendje të veçantë për tetë muajt e parë të Sanchezit në "Old Trafford". Një humbje me fat e Pep Guardiolas. Që Unitedi bëri aq shumë bujë me nënshkrimin e Sanchezit nga Arsenali nuk duket e mirëmenduar momentalisht dhe ata duhet të shpresojnë që loja e pianos nuk është sonata hapëse drejt fundit të karrierës së tij.



Wanda zbulon të ardhmen e Icardit: Do të jenë dyshja e së ardhmes

Wanda Nara, gruaja dhe menaxherja e kapitenit të Inter, Mauro Icardi, ka dhënë disa deklarata të rëndësishme në emisionin "Pressing" të "Canale 5" në lidhje me të ardhmen e sulmuesit argjentinas, jo vetëm për sa i takon zikaltërve, por edhe kombëtares së Argjentinës. "Të kesh shembuj si Zanetti tek Inter dhe Totti te Roma është gjithmonë një gjë e mire dhe është pozitive për këdo që bëhet pjesë e klubit. Të qëndrosh për një kohë të gjatë me të njëjtën skuadër është një vlerë e shtuar. Dëshira e Icardi-t? Ka qenë gjithmonë të qëndrojë tek Inter dhe tifozët e dinë këtë", ka thënë Nara. "Dybala konsiderohet një kampion në Argjentinë, ka luajtur edhe disa minuta bashkë me Mauro-n në ndeshjen e fundit të kombëtares dhe janë paraqitur mirë. Ai dhe Icardi do të jenë dyshja e së ardhmes tek Argjentina".

UEFA merr vendim: VAR-i në Ligën e Kampionëve nga sezoni i ardhshëm

Mbledhja e Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s vendosi sot të miratojë përdorimin e video-arbitrazhit (VAR) në Ligën e Kampionëve, duke nisur nga sezoni 2019-2020. Përveç kësaj u vendos që VAR-i, gjithashtu, të futet në përdorim në "EURO 2020", në sezonin 2020-2021 të "Europa League" (nga faza e grupeve e në vazhdim) dhe në finalen e Superkupës së Europës të vitit 2021. Aleksander Ceferin, president i UEFA-s, tha: "Ne jemi të bindur se prezantimi i VAR-it në gusht 2019 do të na japë kohë të mjaftueshme për të vendosur një sistem solid. Do t'i trajnojmë gjyqtarët për të siguruar një zbatim efikas dhe të suksesshëm të VAR-it në Ligën e Kampioneve, kompeticioni më i rëndësishëm në botë". Në janar, kreu i lartë i qeverisë europiane të futbollit kishte kërkuar kujdes dhe jo ngutje për futjen e VAR-it në garat e organizuara nga UEFA: "Sipas mendimit tim, është shumë herët për ta vendosur atë si rregull". Deri tani, prania e VAR-it ishte ende e kufizuar në turne të vogël të FIFA-s dhe disa liga të tilla si Gjermania, Italia dhe Portugalia. Duket se suksesi i teknologjisë në Botërorin e fundit ("Rusia 2018") ka inkurajuar UEFA-n për t'i përshpejtuar hapat në këtë drejtim. Kjo, edhe me kërkesë të klubeve europiane.

Portieri hero denoncon sjelljen e shëmtuar të Barcelonës

Ivan Cuellar ishte çelësi i fitores së Leganés kundër Barcelonës në "Butarque". Portieri "hero" bëri disa ndërhyrje të rëndësishme dhe shpëtimtare, duke e parandaluar ekipin e trajnerit Valverde që të merrte të paktën një pikë. Pas përfundimit me fitoren 2-1 të Leganes, portieri Cuelar nuk e "kafshoi gjuhën" fare, teksa po fliste për "El Larguero". Ai u ankua për mungesën e sportivitetit të lojtarëve të Barcelonës. "Është e vërtetë që jemi Leganes, një ekip i përulur, por më pëlqen që kundërshtarët të sillen me sportivitet ndaj nesh. Disa lojtarë dhe skuadra mund të jenë mësuar më së shumti të fitojnë, por ja që edhe humbet në futboll. Kur humbet duhet ta përshëndesësh dhe përgëzosh ekipin tjetër, diçka që lojtarët e Barcelonës nuk e bënë, – siguroi portieri. – Askush nuk erdhi për të na uruar, askush prej nesh nuk është përgëzuar. Unë mendoj se ky është një gjest mjaft i shëmtuar".

BUFFON E MBYLL ME KOMBËTAREN, TREGON TALENTIN E VETËM TË VËRTETË ITALIAN

"Ka momente, kur dikush me historinë time duhet të bëjë një hap prapa, për vetëmbrojtje. Mendoj se ishte e drejtë të tërhiqesha. Jetoj me emocione, gjithmonë kam dhënë gjithçka për kauzën e ekipit kombëtar. Për fat të keq, në moshën 40-vjeçare nuk mund të japësh atë që dëshiron më shumë, kështu që do të preferoja të qëndroja në shtëpi me fëmijët dhe familjen time", ka deklaruar Buffon

Gianluigi Buffon ka folur përsëri nga Parisi. E ka bërë këtë për të kurorëzuar shokun e grupit, Marco Verratti, si elementin kryesor të PSG-së, edhe pse shpesh në qendër të kritikave, kur ka veshur fanellën e kombëtares së Italisë. Po ashtu, 40-vjeçari e ka thënë shkoqur, se nuk do të rikthehet më në kombëtare. "Tani për tani, Verratti është i vetmi talent i vërtetë i futbollit italian. Shumë herë, kur duke luajtur me lojtarë të zakonshëm, vihet në vështirësi për shkak se nuk e kuptojnë atë, ndërsa këtu te PSG-ja ka shans për të luajtur me emra të spikatur", vë në dukje Buffon, i intervistuar nga "La Gazzetta dello Sport". Ish-portieri i Juventusit më pas flet për supersfidën e radhës në Seria A, Juventus-Napoli, dhe Lorenzo Insigne: "Rritja e Insigne është evidente, ai është një lojtar shumë i rëndësishëm. Në qoftë se vë në kontekstin e duhur taktik, Lorenzo mund të bëjë që skuadra e tij të fitojë. Jam i lumtur që Napoli është duke bërë mirë, sepse kam një marrëdhënie dhe respekt të madh për Carlo Ancelottin, por Juventusi është Juventus. Si klub, si mentalitet dhe si histori, Juventusi është kryesisht para të gjithëve. Madje, edhe në nivel europian, tani është ndër tri vendet e para". Së fundmi, Buffon e përjashton një kthim të mundshëm në ekipin kombëtar italian: "Ka momente, kur dikush me historinë time duhet të bëjë një hap prapa, për vetëmbrojtje. Mendoj se ishte e drejtë të tërhiqesha. Jetoj me emocione, gjithmonë kam dhënë gjithçka për kauzën e ekipit kombëtar. Për fat të keq, në moshën 40-vjeçare nuk mund të japësh atë që dëshiron më shumë, kështu që do të preferoja të qëndroja në shtëpi me fëmijët dhe familjen time", ka deklaruar Buffon. Kampioni i botës me Italinë në vitin 2006 tregon edhe bisedën që ka pasur me trajnerin aktual të axurrëve, Roberto Mancini: "Me të jam takuar në maj, ishte një bisedë konstruktive. E përsëris, ka momente kur një me historinë time duhet të bëjë një hap prapa. Mendoj se ishte e drejtë të veproja në këtë mënyrë. Ia thashë këto trajnerit dhe ai i kuptoi dhe i respektoi mendimet e mia. Kjo është shumë e bukur".

"Bomba" nga Spanja, Barça gjen zëvendësuesin e Valverdes

Humbja e befasishme e pësuar në shtëpinë e Leganes ka dhënë alarmin në shtëpinë e Barcelona-s, të paktën sipas shtypit spanjoll. Fillimi i sezonit të "blaugrana"-ve ka qenë i mirë, por jo i shkëlqyer, siç mund të imagjinohej pas blerjeve të shumta të bëra në merkato. Humbja e së mërkurës, që ka ardhur pas barazimit në shtëpi me Girona-n, duket se ka bërë drejtuesit e klubit të vënë në dyshim aftësitë e trajnerit Ernesto Valverde. Sipas "Don Balon", trajneri i Barçës, kontrata e të cilit skadon në qershorin e 2019-ës, është në rrezik. Madje, drejtuesit mësohet të kenë zgjedhur edhe emrin e zëvendësuesit. Bëhet fjalë për Laurent Blanc, ish-trajneri i PSG-së, i cili mund të jetë një zgjidhje e menjëhershme nëse marrëdhënia mes Valverde-s dhe Barcelona-s përkeqësohet. E sigurt është se, duke filluar nga ndeshjet e ardhshme dhe veçanërisht në Champions League, një tjetër hap fals nuk do të jetë më i pranueshëm.

Low nuk lejohet në stërvitje, Emery: Nuk vendosa unë!

Trajneri i Arsenalit Unai Emery ka mohuar lajmet se ai nuk lejoi që trajneri Joachim Low të hynte në ambientet stërvitore të Arsenalit, për të takuar mesfushorin Mesut Ozil. Të mërkurën "Sport Bild" raportoi se Low shkoi të takonte lojtarët gjermanë të Arsenalit dhe dëshironte të bisedonte me Ozil, me të cilin nuk ka folur që prej Kupës së Botës, por trajneri gjerman nuk u lejua të hynte në qendrën stërvitore dhe u aludua se urdhri kishte ardhur nga Emery. Megjithatë, vetë trajneri spanjoll ka dashur ta sqarojë këtë çështje, duke folur pas ndeshjes së Kupës së Ligës kundër Brentfordit, të mërkurën më mbrëmje. "Nuk është e vërtetë që nuk e lejova Low-in që të takohej me Ozil. Nuk ishte ndonjë problem për mua, nuk është e vërtetë asgjë nga ato që është thënë".

Acar total, ylli i Arsenalit bën gati valixhet

Arsenali me shumë gjasa do të humbasë falas në fund të sezonit një nga yjet e vet, mesfushorin uellsian Aaron Ramsey, raporton Mirror Sport. Bëhet fjalë për një ndër lojtarët më të rëndësishëm të Topçinjve, i cili ishte gati të firmoste një kontratë të re dhe klubi londinez ishte optimist javët e fundit për aritjen e marrëveshjes. Megjithatë, krejt papritur gjithçka ka ngrirë dhe bisedimet janë ndalur, aq sa Arsenali duket se ka hequr dorë përfundimisht nga firma në kontratën e re. Një situatë e çuditshme, sepse Ramsey është vetëm 27 vjeç dhe është në kulmin e karrierës, ndërsa verën e shkuar Arsenali refuzoi një ofertë prej 50 milionë sterlinash, ndërsa në garë për uellsianin janë Juventusi, Chelsea, Manchester United dhe Lazio. Ramsey ka luajtur në pozicione të ndryshme këtë sezon, për të dhënë kontributin e tij që skemat e trajnerit Unai Emery të funksionojnë, por tashmë nuk kuptohet nëse Emery e ka në plane. Aktualisht lojtari më i paguar tek Arsenali është Mesut Ozil, me 350,000 sterlina në javë, duke bërë që lista e pagave të fryhet ndjeshëm dhe ndoshta edhe Ramsey kërkon një rritje mbi normalen, duke bërë që Arsenali të stepet, por kjo mefshtësi në rinovimin e kontratave tregon që klubi nuk menaxhohet si duhet, sepse edhe Alexis Sanchez u largua duke qenë në vitin e fundit të kontratës.

DASHI 21. mars - 20. prill

Nga pikëpamja sentimentale parashikohet një ditë mjaft aktive dhe dinamike. Takime, rizgjim pasioni dhe shkëndija të reja janë mjaft të mundshme, por bëni kujdes dhe mos përfshini persona të tjerë në raportet tuaja.

DEMI 21. prill - 21. maj

Kjo ditë do ju gjejë mjaft të zënë në punë, sektor të cilës duhet ti kushtoni vëmendjen maksimale, sidomos nëse bashkëpunoni prej pak kohësh me disa persona. Mjaft i favorizuar është dialogu dhe kompromiset. Mbrëmja do të jetë ideale për të përmbyllur një çështje të rëndësishme.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Do të ndiheni mjaft në siklet nga një situatë e pasigurtë, por që iu rizgjon emocione të cilat nuk i ndjenit prej kohësh. Nëse do të jeni më të pavarur, do të arrini të merrni një rol mjaft të rëndësishëm në punë.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Do të dalë në pah pozitiviteti dhe lirshmëria juaj dhe kjo edhe në sajë të përgjigjeve të vogla, të cilat ju lejojnë që të vlerësoni më mirë disa zgjedhje për të ardhmen tuaj profesionale. Kjo e enjte ju fton që të ruani qetësinë në dashuri. Ndonjë diskutim i vogël, mund t'iu nervozojë.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Do t'iu duhet të përvishni mëngët në punë, pasi në këtë moment do të jeni në kërkim të përgjigjeve dhe zgjidhjeve që i prisnit prej kohësh. Në dashuri nuk do të mungojnë mundësitë e mira.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Do të jeni mjaft praktikë dhe të organizuar dhe instinkti juaj do të stimulojë më tej natyrën tuaj komanduese. Megjithatë duhet të mundoheni të dëgjoni më shumë mendimin e bashkëpunëtorëve tuaj. Mos u sforconi shumë nga pikëpamja fizike, pasi nuk përjashtohen keqkuptime të mundshme.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Mundohuni të ruani qetësinë, sidomos në familje. Disa keqkuptime, nuk do ju lejojnë që të diskutoni ashtu siç dëshironi, ndaj duhet të ruani qetësinë. Në familje duhet të tregoheni sa më të kuptueshëm dhe të qetë.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Kjo është një ditë e rëndësishme për të çuar deri në fund një punë, ndërsa prej kohësh keni qenë të stresuar. Megjithatë do të arrini objektivat tuaj, të cilat ia keni vendosur vetes gjatë verës. Kjo e enjte ju fton të forconi bashkëpunimin në çift.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Do të rigjeni guxim dhe kurajo në dashuri dhe kjo rigjetje sigurie do ju lejojë që të stimuloni edhe më shumë fushën e ndjenjave. Ambicie të reja profesionale, do të ndikojnë në zgjedhjet që do të bëni në vendin e punës.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Mundohuni të mbyllni të gjitha çështjet e lëna pezull dhe ato lidhje të cilat nuk ju kënaqin, sidomos nëse gjatë javëve të fundit nuk jeni përkushtuar mjaftueshëm. Dashuria do të jetë mjaft e favorizuar.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Kjo ditë ju fton që të mos tregoheni të nxituar, pasi disa vendime do të duhet të diskutohen më mirë. Merrni mendimet e familjes, partnerit/es dhe bashkëpunëtorëve tuaj me më shumë qetësi.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Mundohuni të ballafaqoni lidhjen tuaj aktuale me atë të të kaluarës, në mënyrë që të shmangni shqetësimet e kota. Harmonia dhe stabiliteti do të mund të konsolidohen në raportin në çift. Duhet të jeni të përgatitur për zhvillime pozitive në vendin e punës.

BESNIK KËRLUKU

(28.09.1944 – 28.09.2003)

PËRKUJTIM

**Ati
Baba,
Rrufeja smirake
Mbi lisat e gjatë bie.
Ty nuk të ngrohu jeta
Midis mëkatarëve vdekatarë
E shkove midis engjëjsh-engjull.
Ti ike nga dashuria e tepërt,
Baba!**

**Bija jote, DELVINA
Të përkujtojnë: mami:- Vjollca; Motrat: - Saranda, Ulza;
Vëllau: - Rilind.
Familja Kërluku, Dibër.**

Mensur Mamuti



- E KUNDËRTA E PRAKTIKËS / BOKSIERI ZVICËRAN NË FOTO
- T
- QYTETI I LINDJES SË BOKSIERIT NË FOTO
- ESAT TELITI
- SISTEM I ZBULIMIT TË OBJEKTEVE ME ANË TË RADIO VALËVE
- MATEMATIKANI SKOCEZ, XHON (N)
- ARTERIA MË E MADHE, QË DEL NGA ZEMRA
- I MOSHËS RINORE / QË KA SHUMË MISH, E TULTA
- GJERMANIA / PAJISJE ELEKTRONIKE ME EKRAN
- E
- TEMPERATURA
- THAJ / APARATET PËR RREGULLIMIN E TEMPERATURËS
- RADIKALI NJËVALENT I KARBONIT DHE HIDROGJENIT
- SHEFI SHQIPTAR, REXHEPI
- SAHATI
- PORTIERI KILIAN, KLAUDIO / PIJE E FORTË ALKOOLIKE
- R
- IRIDIUMI / PRODHIM DRITHI
- PËRHAPJA (E RREZEVE, VALËVE ETJ.)
- NDARËS DHOMASH
- VEND NË SLLOVENI
- NUK NXJERR ZË APO FJALË NGA HABIA A NGA FRIKA
- AKTORE ITALIANE
- POLITIKANE KOSOVARE / MARKË JAPONEZE E ORËVE
- K
- SAPO NIS TË ERRËT OSE TË ZBARDHË, MUGËLLON / QYTET NË KOSOVË
- KOHA
- LLOJ QENI ANGLEZ / QYTET NË SHQIPËRI
- MELIHATE AJETI / PËRPUNOJ LËKURËN
- TIFOZ I SHKENDIJËS
- RHODE ISLAND RED / QYTET NË FRANCË
- KALI I SHALËS / NGJYRA E KUQE E NDEZUR
- RAJON NË AZINË QENDRORE / HANE NIKPRELAJ
- A
- TRUP QË KA VETI TË NJËLLOJTA, I PAPËRZIER / AUSTRIA
- GJENDJE E NGUROSUR
- TANTALI

ZGJIDHJET: T, NEPER, AORTA, I RI, D, E MISHTA, T, TER, ETILI, RENE, BRAVO, RUM, IR, NJOMZA EMINI, KASIO, MUGET, TERIER, MA, BALLIST, RIR, ATI, TIBETI, ALLE, HOMOGJEN, SHTANGIE, TA.

Mos i krahasoni fëmijët me moshatarët e tyre

Prindërit kanë tendencë që zakonisht për model të marrin fëmijët e tjerë të fqinjëve apo në mesin e familjes, në rastin kur fëmija i tyre dështon në ndonjë fushë të caktuar, apo edhe sepse thjesht ata nuk janë të kënaqur me ta për çfarëdo arsye tjetër. Kjo praktikë tashmë po njihet si e keqe, e në lidhje me këtë ka folur edhe mjekja pediatër në NYU, Dr. Robin Jacobson. Sipas saj, nënat janë gjithmonë të shqetësuara për peshën e fëmijës së tyre, por ajo që duhet të kuptojnë dhe të fiksojnë mirë është që fëmijët nuk janë njëlloj. "Burimi më i mirë për të mësuar rreth zhvillimit të fëmijës është pediatri", tha ajo. Dr. Jacobson pranoi se të gjithë prindërit shqetësohen kur shohin një fëmijë më të vogël se fëmija i tyre që flet ose ecën më mirë. Por prindërit duhet të kuptojnë që të gjithë fëmijët janë të ndryshëm. Zakonisht, pediatrit nuk japin receta me gramë dhe as nuk thonë sa duhet të shtojë një fëmijë gjatë një muaji. Mirëpo, këtu nuk është fjala vetëm për peshën në kohën kur fëmijët janë më të vegjël. Edhe mësimi, shoqëria, aktivitetet jashtë mësimore, apo sjellja e tyre, asnjëherë nuk duhet të krahasohet me të tjerët, sepse kështu mund ta dëmtoni fëmijën tuaj, duke i mbjell atij xhelozi për të tjerët, dhe pasiguri për veten.

Vezë të gatshme për fërgim për studentët që nuk dinë t'i përgatisin

Super-marketet në Islandë kanë nisur të shesin paketimet me vezë të gatshme për fërgim, pasi studentët me paaftësi kulinare, nuk dinë se si përgatiten. Nëpërmjet të kësaj mase të ngrirë që shitet për dy euro, mjafton vetëm 90 sekonda në furrën me mikrovalë dhe gjithçka është gati. Ata e krijuan këtë produkt, pasi një hulumtim ka gjetur se çdo i treti i ri, nuk di si fërgohet një ve si duhet. Ambalazhi që kushton për 50 cent më shtrenjtë se kutia me tetë vezë, nuk ka nevojë të ngrihet, ndërsa do të jetë e ekspozuar te supat dhe pastat. Raportohet se secila pako, përmban nga katër vezë të rrahura, pak qumësht, krip dhe piper. Prodhuesit e masës së përpunuar, vendosën ta realizojnë këtë produkt, pasi një hulumtim me 1,000 respodentë ka gjetur se 13 për qind e tyre, nuk dinë të fërgojnë apo ziejnë një vezë. Vezët janë produkt i rëndësishëm dhe shumë i pëlqyer nga të gjithë, andaj vendosëm ta bëjmë sa m të lehtë, veçanërisht për studentët që nisin studimet për herë të parë" thuhet në raport.

MISS-i humb kurorën pasi gënjeu se nuk ka fëmijë

Veronika Didusenko u shpall Miss Ukraina pak kohë më parë, por nuk zgjati shumë dhe drejtuesit e eventit vendosën ta "rrëzojnë nga froni" pasi kishte gënjyer që ishte e martuar dhe kishte edhe një fëmijë 4 vjeçar, në kundërshtim me rregullat. Ajo shkroi në formularin e aplikimit se kurrë nuk ka qenë e martuar dhe nuk kishte fëmijë. Megjithatë, gënjeshtra e saj doli në shesh dhe tani në garën për Miss Bota, Ukraina do të dërgojë një konkurrente tjetër. Organizatorët thonë se nuk janë të sigurt se kush do

të jetë Miss i ri i Ukrainës, por gjithçka do të vendoset nga juria.

Obeziteti më kanceroz se duhani

Obeziteti pritet t'ia kalojë duhanpirjes si një nga shkaqet kryesore të kancerit tek gratë deri në 2043. Parashikimi është bërë nga një qendër kërkimesh për kancerin në Britaninë e Madhe ku aktualisht 12 për qind e rasteve të kancerit tek gratë janë të lidhura me duhanpirjen dhe 7 për qind me mbipeshën apo obezitetin. Por, me numrin e duhanpirësve që po bie dhe me shkallën e obezitetit në rritje, studiuesit vlerësojnë se hendeku mes këtyre dy shkaktarëve do të zhduket në harkun kohor të 25 viteve. Dhe shifra është përllogaritur mbi besimin se tendenca aktuale do të vazhdojë. Sipas studimit, deri në 2035, 10 për qind e rasteve të kencerit tek gratë do të lidhet me duhanpirjen dhe 9 për qind me peshën e tepruar dhe në 2043, nëse trendi vazhdon, mbipesha dhe obeziteti do të

lidhet me më shumë raste kanceri tek gratë krahasuar me duhanin. Edhe pse obeziteti është i zakonshëm edhe mes meshkujve, tek femrat ai mendohet se është një shkaktar më i mundshëm i kancerit. Sidoqoftë, sipas ekspertëve, lufta duhet të vijojë në të dyja frontet, si kundër duhanpirjes ashtu edhe kundër obezitetit.

KALENDARI HISTORIK 28 SHTATOR

48 BC - Vritet Pompei i Madh me urdhër të Mbretit Ptolomej të Egjiptit pasi të zbarkojë në Egjipt.
1448 - Kristiani I kurorëzohet mbret I Danimarkës.
1521 - Trupat e Sulltanit turk Suleimani I okupojnë Beogradin.
1538 - Beteja e Prevezës: Flota turke nën Barbarosën mund flotën spanjolle.
1687 - Venedikasit marrin Athinën nga turqit.
1760 - Ushtria ruse dhe austriake okupon Berlinin.
1906 - Trupat amerikane ri-okupojnë Kubën.
1915 - Beteja e Kut-el-Amara: Britanikët mundin turqit në Mesopotami.
1922 - Musolini marshon në Romë.
1923 - Abisinia (Etiopia) largohet nga Lidhja e Kombeve.
1928 - Prusia ndalon fjalimin e Adolf Hitlerit.
1969 - SPD wins West German Parliament elections
1970 - Anvar Sadat zëvendëson kryetarin egjiptian, Nassar.
1972 - Japonia dhe Kina komuniste pajtohen që të rivendosin marrëdhëniet diplomatike.
2000 - Al-Aqsa Intifada: Ariel Sharon viziton Temple Mount në Jerusalem.

A E DINI SE...

ATA QË SHOHIN ËNDRRA TË FRIKSHME JANË MË KREATIVË
Poetët dhe filozofët i kanë interpretuar ëndrrat e këqija dhe makthet e natës si fantazi romantike ose si manifestime të anës së errët të natyrës njerëzore. Shumë shkencëtarë i kanë studiuar ato si jashtë dhe brenda mjediseve laboratorike me qellim për të kuptuar në mënyrë më shkencore vendin e tyre në jetën njerëzore. Një studim kanadez zbulon se njerëzit që përjetojnë ankthe të rregullta deri në dy javë shfaqin një model të pazakontë të të menduarit. Sipas studimit thuhet se personat që kanë patur një gjumë të parehatshëm, plot me makthe dhe ëndrra të frikshme janë më kreativë dhe sidomos për të realizuar piktura.

BARSOLETA

PROFESORI PYET BENIN
- Beni, çfarë të ndodh nëse të shkul një vesh?
- Do bëhem gjysëm shurdh profesor:
- Po nëse të shkul edhe veshin tjetër?
- Do ngelem qorr profesor...
Profesori i trembur e pyet:
- E si ka mundësi që do ngelesh qorr?
- Po ngaqë s'kam ku ti var syzet profesor!

THËNIA E DITËS

Do mësosh se, në rrugëtimin e jetës tënd, do takosh shumë maska dhe pak fytyra.
(Luigi Pirandello)